



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

**RAPORT AUDITIMI PERFORMANCE**

**“Planet gjithëpërfshirëse të qeverisë dhe aspektet buxhetore për një popullsi në moshim”**

**Tiranë, mars 2026**

## PËRMBAJTJA

1. Përmbledhje.....	5
2. Problemi social dhe rëndësia e auditimit .....	7
2.1 Konteksti i Problemit Social.....	7
2.2 Rëndësia e auditimit të performancës .....	7
3. Subjektet nën auditim.....	8
3.1 Hyrje në subjektet nën auditim .....	8
3.2 Baza ligjore dhe kriteret e tjera që rregullojnë çështjen nën auditim.....	10
3.3 Rëndësia e produkteve të subjektit.....	11
3.4 Peshat në buxhet.....	13
3.5 Feedback-u i subjekteve gjatë auditimit .....	15
4. Detajet e auditimit.....	15
4.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjekteve.....	15
4.2 Objektivat e auditimit.....	16
4.3 Pyetjet e auditimit .....	17
4.4 Fushëveprimi i auditimit .....	18
5. Shtjellimi i pyetjeve të auditimit.....	18
Pyetja kryesore – A sigurojnë politikat kombëtare mbështetje gjithëpërfshirëse për të përballuar sfidat e një popullsie në moshim? .....	18
Mesazhi i auditimit .....	18
5.1 A është miratuar një plan gjithëpërfshirës që adreson fenomenin e moshimit të popullsisë? .....	23
5.1.1 A i kanë përmbushur institucionet përgjegjëse detyrimet lidhur me zbatimin e politikave të ndryshme që adresojnë moshimin e popullsisë? .....	23
5.1.2 A është kryer monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të politikave të moshimit të popullsisë?.....	30
5.2 A adresojnë politikat kombëtare sfidat e moshimit të popullsisë në periudhë afatgjatë? ..	40
5.2.1 A janë miratuar politikat bazuar në të dhënat aktuale mbi moshimin e popullsisë?.....	40
5.2.2 A sigurojnë burimet financiare mbështetjen e nevojshme për të mundësuar arritjen e objektivave kombëtare në moshimin e popullsisë? .....	61
6. Observacione të subjekteve nën auditim .....	78

## Lista e Shkurtimeve

KLSH	Kontrulli i Lartë i Shtetit
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
MF	Ministria e Financave
MEI	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MSHRF	Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
NJQV	Njësi të Qeverisjes Vendore
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
EUROSAI	Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit
KM	Këshilli i Ministrave
3E	Ekonomiciteti, Eficienca, Efektiviteti
SK	Strategjia Kombëtare
PBA	Program Buxhetor Afat Mesëm
INSTAT	Instituti i Statistikave
IPSH	Institucionet e Përkujdesit Shoqëror
GR	Garancia Rinore
AFP	Arsimi dhe Formimi Profesional
OECD	Organisation for Economic Co-operation and Development
UNESCO	United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization
NEET	Të rinj jo në punësim, arsim apo trajnim
UNICEF	United Nations Children's Fund
UNDP	United Nation Development Programme
GIZ	The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit

\*\*\*\*\*

Kontrolli i Lartë i Shtetit në përmbushje të objektivave të Strategjisë së Zhvillimit 2023-2027, rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, si dhe në kuadër të bashkëpunimit të vijueshëm me institucionet homologe të auditimit, zhvilloi Auditimin e Performancës me temë “*Planet gjithëpërfshirëse të qeverisë dhe aspektet buxhetore për një popullsi në moshim*”.

Ky auditim vjen si rezultat i angazhimit që KLSH ka ndërmarrë me disa SAI të tjera për të audituar fenomenin e **moshimit të popullsisë** që ka prekur vendet e Europës por edhe më gjerë. Në këtë auditim paralel që drejtohet nga SAI i Izraelit, marrin pjesë institucionet supreme të auditimit të Austrisë, Maqedonisë së Veriut, Lituanisë, Maltës, Paraguait, Polonisë, Portugalisë, Sllovakisë, Republikës Çeke dhe Izraelit. Brenda temës së **moshimit të popullsisë** janë identifikuar 5 nëntema si:

1. *Planet gjithëpërfshirëse të qeverisë dhe aspektet buxhetore për një popullsi në moshim;*
2. *Përgatitja e sistemit shëndetësor për një popullsi në moshim – Kujdesi për të moshuarit në bazë komuniteti;*
3. *Përgatitja e sistemit të mirëqenies për një popullsi në moshim – Mirëqenia dhe cilësia e jetës pas daljes në pension;*
4. *Efektet e një popullate në moshim në tregun e punës dhe sistemi i mirëqenies;*
5. *Përgatitja e sistemit të pensioneve për një popullsi në moshim.*

Lidhur me 5 nëntemat e listuara më sipër SAI të ndryshëm janë angazhuar në kryerjen e temave që kanë interes për vendin e tyre. KLSH u angazhua në kryerjen e auditimit me temë “*Planet gjithëpërfshirëse të qeverisë dhe aspektet buxhetore për një popullsi në moshim*” së bashku me 5 SAI të tjerë si SAI i Izraelit, Maqedonisë së Veriut, Sllovakisë, Portugalisë dhe Paraguajt.

Fokusi i këtij auditimi i dakordësuar me të gjithë pjesëmarrësit ishte dhënia e një panorame të politikave dhe planeve të secilit shtet pjesëmarrës për të adresuar moshimin e popullsisë, me qëllim garantimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe social. Më konkretisht, ky auditim është përpjekur të identifikojë dhe të trajtojë çështje si ekzistenca e një plani gjithëpërfshirës me objektiva specifike që synojnë të përmirësojnë trendet e moshimit të popullsisë, apo ka plane të ndryshme sektoriale. Lidhur me planin gjithëpërfshirës apo planet sektoriale është synuar të identifikohen objektivat konkrete, përgjegjësia institucionale, realizimi i qëllimeve të synuara, monitorimi dhe mbështetja financiare. Gjithashtu, është vlerësuar se deri në çfarë mase planet janë hartuar duke u bazuar në të dhëna dhe nëse ato synojnë ndryshimin e trendit të moshimit të popullsisë në periudhë afatgjatë.

## 1. Përmbledhje

Auditimi me temë “*Planet gjithëpërfshirëse të qeverisë dhe aspektet buxhetore për një popullsi në moshim*” kishte si objektivi kryesor vlerësimin e politikave, strategjive, planeve të vendit tonë që adresojnë çështjet, sfidat dhe problemet që lidhen me fenomenin e moshimit të popullsisë. Auditimi u zhvillua në institucionet që kanë përgjegjësi për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave kombëtare për moshimin e popullsisë, konkretisht në Ministrinë e Financave, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, Institutin e Statistikave dhe në Shërbimin Social Shtetëror. Periudha nën auditim ishte 2020-2025.

Sipas Censurit të vitit 2023, popullsia banuese në Republikën e Shqipërisë në Shtator 2023 ishte 2,402,113 banorë, duke shënuar një ulje prej rreth 420 mijë personash krahasuar me Censurin e vitit 2011. Ndërsa sipas bazës së të dhënave të INSTAT popullsia e Shqipërisë në vitin 2023 ka qenë 2,761,785 banorë me një ulje prej rreth 145 mijë persona krahasuar me vitin 2011<sup>1</sup>. Të dhënat tregojnë se Shqipëria po përballet me një transformim të thellë demografik, i karakterizuar nga rënie e vazhdueshme e lindshmërisë, emigrim i lartë i të rinjve në moshë pune, rritje e jetëgjatësisë dhe rritje e ndjeshme e moshës mediane të popullsisë.

Sipas projeksioneve të popullsisë të publikuara nga INSTAT në vitin 2019, skenari i rritjes së ulët, ku supozohet rënie e mëtejshme e lindshmërisë dhe rritje e numrit të emigrantëve, popullsia e Shqipërisë pritet të arrijë në 2,592,975 banorë në vitin 2031, dhe në 2,093,056 banorë në vitin 2061. Projeksione këto që duhet të studiohen përsëri pas rezultateve të Censurit 2023.

Të dhënat tregojnë se norma e lindshmërisë në Shqipëri ishte 1.71 fëmijë për grua në vitin 2012 dhe në vitin 2023 zbriti në 1,21 fëmijë për grua, ndërsa norma e BE-së ishte 1.38 lindje për grua në vitin 2023.

Referuar të ardhurave dhe nivelit të jetesës konstatohet se familjet me fëmijë në varësi, në vitin 2024 rrezikun për të qenë i varfër e kanë në masën 24.8%, ndërsa familjet pa fëmijë në varësi e kanë këtë rrezik në masën 10.5%.

Auditimi i KLSH-së u përpoq të japë një vlerësim të paanshëm lidhur me çështje si:

- nëse vendi ynë ka një plan gjithëpërfshirës që adreson çështjet e moshimit të popullsisë, apo ka plane të ndryshme sektoriale që adresojnë këtë fenomen;
- zbatimin e objektivave të vendosura, si dhe monitorimin e progresit të bërë;
- vlerësimin e objektivave apo planeve që adresojnë moshimin e popullsisë në terma afatgjatë dhe sa janë bazuar ato në të dhëna apo në treguesit e moshimit të popullsisë;
- vlerësimin e burimeve financiare për mbështetjen e objektivave që adresojnë çështjet e moshimit të popullsisë.

Disa nga problematikat kryesore që rezultuan në përfundim të auditimit paraqiten të përmbledhura në vijim.

Shqipëria nuk ka një dokument të vetëm strategjik që adreson në mënyrë të integruar fenomenin e moshimit të popullsisë. Moshimi i popullsisë trajtohet pjesërisht përmes strategjive sektoriale (p.sh. Strategjia e Punësimit dhe Aftësive, Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale, Strategjia e Rinisë, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim). Mungesa e një strategjie gjithëpërfshirëse për moshimin e popullsisë bën që politikat të jenë të shpërndara dhe jo të koordinuara si duhet, duke sjellë mos adresimin në mënyrë efektive të fenomenit të moshimit të popullsisë. Nga ana tjetër edhe objektivat e vendosura në strategjitë sektoriale nuk kanë një nivel të lartë zbatimi, si dhe procesi i monitorimit ka ende probleme në matjen e saktë të arritjes së objektivave. Si rezultat treguesit demografikë vijnë të

<sup>1</sup> [https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST/START\\_DE/POP01/table/tableViewLayout1/](https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST/START_DE/POP01/table/tableViewLayout1/)

përkeqësohen, duke dëshmuar që politikat aktuale nuk kanë sjellë ndikim real në përmirësimin e treguesve.

Të dhënat tregojnë se pavarësisht politikave të miratuara, treguesit demografikë kanë vijuar të përkeqësohen. Konkretisht moshja mediane në Shqipëri ka shënuar një rritje, nga rreth 32.6 vjeç në vitin 2011 në 38.8 vjeç në vitin 2023 dhe me një rritje akoma edhe më të shpejtë në vitet 2024 dhe 2025, respektivisht 43.5 dhe 44.3 vjeç. Lindshmëria ka rënë me 72% nga viti 1990 deri në vitin 2024, ndërsa migracioni neto është përkeqësuar nga -15,030 (2018) në -32,497 (2022). Konstatohet se “bonusi i bebes” i planifikuar si një politikë e Qeverisë Shqiptare për mbështetjen e familjeve të reja, rritjen e numrit të lindjeve dhe zhvillimin e shoqërisë, nuk ka pasur asnjë ndikim në ndryshimin e trendeve aktuale përsa i takon rritjes së numrit të lindjeve. Si rezultat vendi ynë duhet të vlerësojë me prioritet ndryshimin e skemës së mbështetjes financiare për fëmijët si dhe të vlerësojë politika të tjera për mbështetjen e familjeve me fëmijë.

Plakja e popullsisë është sfida më serioze demografike në dekadat e ardhshme për Shqipërinë, pasi politikat aktuale, të fragmentuara dhe të pazbatuara plotësisht, nuk garantojnë qëndrueshmërinë ekonomike dhe sociale të vendit.

Në këtë kontekst, gjetjet e auditimit theksojnë domosdoshmërinë e hartimit të një strategjie kombëtare të unifikuar dhe ndërsektoriale për moshimin e popullsisë, të mbështetur në analiza demografike të thelluara, objektiva afatshkurtër dhe afatgjatë, tregues të matshëm dhe një sistem të integruar të monitorimit. Një strategji e tillë duhet të bashkojë në një dokument të vetëm politikat e punësimit, lindshmërisë, migracionit, mbrojtjes sociale dhe zhvillimit ekonomik, duke garantuar që të gjitha institucionet të punojnë sipas një vizioni të përbashkët dhe të sinkronizuar për t’u përballur me fenomenin e moshimit.

Analiza e dokumenteve strategjike aktualë dhe performancës së institucioneve përgjegjëse tregon se Shqipëria ka ende shumë punë për të bërë për t’u përballur me pasojat afatgjata të plakjes së popullsisë. Për sa kohë që politikat mbeten të fragmentuara, të pazbatuara plotësisht dhe të paorientuara nga të dhëna reale, vendi rrezikon të mos përballet në mënyrë të qëndrueshme me këtë fenomen në dekadat e ardhshme.

Në përfundim për të gjithë problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime specifike shoqëruar me afatet kohore konkrete për zbatimin e tyre.

## **2. Problemi social dhe rëndësia e auditimit**

### **2.1 Konteksti i Problemit Social**

Shqipëria po përballet me një ndryshim të madh në përbërjen e popullsisë: numri i të moshuarve po rritet me shpejtësi, ndërsa lindjet dhe të rinjtë në vend po pakësohen. Ky proces, i njohur si plakja e popullsisë, është kthyer në një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballet vendi ynë sot.

Ky ndryshim vjen si pasojë e disa faktorëve të ndërthurur: më pak lindje, largimi i të rinjve jashtë vendit. Të dhënat e INSTAT tregojnë se në vitin 2023, 15.4% e popullsisë shqiptare ishte mbi 65 vjeç<sup>2</sup>. Parashikimet flasin për një rritje të mëtejshme, ku deri në vitin 2050 kjo shifër pritet të kapërcejë 25% – një nga nivelet më të larta në rajon.

Kjo situatë po sjell sfida të mëdha në shumë drejtime. Një ndër to është ndryshimi i rolit të familjes. Tradicionalisht, në Shqipëri kujdesi për të moshuarit është ofruar nga familja. Por sot, për shkak të emigracionit dhe ndryshimeve në mënyrën e jetesës, shumë të moshuar jetojnë vetëm ose me ndihmë të kufizuar. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë<sup>3</sup>, më shumë se 40% e të moshuarve në Shqipëri ndodhen në këtë situatë, duke rritur rrezikun për izolim social dhe probleme me shëndetin mendor e fizik.

Për më tepër, përparimi teknologjik dhe ndryshimet kulturore kanë thelluar distancën mes brezave, duke e bërë më të vështirë për të moshuarit të marrin pjesë në jetën sociale. Një raport i Eurostat<sup>4</sup> tregon se rreth 30% e të moshuarve shqiptarë ndihen të vetmuar dhe kanë mungesë aktivitetesh. Kjo tregon nevojën për politika që nxisin përfshirjen sociale dhe jetën aktive të të moshuarve.

Një tjetër arsye e rëndësishme për plakjen e popullsisë është emigracioni i vazhdueshëm i të rinjve dhe rënia e lindshmërisë. Shumë të rinj largohen nga vendi për mundësi më të mira, ndërsa ata që qëndrojnë shpesh ndihen të pasigurt për të krijuar familje për shkak të kushteve ekonomike dhe mungesës së mbështetjes. Në vitin 2023, numri mesatar i lindjeve për një grua ishte vetëm 1.3 e cila është një nga nivelet më të ulëta në rajon.

Për të përballuar këtë realitet, qeveria shqiptare ka përfshirë moshimin e popullsisë në Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2023–2030<sup>5</sup>. Kjo strategji synon të përmirësojë shërbimet sociale, të forcojë sistemin e kujdesit afatgjatë dhe të promovojë përfshirjen digjitale e sociale të të moshuarve. Megjithatë, zbatimi i saj kërkon bashkëpunim të mirëfilltë mes institucioneve, fonde të mjaftueshme dhe monitorim të rregullt të rezultateve.

Përmes këtij auditimi synohet të vlerësohet nëse politikat dhe shërbimet aktuale po i përgjigjen realisht nevojave të të moshuarve dhe a po merren masa për të nxitur rritjen e lindshmërisë dhe uljen e shifrave të plakjes së popullsisë. Auditimi do të analizojë masat e ndërmarra nga institucionet publike, si dhe boshllëqet që duhen mbushur për të ndërtuar një sistem të qëndrueshëm mbështetjeje.

Plakja e popullsisë nuk është vetëm çështje numrash, por është një çështje që prek drejtpërdrejt jetën e mijëra njerëzve dhe mënyrën si funksionon shoqëria jonë. Ajo kërkon vëmendje të menjëhershme, planifikim të kujdesshëm dhe politika gjithëpërfshirëse që e vënë njeriun në qendër.

### **2.2 Rëndësia e auditimit të performancës**

Auditimi është një instrument thelbësor i procesit të llogaridhënies për shpenzimin e parave publike, i cili jep një kontribut të rëndësishëm për miradministrimin e burimeve dhe kryerjen e shërbimeve për qytetarët. Auditimi i performancës është një shqyrtim i pavarur, objektiv dhe i besueshëm i faktit nëse sipërmarrjet, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet dhe

<sup>2</sup> Struktura e popullsisë sipas grupmoshës <https://www.instat.gov.al/>

<sup>3</sup> *Ageing and health profile: Albania*, <https://www.who.int/>

<sup>4</sup> *Elderly social inclusion statistics*: <https://ec.europa.eu/eurostat/>

<sup>5</sup> Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale: <https://shendetesia.gov.al/>

organizatat qeveritare po veprojnë në përputhje me parimet e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit, dhe nëse ekziston mundësia për përmirësim të mëtejshëm. Kontrolli i Lartë i Shtetit e ka vendosur auditimin e performancës si një nga shtyllat moderne të zhvillimit institucional. Në Planin Strategjik 2023-2027, KLSH e ndërton misionin e vet si institucion i pavarur kushtetues, duke qenë partner strategjik i Kuvendit, i qytetarit shqiptar dhe palëve të interesit, duke i informuar në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë, mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në përdorimin e kontributit të taksapaguesve shqiptarë e duke kontribuar në përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet luftës kundër korrupsionit.

Synimi i KLSH-së në auditimin e performancës është përmirësimi i eficiencës dhe efektivitetit në shërbimet publike që i ofrohen taksapaguesit shqiptar, duke ekonomizuar njëkohësisht përdorimin e fondeve publike. Informimi i publikut dhe i Kuvendit të Shqipërisë në lidhje me përdorimin e burimeve me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet, nga pushteti qendror dhe lokal e nga njësi të tjera publike, si dhe nxitja e përgjegjshmërisë në të gjithë sektorin publik, në përputhje me direktivat e praktikave me të mira të BE-së dhe me standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t, duke kontribuar kështu në mirë qeverisje.

Në linjë me Strategjinë institucionale 2023-2027, auditimi i performancës synon parandalimin përmes këshillimit, përpara ndëshkimit përmes penalizimit. Në këtë kontekst ky auditim, ka në fokus kryesisht politikën dhe planet e qeverisë me qëllim vlerësimin nëse janë hartuar dhe a janë të aplikueshme dhe gjithëpërfshirëse për një popullsi në moshim si dhe efektivitetin e menaxhimit financiar dhe përdorimin e burimeve buxhetore për trajtimin e këtij fenomeni. Bazuar sa më lart, ky lloj auditimi ka si synim të rekomandojë përmirësime për zbatimin e politikave dhe programeve qeveritare, që adresojnë në mënyrë më efikase dhe të qëndrueshme sfidat që sjell plakja e popullsisë në vendin tonë.

### 3. Subjektet nën auditim

#### 3.1 Hyrje në subjektet nën auditim

Për vlerësimin e planeve dhe politikave gjithëpërfshirës të qeverisë për një popullsi në moshim, është e domosdoshme të shqyrtohen institucionet kyçe që kanë përgjegjësi për menaxhimin e aspekteve financiare, demografike dhe sociale të kësaj çështjeje si dhe hartimin e politikave dhe strategjive në bazë të adresimit të problematikave të një popullsie në moshim. Subjektet nën auditim janë:



**Ministria e Financave (MF)**, është institucioni përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave makroekonomike, fiskale dhe buxhetore të vendit, duke përfshirë edhe fondet e destinuar për përfitimet në bazë të politikave qeveritare. Ajo vepron në përputhje me legjislacionin dhe mbulon ndër të tjera dhe fushat e mëposhtme:

- Politika makroekonomike dhe fiskale;
- Administrimi i të ardhurave dhe buxhetit të shtetit;
- Administrimi dhe kontrolli financiar;
- Menaxhimi i asistencës financiare nga BE. <sup>6</sup>

Lidhur me një popullsi në moshim, ish Ministria e Financave dhe Ekonomisë (ish- MFE) ka hartuar Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023–2030<sup>7</sup> e cila adreson, ndër të tjera dhe problemin e zvogëlimit të rritjes së fuqisë punëtorë si pasojë e plakjes së popullsisë

<sup>6</sup> VKM-së nr. 31, datë 17.01.2024 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë së Ministrisë së Financave”, pika 3 dhe 4.

<sup>7</sup> Miratuar me VKM nr. 173, datë 24.03.2023, ndryshuar me Vendimin Nr. 68, datë 29.01.2025 Për disa ndryshime në vendimin nr. 173, datë 24.03.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023–2030, planit të veprimit për zbatimin e saj, si dhe Planit të Zbatimit të Garancisë Rinore 2023–2024”.

dhe lëvizjes migratore.<sup>8</sup> Kjo strategji synon të përmirësojë cilësinë e punësimit, të nxisë përfshirjen e grupeve vulnerabël dhe të përshtatë ofertën e aftësive me kërkesat e tregut të punës. Në vitin 2024 MFE u ristrukturua duke u ndarë në Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit.<sup>9</sup> Si pasojë, kompetencat e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e kësaj strategjie i kaluan **Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI)**.



### **Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI)**

MEI ushtron veprimtarinë e saj në disa fusha përgjegjësie si në atë të punësimit, nxitjen e investimeve, arsimit dhe formimit profesional, nxitjen e investimeve etj.<sup>10</sup> MEI ka përgjegjësi për hartimin dhe zbatimin e politikave të qeverisë në sferën makro-dhe mikroekonomike, për ndërtimin e një modeli të ri ekonomik, me synim garantimin e një rritjeje ekonomike të lartë e të qëndrueshme në Shqipëri, si dhe garanton të drejtën për arsim dhe formim profesional, punësim të sigurt e të denjë.

Në zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023–2030, MEI ka rol udhëheqës dhe është institucioni përgjegjës për fushën e punësimit dhe aftësimin profesional. MEI ka kompetenca të drejtpërdrejta për hartimin e politikave strategjike dhe të kuadrit ligjor, si dhe për sigurimin e bashkërendimit dhe bashkëpunimit mes institucioneve kyçe të sektorit, të cilat janë:

- Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA)– përgjegjëse për zbatimin e politikave publike dhe ofrimin e shërbimeve të drejtpërdrejta të punësimit dhe administrimin e ofruesve të arsimit e formimit profesional;

- Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK)– përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe sigurimin e cilësisë në AFP 33, veçanërisht për barrën fiskale nga tatimi i punës për pagat e ulëta, ndihmën ekonomike dhe kushtet e sigurisë dhe shëndetit në punë. Barra fiskale e të ardhurave nga puna është ndryshimi midis pagës bruto dhe neto e cila krijon një kosto shtesë për punonjësit, për shkak të kontributeve për sigurimet shoqërore dhe tatimit mbi pagë. Sipas raportit të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal lidhur me Performancën e Ekonomive të Ballkanit Perëndimor në lidhje me Shtyllën Evropiane të të Drejtave Sociale, një e treta e bizneseve shqiptare i konsiderojnë taksat e pagave dhe kontributet e sigurimeve shoqërore si një pengesë të rëndë për rritjen e biznesit.

- Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH), përgjegjës për sigurimin e zbatimit të legjislacionit të punës dhe mbrojtjes së punëmarrësve. Përveç institucioneve përgjegjëse në nivel qendror, si dhe institucioneve zbatuese, një rol kyç në zbatimin e politikave të punësimit dhe të zhvillimit të aftësive luan koordinimi dhe bashkërendimi ndërinstytucional me ministrinë përgjegjëse për çështjet e arsimit dhe mbrojtjes sociale, agjencitë e tyre zbatuese, si dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore.



**Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (MSHMS)**, ka si qëllim kryesor hartimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive zhvillimore në sektorin e kujdesit shëndetësor dhe të mbrojtjes sociale. Ajo është përgjegjëse për rregullimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve shëndetësore, si dhe për bashkërendimin e punës ndërmjet aktorëve të ndryshëm që kontribuojnë në garantimin e së drejtës kushtetuese për kujdes shëndetësor dhe

<sup>8</sup> Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023–2030, pika 1.1, fq. 9.

<sup>9</sup> Vendim nr. 30, datë 17.1.2024 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit”, pika 4.

<sup>10</sup> Vendim nr. 30, datë 17.1.2024 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit”,

përfshirje sociale. Ministria ushtron veprimtarinë e saj në një sërë fushash, përfshirë zhvillimin e politikave dhe strategjive për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore dhe të treguesve të shëndetit publik. Po ashtu, MSHMS është e angazhuar në hartimin dhe zbatimin e politikave për mirëqenien sociale të individëve dhe komuniteteve në nevojë, barazinë gjinore, mbrojtjen nga dhuna dhe diskriminimi, përfshirë këtu edhe ndihmën për grupe të cënueshme dhe sigurimin e shërbimeve sociale alternative.<sup>11</sup> Lidhur me një popullsi në moshim ajo ka hartuar dhe miratuar strategji afatgjata që synojnë përmirësimin e cilësisë së jetës.



**Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH)**, është një institucion buxhetor në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, mbështet implementimin e politikave të mbrojtjes sociale përmes ofrimit të ndihmës ekonomike<sup>12</sup>, programeve komunitare dhe shërbimeve për individët në nevojë.<sup>13</sup> Gjithashtu, SHSSH është përgjegjës për zbatimin praktik të politikave dhe programeve sociale, sipas direktivave të MSHMS. Ky institucion monitoron dhe mbështet njësitë vendore në ofrimin e shërbimeve sociale për grupet në nevojë, përfshirë të moshuarit.



**Instituti i Statistikave (INSTAT)**, është institucioni qendror për prodhimin e statistikave zyrtare në Shqipëri. Ai ka për detyrë të sigurojë statistika të sakta, transparente dhe të paanshme për zhvillimet ekonomike e sociale në vend. INSTAT harton dhe zbaton programin statistikor, garanton cilësinë e të dhënave, përfaqëson vendin në marrëdhëniet statistikore ndërkombëtare dhe mirëmban regjistrat statistikorë, duke u mbështetur në standardet më të mira profesionale dhe ndërkombëtare.<sup>14</sup> Ai siguron të dhëna të përditësuara mbi tendencat e plakjes, emigracionit, lindshmërinë dhe ndryshimet në tregun e punës. INSTAT organizon dhe zbaton Censin i cili synon të ofrojë të dhëna mbi strukturën demografike të popullsisë sipas grupmoshave dhe gjinisë me rëndësi për planifikimin dhe realizim e politikave qeveritare.<sup>15</sup>

### 3.2 Baza ligjore dhe kriteret e tjera që rregullojnë çështjen nën auditim

Baza ligjore kryesore që rregullon aktivitetin e subjektit lidhur me çështjen nën auditim që do të jetë burimi i kriterëve të auditimit.

#### Kriteret politike

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI);
- Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021 - 2030;
- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030;
- Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2020 - 2023 dhe 2024 - 2030;
- Dokumenti Politik Kombëtar për Moshimin 2020 - 2024;
- Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023 - 2030;
- Plani i Veprimit të Shëndetit Seksual dhe Riprodhues 2022 - 2030;
- Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Rinisë 2022 - 2029.

#### Kriteret teknike

<sup>11</sup> Vendim Nr.609, datë 20.10.2021 “Për Përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”.

<sup>12</sup> Ligj Nr. 57/2019, i përditësuar, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>13</sup> Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>14</sup> Ligji nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, neni 14.

<sup>15</sup> Ligji nr. 140/2020 “Për Censin e popullsisë dhe të banesave”, neni 2.

- Ligji nr.10383, datë 24.2.2011, “Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr.121/2016, “ Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”;
- Ligji nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;<sup>16</sup>
- Ligji nr. 57/2019 “ Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr.10 107, datë 30.3.2009, “Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 8876, datë 04.04.2002 “Për Shëndetin Riprodhues”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 15/2019 “ Për Nxitjen e Punësimit”;
- Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 ”Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”;
- Ligji nr. 75/2019 “Për Rininë”;
- Ligji nr.15/2017 “ Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji nr. 65/2016 “Për Ndhimën Shtetërore”;
- Ligji nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”;
- Urdhër i Ministrit të Shëndetësisë nr.25, datë 22.01.2016, “Për Miratimin e Udhërrëfyesit dhe Protokollet e Planifikimit Familjar”.

#### **Kriteret e monitorimit dhe raportimit**

- Census 2023 ”Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave”.
- Programi i statistikave zyrtare 2022-2026;
- EUROSTAT “Demography of Europe”.<sup>17</sup>
- World Bank, “Population estimates and projections”.<sup>18</sup>
- Raporte vjetore të monitorimit të buxhetit.

#### **Kriteret e tjera/Praktikat më të mira**

- Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH): “Global strategy and action plan on ageing and health”.<sup>19</sup>
- UNECE “Ageing Policies Database”.<sup>20</sup>

### **3.3 Rëndësia e produkteve të subjektit**

Institucionet shtetërore në Shqipëri, veçanërisht Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Shërbimi Social Shtetëror dhe Instituti i Statistikave luajnë një rol vendimtar në adresimin e sfidave që lidhen me moshimin e popullsisë.

- INSTAT është një institucion profesional i pavarur i cili prodhon statistika asnjëse, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve mbi proceset e zhvillimit e transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit. Vizioni i INSTAT-it është që të ofrojë të dhëna të besueshme dhe të krahasueshme, duke përshtatur metodologjitë dhe duke shtuar listën e treguesve statistikorë.

<sup>16</sup> Neni 26, 27, 28, 29.

<sup>17</sup> <https://ec.europa.eu/eurostat/web/interactive-publications/demography-2023#ageing-population>

<sup>18</sup> <https://databank.worldbank.org/source/population-estimates-and-projections>

<sup>19</sup> <https://iris.who.int/bitstream/handle/10665/329960/9789241513500-eng.pdf>

<sup>20</sup> <https://ageing-policies.unece.org/browse-policy?keyword=&countries=1&themes>

Bazuar në të dhënat e publikuara nga ky institucion në Censin e 2023, popullsia në Shqipëri po përballet me një proces të qartë moshimi, ku përqindja e personave mbi 65 vjeç ka arritur në 19.5% të totalit, nga 12.4% që ishte në vitin 2000, ndërsa pritet që kjo përqindje të rritet në mbi 30% brenda 20 viteve të ardhshme, duke krijuar presion të madh mbi sistemin shëndetësor dhe shërbimet sociale. Ky ndryshim reflekton uljen e lindshmërisë dhe rritjen e jetëgjatësisë mesatare, që tani është 77.3 vjet për meshkujt dhe 81.2 vjet për femrat. Po ashtu, INSTAT raporton se mosha mesatare e shqiptarëve ka arritur në 42.1 vjeç, duke reflektuar një trend të qartë të plakjes së popullsisë

Këto statistika shërbejnë si instrument matës dhe mbështetës për zhvillimin ekonomik-social dhe programimin ekonomik, shëndetësor apo social në Shqipëri pasi pritet të ndikojnë ndjeshëm në kërkesën për shërbime shëndetësore dhe sociale, duke rritur nevojën për politika gjithëpërfshirëse dhe të koordinuara.

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale si institucion përgjegjës për hartimin e politikave kombëtare sa i takon shërbimeve të përkujdesit shoqëror, ka gjeneruar produkte siç është Dokumenti Politik Kombëtar për Moshimin, 2020- 2024, udhëzime, statistika, trajnime të stafit, raporte monitorimi si dhe aktivitete që adresojnë fokusin tonë të auditimit. Ministria e Shëndetësisë ka zhvilluar programe për menaxhimin e sëmundjeve kronike, të cilat janë më të përhapura në grupmoshën e tretë, si diabeti, hipertensioni dhe sëmundjet kardiovaskulare duke promovuar fushata ndërgjegjësimi për stilin e jetesës së shëndetshme dhe kujdesin parandalues.

- Shërbimi Social Shtetëror si institucion buxhetor në varësi të ministrit përgjegjës për çështjet e ndihmës dhe të shërbimeve shoqërore, është i organizuar me një Drejtori të Përgjithshme dhe 12 Drejtori Rajonale, si edhe 29 institucione të përkujdesit shoqëror ndër to edhe për të moshuar, apo për persona me aftësi të kufizuara etj.

Në nivel social, rreth 60% e të moshuarve jetojnë në zonat rurale, ku aksesueshmëria në shërbime shëndetësore dhe sociale është më e kufizuar, dhe vetëm 38% e tyre përfitojnë nga shërbimet sociale, situatë e cila nënvizon rëndësinë e shërbimeve sociale dhe komunitare për të ofruar mbështetje në aktivitete të përditshme, ndihmë në shtëpi, dhe mundësi për integrim social dhe reduktim të izolimit. Shërbimi Social Shtetëror financohet nga buxheti i shtetit dhe alokon fondet për institucionet e përkujdesit shoqëror, për kompensimin e pagesave të familjeve në skemën e ndihmës ekonomike dhe personave me aftësi të kufizuara, si edhe shpenzimet administrative për Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror dhe Drejtoritë Rajonale.

Në formë ndihme të menjëhershme financiare për nënat me foshnja të porsalindura, pranë Shërbimit Social Shtetëror ofrohet shërbimi i lëshimit të bonusit të bebes. Ky është një shërbim që ofrohet prej vitit 2019 edhe për fëmijët e lindur në strukturat spitalore private dhe për fëmijët e lindur jashtë vendit kur prindërit nuk janë rezidentë jashtë vendit.

Koordinimi i Ministrisë së Shëndetësisë me shërbimet sociale është thelbësor për të garantuar një qasje gjithëpërfshirëse dhe efektive në përballimin e sfidave të moshimit të popullsisë, duke përmirësuar cilësinë e jetës së të moshuarve dhe duke siguruar përdorimin efikas të fondeve publike. Investimi në trajnimin e personelit apo dhe përmirësimi i infrastrukturës mbeten prioritet për të ofruar kujdes cilësor dhe të qëndrueshëm në të ardhmen.

- Ministria e Financave është institucioni përgjegjës për arritjen e stabilitetit ekonomik nëpërmjet drejtimit me efektshmëri, efektivitet dhe transparencë të financave publike, e cila e ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës për politikën makroekonomike dhe fiskale, administrimin e të ardhurave, administrimin e buxhetit të shtetit, sigurimin e fondeve të mjaftueshme për shërbimet dhe programet për të moshuarit, etj. Në kuadër të

Dokumentit Politik Kombëtar për Moshimin, 2020- 2024, i cili është një dokument politik që përfaqëson një plan të detajuar dhe gjithëpërfshirës me synim përmirësimin e jetës së të moshuarve në Shqipëri, duke adresuar sfidat komplekse të plakjes së popullsisë në mënyrë të koordinuar dhe të qëndrueshme, MF përfshihet nëpërmjet garantimit të kushteve për përmirësimin gradual të pensioneve më të ulëta, për çdo vit, në përputhje me rritjen e nivelit të inflacionit. Ofrimin e një mbështetje të qëndrueshme për të moshuarit më të varfër, hartimin e një dokumenti mbi metodologjinë për përlogaritjen e vazhdueshme të pensionit minimal dhe intensifikimin e informimit nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore mbi pensionet sociale, me synim uljen e numrit të atyre që nuk e përfitojnë atë, thjesht për arsye informimi dhe burokracie. Për sa më lartë, moshimi i popullsisë është një sfidë komplekse që kërkon përgjigje gjithëpërfshirëse, ku institucionet shtetërore luajnë rol kyç në zbatimin e politikave dhe masave të duhura për mirëqenien e të moshuarve në Shqipëri.

### 3.4 Pesha në buxhet

Për referencë të temës tonë të auditimit kemi shqyrtuar buxhetin faktik të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për vitet 2020-2024 si buxhetin e planifikuar për vitin 2025. Nga të dhënat e paraqitura në tabelën në vijim, vërehet se buxheti i MSHMS ka ardhur duke u rritur nga viti 2020 në vitin 2025. Si zë të lidhur me temën tonë të auditimit kemi identifikuar programin “Përkujdesi Social” vlera e të cilit po ashtu ka pësuar një rritje nga viti 2020 (27,756,103 lekë) në vitin 2024 (30,332,521 lekë). Vërehet se në vitin 2025 planifikimi i buxhetit për këtë program është më i ulët se në vitin 2024, përkatësisht 27,502,528 lekë në total nga 30,332,521 lekë që është realizuar në vitin 2024.

Tabela nr. 1: Buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për periudhën 2020-2025  
000 lekë

Programi	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
	Fakt	Fakt	Fakt	Fakt	Fakt	Plan
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2,188,312	1,534,148	446,138	313,261	363,094	467,313
Shërbimet e Kujdesit Parësor	7,702,041	8,421,690	7,692,563	6,957,690	5,555,527	6,836,799
Shërbimet e Kujdesit Dytësor	25,732,181	31,938,573	33,278,914	33,950,951	37,547,691	39,456,173
Shërbimet e Shëndetit Publik	2,842,056	7,016,121	4,869,954	3,673,275	4,130,654	5,019,287
Shërbimi Kombëtar i Urgjencës	296,051	289,775	232,995			
<b>Përkujdesi Social</b>	<b>27,756,103</b>	<b>28,215,775</b>	<b>29,486,505</b>	<b>30,187,006</b>	<b>30,332,521</b>	<b>27,502,528</b>
Rehabilitimi i të Përndjekurve Politik	1,033,156	945,121	1,027,241	1,135,013	1,096,402	1,448,051
<b>Totali MSHMS</b>	<b>67,549,900</b>	<b>78,361,203</b>	<b>77,034,310</b>	<b>76,217,196</b>	<b>79,025,889</b>	<b>80,730,151</b>

Burimi: MSHMS, përpunoi grupi i auditimit

### Programi i Përkujdesit Social

Programi i Përkujdesit Social ka në fokus mbështetjen financiare të kategorive në nevojë nëpërmjet shtyllave kryesore, që janë Ndihma Ekonomike, Pagesa e Aftësisë së Kufizuar, Bonusi i bebes, programi i mbështetjes së veçantë për gratë e papuna, me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç dhe financimi i shërbimeve të Përkujdesit Social.

Tabela nr. 2: Produktet e programit të “Përkujdesit Social” për periudhën 2020-2025

Produktet e Programit	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
“Përkujdesi Social”	Fakt	Fakt	Fakt	Fakt	Fakt	Plan
Familje dhe individë në nevojë që përfitojnë nga skema e NE	5,434,644	6,464,153	6,663,411	5,999,478	5,763,983	7,232,000
PAK dhe kujdestarë që përfitojnë pagesa	18,465,130	17,079,189	18,430,117	18,349,196	19,612,354	15,238,000
Bonusi i bebes	2,820,890	3,303,110	3,100,000	3,305,516	2,200,000	2,250,000
Përfitues të shërbimeve të përkujdesit social të ofruara në qendrat rezidenciale publike	871,043	457,564	274,522	382,237	444,985	452,672
Fëmijë që përfitojnë shërbime në institucionet e përkujdesit	-	235,143	237,503	266,372	305,139	307,375
Të moshuar të trajtuar me shërbime të përkujdesit	-	174,087	184,893	209,941	242,902	240,803
Persona me Aftësi të Kufizuar që përfitojnë shërbime të përkujdesit	-	-	206,071	250,859	284,197	282,175
Persona nga grupet e pafavorizuara të punësuar nga ndërmarrjet sociale	-	-	-	-	3,677	80,000
Shërbime të reja sociale për grupet në nevojë të ofruara nëpërmjet njësisve vendore nga financimi i fondit social	94,481	147,895	158,818	176,293	275,365	330,000
Mbrojtje e veçantë nga shteti, për gratë e papuna, me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç				779,824	862,710	820,000
Raporte monitorimi për mbrojtjen e fëmijëve	10,370	9,963	10,079	11,690	12,637	13,565
Vendimet e gjykatës për PAK		287,822	196,897	380,248	318,595	
Personel jo mjekësor i trajtuar me bonus për COVID-19	28,093					
Investime	32,356	56,849	24,194	75,351	5,975	255,938
<b>Totali</b>	<b>27,757,007</b>	<b>28,215,775</b>	<b>29,486,505</b>	<b>30,187,006</b>	<b>30,332,521</b>	<b>27,502,528</b>

Burimi: MSHMS, përpunoi grupi i auditimit

Nga 14 produkte që ka “Programi i Përkujdesit Social”, referuar përshkrimit të produkteve dhe aktiviteteve që ndërmerren në arritje të qëllimeve të këtij programi, janë identifikuar dy produkte të lidhura me temën tonë të auditimit, konkretisht “Bonusi i bebes” dhe “Të moshuar të trajtuar me shërbime të përkujdesit”.

Vlera e produktit “Bonusi i Bebes” ka qenë e ndryshueshme nga viti në vit për periudhën 2020-2025, por ajo që vihet re është se realizimi në vitin 2024 dhe planifikimi në vitin 2025 janë në vlerat më të ulta se vitet 2020-2023.

Vlera e produktit “Të moshuar të trajtuar me shërbime të përkujdesit” ka ardhur në rritje nga 174,087 lekë në vitin 2021 në 240,803 lekë të planifikuara për vitin 2025.

Me Vendimin nr. 535, datë 12.08.2024, të Këshillit të Ministrave janë miratuar tavanet përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027, ku Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale financon disa programe buxhetore përfshirë Programin e “Përkujdesjes Sociale”.

Sipas tavaneve përfundimtare shpërndarja për vitet 2025, 2026 dhe 2027 është si më poshtë vijon:

Tabela nr. 3: Tavanet nga Ministria Financave sipas programeve

Në 000 lekë

Kodi	Programi	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	467,313	488,013	490,013
07220	Shërbimet e Kujdesit Parësor	6,836,799	6,956,491	7,006,491
07330	Shërbimet e Kujdesit Dytësor	39,456,173	37,460,059	37,024,059
07450	Shërbimet e Shëndetit Publik	5,019,287	4,398,577	4,408,577
<b>10430</b>	<b>Përkujdesi Social</b>	<b>27,502,528</b>	<b>30,496,770</b>	<b>30,946,770</b>
01190	Rehabilitimi i të Përndjekurve Politik	1,448,051	2,043,351	2,043,351
	<b>Totali MSHMS</b>	<b>80,730,151</b>	<b>81,843,261</b>	<b>81,919,261</b>

Burimi: MSHMS, përpunoi grupi i auditimit

Programi Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 ka parashikuar rritje të vlerës së “Programit të Përkujdesit Social” nga viti 2025 në vitin 2027 në vlerën prej 344,242 lekë.

### 3.5 Feedback-u i subjekteve gjatë auditimit

Gjatë kryerjes së auditimit nga institucionet e përfshira në auditim të cilat janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave kombëtare lidhur me çështje të moshimit të popullsisë, përgjithësisht është mbledhur dokumentacioni i kërkuar por në disa raste ka pasur vonesa të pa justifikuar nga subjektet nën auditim. Nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale grupit të auditimit i janë krijuar kushtet bazë për realizimin e auditimit. Komunikimi me nëpunësit e caktuar nga institucionet nën auditim si dhe me nëpunës të tjerë në përgjithësi ka qenë korrekt dhe nëpunësit i janë përgjigjur kërkesave të grupit të auditimit.

## 4. Detajet e auditimit

### 4.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjekteve

Risqet e aktivitetit të subjekteve janë ato risqe me të cilat përballen institucionet e audituara për realizimin e përgjegjësive të tyre që krijohen nga aktiviteti në tërësi duke u fokusuar në politikat, programet, proceset dhe strategjitë që ndjekin këto institucione për ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore dhe/ose natyrore me vlerë të jashtëzakonshme universale. Risqet e aktivitetit të subjekteve janë analizuar dhe evidentuar në tabelën në vijim.

Fusha e aktivitetit	Përshkrimi i riskut	Ndikimi që mund të kenë risqet e identifikuara	Niveli i riskut	Pyetja e auditimit
Hartimi dhe miratimi i politikave / strategjive	Mungesa e një politike, plani apo/dhe strategjie gjithëpërfshirëse.	Mungesa e një qasjeje gjithëpërfshirëse mund të çojë në veprime të fragmentuara, mbulim të pjesshëm të nevojave dhe mungesë drejtimi të qartë për adresimin e fenomenit të moshimit të popullsisë. Tkurrja e fuqisë punëtore dhe ndikim në rritjen ekonomike. Ulja e normave të lindshmërisë dhe rritja e emigracionit të të rinjve.	I lartë	A është miratuar një plan gjithëpërfshirës që adreson fenomenin e moshimit të popullsisë?
Hartimi i politikave bazuar në të dhëna	Politikat, planet apo strategjitë mund të mos jenë hartuar duke konsideruar të	Hartimi i politikave apo objektivave duke mos u bazuar në të dhëna të besueshme do të bënte që ato	I lartë	A janë miratuar politikat bazuar në të dhënat aktuale mbi moshimin e popullsisë?

Fusha e aktivitetit	Përshkrimi i riskut	Ndikimi që mund të kenë risqet e identifikuara	Niveli i riskut	Pyetja e auditimit
	dhënat mbi moshimin e popullsisë.	mos të ishin reale, të matshme apo të arritshme, ç'ka nuk do të sillte një përmirësim në fenomenin e moshimit të popullsisë.		
Bashkëpunimi dhe ndërveprimi	Mungesë bashkëpunimi apo ndërveprimi midis institucioneve që janë përgjegjëse për zbatimin e objektivave të ndryshme që lidhen me moshimin e popullsisë.	Mungesa e koordinimit midis institucioneve përgjegjëse mund të çojë në mbivendosje kompetencash, krijim hapësirash që mund të mbeten të pambuluara, si rezultat mos zbatim efektiv të politikave apo objektivave për çështjet e moshimit.	I lartë	A i kanë përmbushur institucionet përgjegjëse detyrimet lidhur me zbatimin e politikave të ndryshme që adresojnë moshimin e popullsisë?
Zbatimi i politikave / arritja e objektivave	Politikat, planet apo strategjitë e ndryshme që lidhen direkt apo indirekt me fenomenin e moshimit të popullsisë mund të mos jenë zbatuar plotësisht.	Moszbatimi i politikave apo mos përmbushja e objektivave të ndryshëm që adresojnë çështjet e moshimit të popullsisë ndikojnë në nivelet e punësimit, migrimit, rritjes së numrit të popullsisë etj.	I lartë	A i kanë përmbushur institucionet përgjegjëse detyrimet lidhur me zbatimin e politikave të ndryshme që adresojnë moshimin e popullsisë?
Financimi	Financimi i nevojshëm për arritjen e objektivave mund të mos jetë planifikuar si duhet gjatë procesit të hartimit të strategjive ose mund të mos jetë arritur të sigurohet.	Nuk arrihet zbatimi i objektivave dhe aktiviteteve të përcaktuara duke sjellë pamundësi në uljen e fenomenit të moshimit dhe të faktorëve që e ndikojnë atë në terma afatgjatë.	I mesëm	A sigurojnë burimet financiare mbështetjen e nevojshme për të mundur arritjen e objektivave kombëtare në moshimin e popullsisë?
Monitorimi i zbatimit të objektivave	Mund të mos jetë bërë monitorimi dhe vlerësimi i nivelit të përmbushjes së objektivave të vendosura.	Mungesa e monitorimit mund të çojë në mosidentifikimin e devijimeve dhe pamundësinë për të marrë masa korrigjuese në kohë.	I mesëm	A është kryer monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të politikave të moshimit të popullsisë?

## 4.2 Objektivat e auditimit


Auditimi me temë “*Planet gjithëpërfshirëse të qeverisë dhe aspektet buxhetore për një popullsi në moshim*” kishte si objektiv kryesor vlerësimin e politikave, strategjive, planeve të vendit tonë që adresojnë çështjet, sfidat dhe problemet që lidhen me fenomenin e moshimit të popullsisë.

Ky vlerësim u realizua duke u fokusuar kryesisht në rolin dhe përgjegjësitë që subjektet nën auditim kanë për realizimin e objektivave të tyre institucionale dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni. Në këtë mënyrë grupi i auditimit u përpoq të sigurojë një vlerësim të paanshëm dhe objektiv të institucioneve të përfshira në auditim në drejtim të:

- Vlerësimin nëse vendi ynë ka një plan gjithëpërfshirës që adreson çështjet e moshimit të popullsisë, apo ka plane të ndryshme sektoriale që adresojnë këtë fenomen;
- Vlerësimin e zbatimit të objektivave të vendosura, si dhe monitorimin e progresit të bërë;

- Vlerësimin e politikave, objektivave apo planeve që adresojnë moshimin e popullsisë në terma afatgjatë dhe sa janë bazuar ato, në të dhëna apo në treguesit e moshimit të popullsisë;
- Vlerësimin e planifikimit të burimeve financiare për mbështetjen e politikave, objektivave apo planeve që adresojnë çështjet e moshimit të popullsisë;
- Vlerësimin e koordinimit dhe bashkëpunimit midis institucioneve përgjegjëse për të siguruar arritjen e objektivave.

### 4.3 Pyetjet e auditimit



#### **4.4 Fushëveprimi i auditimit**

Auditimi me temë “*Planet gjithëpërfshirëse të qeverisë dhe aspektet buxhetore për një popullsi në moshim*” vlerësoi hartimin dhe zbatimin e politikave, strategjive apo planeve që adresojnë fenomenin e moshimit të popullsisë në vendin tonë.

Auditimi u zhvillua në institucionet që kanë përgjegjësi për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave kombëtare për moshimin e popullsisë, konkretisht në Ministrinë e Financave, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, Institutin e Statistikave dhe në Shërbimin Social Shtetëror.

Periodha nën auditim ishte 2020-2025.

#### **5. Shtjellimi i pyetjeve të auditimit**

**Pyetja kryesore – A sigurojnë politikat kombëtare mbështetje gjithëpërfshirëse për të përballuar sfidat e një popullsie në moshim?**

##### **Mesazhi i auditimit**


*Shqipëria nuk ka një plan gjithëpërfshirës dhe ndërsektorial që trajton fenomenin e moshimit të popullsisë. Ky fenomen adresohet në strategji apo plane sektoriale të cilat në vetvete nuk ofrojnë një mbështetje të plotë, të koordinuar dhe gjithëpërfshirëse për çështjet e moshimit të popullsisë. Politikat sektoriale të ndërmarra deri më tani nga institucionet përgjegjëse në tërësinë e tyre, nuk kanë sjellë ndikim në përmirësimin e treguesve, pasi vendi ynë vijon të ketë rënie të lindshmërisë me afërsisht 72% nga viti 1990 në vitin 2024, bilanc migrator negativ me migrim neto nga -15,030 persona në vitin 2018, në -32,497 në vitin 2022, si dhe rritje të moshës mediane nga 32.6 vjeç në vitin 2011 në 44.3 vjeç në vitin 2025.*

*Duke iu referuar treguesve të analizuar është e nevojshme që të hartohen dhe të zbatohen politika të drejtpërdrejta në perspektivë afatgjatë, duke pranuar se ndryshimet në politikat e punësimit, lindshmërisë, migracionit, mbrojtjes sociale dhe zhvillimit ekonomik duhen dekada që të kenë një efekt të qëndrueshëm në shoqëri.*

#### **Struktura demografike e Shqipërisë**

Popullsia e Shqipërisë po përballet me tkurrje të normave të rritjes natyrale e cila vjen si rezultat i uljes së numrit të lindjeve dhe emigracionit të lartë. Të dhënat demografike të marra nga INSTAT dhe të përpunuara nga grupi i auditimit tregojnë se në vitin 2024 është regjistruar numri më i ulët i lindjeve duke filluar që nga viti 1990. Koncretisht, në vitin 2024 në vendin tonë janë regjistruar rreth 23,310 lindje duke vijuar një trend rënës që ka disa vite që ndodh.


Figura nr.1: Numri i lindjeve në Shqipëri për periudhën 1990-2025



Burimi i të dhënave: INSTAT, përpunoi grupi i auditimit.

Shtesa natyrore e popullsisë, gjithashtu është një tjetër tregues i rëndësishëm demografik e cila përfaqëson diferencën midis lindjeve dhe vdekjeve. Ky tregues është një faktor i rëndësishëm që tregon për dinamikën demografike, pasi na informon nëse popullsia po rritet apo po tkurret në mënyrë natyrore, pa marrë parasysh emigracionin. Shtesa natyrore e popullsisë është pozitive nëse numri i lindjeve tejkalon atë të vdekjeve. Nëse ndodh e kundërta, kemi një shtesë natyrore negative e cila tregon për një tkurrje të popullsisë.

Figura nr.2: Shtesa natyrore e popullsisë në Shqipëri për periudhën 1990-2025



Burimi i të dhënave: INSTAT, përpunoi grupi i auditimit.

Sikurse mund të konstatohet edhe nga grafiku shtesa natyrore e popullsisë është në trend rënës në më shumë se tre dekada. Për shembull, vetëm në 10 vjeçarin e fundit kemi një rënie të shtesës natyrore me afërsisht 88.3%, nga 10,297 në vitin 2015 në 1,208 në vitin 2024.




Sipas Censurit të vitit 2023, popullsia banuese në Republikën e Shqipërisë më 18 shtator 2023 rezultoi 2.402.113 banorë, duke shënuar një ulje prej rreth 420 mijë personash krahasuar me Censin e vitit 2011. Ky reduktim i numrit të banorëve ndjek trendin e vazhdueshëm të rënies demografike që ka filluar që prej viteve 1990, si pasojë kryesisht e emigracionit.

Rreth një e treta e popullsisë shqiptare (31,6%) jeton në qarkun e Tiranës, duke e konfirmuar atë si zonën më të populluar të vendit.

Sipas Censit 2023, emigracioni masiv dhe ulja e lindshmërisë u bënë faktorët kryesorë të tkurrjes demografike. Vetëm gjatë viteve 2001 - 2011, rreth 500 mijë qytetarë emigruan nga vendi, me një mesatare prej 50 mijë personash në vit, trend ky që ka vijuar në mënyrë të ngjashme edhe më pas.

Gjatë periudhës 2011 - 2025 moshë mediane<sup>21</sup> në Shqipëri ka shënuar një rritje, nga rreth 32.6 vjeç në vitin 2011 në 38.8 vjeç në vitin 2023 dhe me një rritje akoma edhe më të shpejtë në vitet 2024 dhe 2025, respektivisht 43.5 dhe 44.3 vjeç. Ky trend reflekton kombinimin e fertilitetit të ulët<sup>22</sup>, emigracionit të konsiderueshëm të të rinjve, përmirësimit të shëndetit dhe rritjes së jetëgjatësisë. Këto faktorë ndikojnë në uljen e popullsisë së re dhe në rritjen e peshës së grupeve të moshës së mesme apo të të moshuarve.

Figura nr.3: Moshë mediane në Shqipëri 2011 - 2025<sup>23</sup>



Burimi i të dhënave: Baza e të dhënave INSTAT dhe publikimi i INSTAT – Popullsia e Shqipërisë, 1 janar 2025, punoi grupi i auditimit.

### Mbi tregun e punës

Tregu i punës përfaqëson një nga treguesit kryesorë të zhvillimit ekonomik dhe social të një vendi. Të dhënat e grafikut më poshtë tregojnë se shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës në


<sup>21</sup> Moshë mediane është moshë që ndan popullsinë në dy pjesë të barabarta: 50% e popullsisë është më e re se kjo moshë; 50% e popullsisë është më e vjetër se kjo moshë. Ky tregues evidenton strukturën demografike të një vendi, për të kuptuar nëse popullsia po plakët apo jo.

<sup>22</sup> Numri mesatar i lindjeve për grua ka rënë ndjeshëm gjatë dekadës së fundit. Të dhënat zyrtare nga Eurostat tregojnë se norma e lindshmërisë në Shqipëri ishte 1.71 fëmijë për grua më 2012 dhe në vitin 2023 zbriti në 1,21 fëmijë për grua, ndërsa norma e BE-së është 1.38 lindje për grua në vitin 2023.

<sup>23</sup> [https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST/START\\_DE/POP03/table/tableViewLayout1/](https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST/START_DE/POP03/table/tableViewLayout1/)  
Publikimi i INSTAT – Popullsia e Shqipërisë, 1 janar 2025. <https://www.instat.gov.al/en/themes/demography-and-social-indicators/population/>

Shqipëri ka qenë relativisht e qëndrueshme, duke lëvizur nga 75,4% në fillim të vitit 2023 në 76,2% në mesin e vitit 2025.


Figura nr. 4: Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës sipas grupmoshave.



Burimi: INSTAT

Për grupmoshën 25-54 vjeç, që përfaqëson bazën kryesore të fuqisë punëtore, shkalla e pjesëmarrjes është dukshëm më e lartë dhe ka ndjekur një trend rritës të qëndrueshëm, nga 83,0% në vitin 2021 në 87,7% në vitin 2024. Kjo tregon një përfshirje të lartë të kësaj grupmoshe në tregun e punës dhe një stabilitet në aktivitetin ekonomik të popullsisë aktive.

74,8% 87,7%



55-64 vjeç 25-54 vjeç

2024

Në krahasim me këtë grupmoshë, pjesëmarrja e moshës 55-64 vjeç është më e ulët, por gjithsesi ka njohur rritje të ndjeshme nga 64,6% në vitin 2021 në rreth 75% në vitin 2024.

Ndërsa për grupmoshën 65+, pjesëmarrja mbetet shumë më e ulët, por me rritje graduale nga 15,1% në vitin 2021 në 25,1% në vitin 2024.

#### **Mbi politikat që adresojnë fenomenin e plakjes së popullsisë**

Fenomeni i moshimit të popullsisë adresohet direkt apo indirekt nga vendi ynë nëpërmjet një qasjeje strategjike sektoriale dhe ndërsektoriale të lidhura me SKZHIE<sup>24</sup>-në, duke e përfshirë atë në:

<sup>24</sup> Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2022 – 2030, është dokumenti kryesor strategjik i zhvillimit socio - ekonomik të Shqipërisë dhe përcakton vizionin afatgjatë për zhvillim të qëndrueshëm dhe integrim në BE.



- **Strategjia e Punësimit dhe Aftësive 2023-2030**, e cila ka si vizion “Punësim cilësor dhe aftësim gjatë gjithë jetës për të gjithë”. Ajo fokusohet në zhvillimin e aftësive, përmirësimin e përputhjes mes ofertës dhe kërkesës në tregun e punës, rritjen e përfshirjes së grave dhe personave me aftësi të kufizuara, si dhe transformimin digjital të shërbimeve të punësimit. Kjo strategji kontribuon në menaxhimin e sfidave të plakjes së popullsisë duke nxitur punësimin e brezave aktivë, krijimin e mundësive për grupet e cënueshme që të mbeten ekonomikisht aktivë, si dhe nxitjen e të rinjve në tregun e punës nëpërmjet garancisë rinore.
- **Strategjia Kombëtare e Rinisë dhe Plani i Veprimit 2022-2029**, qëllimi i së cilës është të vendosë të rinjtë në qendër të zhvillimit social dhe ekonomik të vendit, duke krijuar mundësi reale për përfshirjen, aktivizimin dhe fuqizimin e tyre. Strategjia synon të garantojë që të rinjtë të kenë qasje më të mirë në arsim cilësor, punësim të denjë, pjesëmarrje aktive në vendimmarrje dhe mbështetje për nisma inovative, kulturore e sportive. Ajo ka për qëllim të sigurojë që investimet në rini të kthehen në zhvillim të qëndrueshëm për vendin, duke e bërë rininë një forcë aktive të ndryshimit pozitiv dhe integritimit evropian të Shqipërisë.
- **Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2024-2030**, është dokumentet kryesore që drejtojnë politikat publike për zbutjen e varfërisë, përfshirjen sociale, përmirësimin e cilësisë së jetës dhe kujdesin ndaj personave të moshuar. Për këtë arsye, grupi i auditimit zgjodhi t’i analizojë këto strategji si pjesë e planeve gjithëpërfshirëse në kushtet e një popullsie që po plakët.
- **Dokumenti Politik Kombëtar për Moshimin dhe Plani i Veprimit në zbatim të tij 2020-2024**, i cili përcakton drejtimet strategjike dhe masat konkrete për përmirësimin e cilësisë së jetës së të moshuarve, duke u fokusuar në mbështetjen shëndetësore, sociale dhe përfshirjen aktive të tyre në shoqëri. Dokumenti është thelbësor për vlerësimin e planeve gjithëpërfshirëse për një popullsi në moshim, pasi mat nivelin e gatishmërisë institucionale për të garantuar shërbime dhe politika të qëndrueshme në një kontekst ku grupmosha e të moshuarve po rritet me ritme të shpejta.
- **Strategjia Kombëtare për Migracionin 2024 – 2030**, qëllimi kryesor i është të sigurojë qeverisje efektive të migracionit, duke menaxhuar në mënyrë gjithëpërfshirëse lëvizjet migratore, dhe në të njëjtën kohë të maksimizojë ndikimin pozitiv të migracionit në zhvillimin socio-ekonomik të vendit, si dhe të promovojë migracionin të rregullt, të mbrojtë të drejtat e migrantëve.

Politikat dhe objektivat sipas strategjive të përzgjedhura për vlerësim dhe analizë nga grupi i auditimit, janë:

**Në Strategjinë e Punësimit dhe Aftësive 2023 – 2030**, objektivat e përzgjedhur janë:

- Politika 1, e cila ka si qëllim zhvillimin e aftësive dhe lidhje më e mirë e kërkesës me ofertën në tregun e punës për më shumë punësim. Në këtë politikë kemi përzgjedhur 2 objektiva të cilët janë: “Funksionimi më i mirë i tregut të punës për të gjithë” dhe “Rritja e nivelit të aftësive të grave dhe burrave në moshë pune”.
- Politika 2, e cila ka si qëllim mundësimin e punësimit të denjë për gra dhe burra nëpërmjet zbatimit të politikave gjithëpërfshirëse të tregut të punës. Objektivi i përzgjedhur në këtë politikë është “Ndërmjetësim më gjithëpërfshirës i punësimit”.

**Në Strategjinë Kombëtare të Rinisë dhe Planin e Veprimit 2022-2029**, objektivat e përzgjedhur janë:

- Pjesëmarrje aktive e të rinjve në shoqëri dhe fuqizimi i tyre për t’u shprehur lirisht.
- Rritje e mundësive për punësim, përmes zhvillimit të aftësive dhe këshillimit të karrierës.
- Përmirësim i mirëqenies fizike, mendore dhe sociale të të rinjve.
- Arsimit dhe inovacion cilësor, që ndihmon në zhvillimin e potencialit të tyre të plotë.
- Siguri dhe përfshirje sociale për të gjithë, veçanërisht për të rinjtë në rrezik.
- Politika rinore të koordinuara dhe të bazuara në fakte, me mekanizma të mirë financiar për zbatim, monitorim dhe vlerësim.

**Në Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024-2030**, objektivat e përzgjedhur janë:

Politika A - Zbutja e varfërisë dhe përmirësimi i jetesës.

- Objektivi specifik A 1 dhe masën prioritare A 1.2, e cila ka si qëllim përmirësimin e riintegritit social-ekonomik të individëve (gra dhe burra) pjesë e skemës së ndihmës ekonomike, përmes lidhjes me punësimin dhe promovimit të ndërmarrjeve sociale.
- Objektivi specifik A3 me qëllim përmirësimin e shenjestrimit të fëmijëve përmes një programi mbrojtje sociale me fokus fëmijët dhe ndjeshmërisë gjinore Në këtë objektivi bën pjesë dhe zbatimi dhe monitorimi i bonusit të bebes për çdo fëmijë të lindur.

**Në Dokumentin Politik Kombëtar për Moshimin dhe Planin e Veprimit 2020-2024**, objektivat e përzgjedhur janë:

- Objektivi për krijimin e mjediseve motivuese në punë për personat para daljes në pension dhe nxitjen e të mësuarit gjatë gjithë jetës.

**5.1 A është miratuar një plan gjithëpërfshirës që adreson fenomenin e moshimit të popullsisë?**

**5.1.1 A i kanë përmbushur institucionet përgjegjëse detyrimet lidhur me zbatimin e politikave të ndryshme që adresojnë moshimin e popullsisë?**

*Shqipëria nuk ka një strategji kombëtare gjithëpërfshirëse për plakjen e popullsisë.*

Në vitin 2021, Komisioni Evropian publikoi “Librin e Gjelbër për Plakjen” (Green paper on Aging)<sup>25</sup>, me qëllim nxitjen e një debati të gjerë mbi sfidat dhe mundësitë që sjell plakja e popullsisë në Bashkimin Evropian. Dokumenti thekson se popullsia në moshë pune po tkurret prej më shumë se një dekade, çka rrezikon mungesën e fuqisë punëtore dhe qëndrueshmërinë e sistemeve të pensioneve, mirëqenies etj. Për këtë arsye, Komisioni propozon politika që rrisin pjesëmarrjen në tregun e punës, zgjasin jetën aktive, nxisin produktivitetin dhe inovacionin, si dhe forcojnë integrimin social të grupeve të ndryshme, përfshirë migrantët dhe personat me aftësi të kufizuara.

<sup>25</sup> [https://commission.europa.eu/system/files/2021-06/green\\_paper\\_ageing\\_2021\\_en.pdf](https://commission.europa.eu/system/files/2021-06/green_paper_ageing_2021_en.pdf)

Shqipëria nuk ka një plan të vetëm kombëtar dhe gjithëpërfshirës që trajton të gjitha aspektet si më sipër. Fenomeni i plakjes demografike adresohet në plane dhe strategji sektoriale dhe ndërsektoriale që prekin aspekte të ndryshme të moshimit aktiv, si:

- Strategjia e Punësimit dhe Aftësive 2023 – 2030;
- Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2019 - 2023 dhe 2024 – 2030;
- Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022 – 2029;
- Dokumenti Politik Kombëtar për Moshimin 2020 - 2024.

*Në këtë drejtim, Ekspertët<sup>26</sup> mbështesin idenë e zhvillimit të një strategjie ndërministrorë për të adresuar sfidat e moshimit. rëndësinë e trajtimit të moshimit dhe çështjeve demografike si prioritet në agjendën kombëtare, për të garantuar zhvillim të qëndrueshëm dhe një shoqëri gjithëpërfshirëse.*

Në këtë kuadër, grupi i auditimit vlerësoi masat dhe politikat e institucioneve përgjegjëse, duke analizuar nëse ato kontribuojnë në rritjen e pjesëmarrjes në tregun e punës, zgjatjen e jetës aktive dhe forcimin e kapaciteteve në të gjitha grupmoshat.

### **Vlerësimi i Zbatimit të Objektivave të Strategjisë së Punësimit dhe Aftësive 2023 - 2030**

Politika 1 e Strategjisë së Punësimit dhe Aftësive ka si qëllim kryesor *sigurimin e punësimit cilësor dhe zhvillimin e aftësive gjatë gjithë jetës*. Ky qëllim pritet të arrihet përmes disa objektivave specifikë, ndër të cilët grupi i auditimit ka analizuar:

- **Objektivi 1.2 – Rritja e nivelit të aftësive të grave dhe burrave në moshë pune.**  
Ky objektivi synohet të realizohet përmes masave prioritare si: nxitja e mundësive gjithëpërfshirëse për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe përshtatja e ofertës së formimit sipas nevojave të të rriturve.
- **Objektivi 1.3 – Përmirësimi i funksionimit të tregut të punës për të gjithë.**  
Ky objektivi përfshin masa prioritare si:
  - transformimi digjital i shërbimeve të punësimit dhe sistemit të arsimit dhe formimit profesional (AFP);
  - krijimi i një sistemi të inteligjencës së aftësive që prodhon sinjale të rregullta mbi kërkesën dhe ofertën në tregun e punës;
  - konsolidimi dhe zgjerimi i shërbimeve për punëkërkuarit dhe punëdhënësit, duke i përshtatur në mënyrë të vazhdueshme mbi bazën e praktikave të monitorimit dhe vlerësimit;
  - lehtësimi i lëvizshmërisë së fuqisë punëtore brenda dhe jashtë vendit.

Përgjegjës për realizimin e ndërhyrjeve, si dhe afatet për realizimin, janë të pasqyruara në Aneksin nr. 4

### ***Institucionet nuk kanë kryer vlerësimin e plotë të nevojave të të rriturve për arsim dhe trajnim.***

Objektivi 1.2 – *Rritja e nivelit të aftësive të grave dhe burrave në moshë pune*, synohet të realizohet përmes masave prioritare si: nxitja e mundësive gjithëpërfshirëse për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe përshtatja e ofertës së formimit sipas nevojave të të rriturve.

Sipas Progres-Raportit të Strategjisë së Punësimit dhe Aftësive 2023-2030, për vitin 2024, të siguruar nga MEI, janë evidentuar disa arritje që lidhen kryesisht me iniciativën të mbështeturë nga partnerët ndërkombëtarë. Në drejtim të fleksibilitetit të arsimit, United Nations Children’s Fund (UNICEF) dhe United Nations Development Programme (UNDP), në bashkëpunim me MEI dhe MAS, kanë kryer një vlerësim të politikave të arsimit parauniversitar me synimin për të rritur mundësitë e tranzicionit drejt Arsimit dhe Formimit Profesional dhe për të mbështetur

<sup>26</sup> <https://albania.unfpa.org/sq/news/workshop-mbi-demografin%C3%AB-dhe-moshimin-prioritete-dhe-sfida-p%C3%ABr-shqip%C3%ABrin%C3%AB>

ri-angazhimin e të rinjve në sistemin arsimor. Gjithashtu, gjatë vitit 2024 janë realizuar nisma të rëndësishme për zhvillimin e aftësive digjitale dhe të gjelbra. Shoqata RisiAlbania ka kryer një studim të detajuar për aftësitë e kërkuara në sektorin e turizmit, ndërsa me mbështetjen e The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) janë trajnuar 80 të rinj dhe 23 instruktorë në aftësi të gjelbra, duke u zhvilluar 16 module të reja trajnimi. Paralelisht, Programi i Kodimit ka vijuar mbështetjen për rikualifikimin digjital të të rriturve, duke kontribuar në përshtatjen e aftësive me kërkesat e tregut të punës.

RisiAlbania ka nisur një fushatë sensibilizuese mbarëkombëtare për promovimin e karrierës dhe të nxënimit gjatë gjithë jetës. Në fushën e orientimit profesional, janë bërë përparime të dukshme me ngritjen e katër zyrave komunitare të karrierës dhe me hartimin e udhëzuesit për koordinatorët e karrierës në institucionet AFP. Gjithashtu, është aktivizuar rrjeti AFPro Professionals' Network, i cili krijon një platformë bashkëpunimi ndërmjet shkollave profesionale, bizneseve, mësuesve dhe nxënësve.

Sa më sipër, pavarësisht këtyre arritjeve, grupi i auditimit vlerëson se rezultatet e raportuara janë të lidhura kryesisht me projekte të financuara nga partnerët ndërkombëtarë, ndërkohë që disa nga masat thelbësore të parashikuara në Strategji për vitin 2024 nuk janë realizuar. Së pari, INSTAT, MEI, AKPA dhe AKAFPK nuk kanë kryer vlerësimin kombëtar të nevojave të të rriturve për arsim dhe trajnim, një ndërhyrje e parashikuar të përfundonte brenda vitit 2024. Mungesa e këtij vlerësimi cenon aftësinë për të hartuar politika të bazuara në evidencë dhe pengon përshtatjen e programeve të të nxënimit me kërkesat reale të tregut të punës. Së dyti, nuk ka asnjë të dhënë në progres-raport për realizimin e studimit të fizibilitetit dhe roadmap-it për mikrokredencialet<sup>27</sup>, një masë e rëndësishme për përafrimin me rekomandimet e BE-së dhe ofrimin e rrugëve fleksibile të të nxënimit. Nga ana tjetër, të dhënat e raportuara në Progres Raportin e strategjisë tregojnë se në vitin 2024 ka pasur një ulje të pjesëmarrjes së të rriturve në trajnim, nga 16,428 persona në vitin 2023 në 12,830 gjatë vitit 2024. Ky trend tregon se masat për nxitjen e të nxënimit gjatë gjithë jetës nuk kanë arritur të ruajnë nivelin e përfshirjes së popullsisë në moshë pune. Në përfundim, ndonëse disa nisma pozitive janë realizuar, masat që duhej të fillonin ose të përfundonin brenda vitit 2024 nuk janë zbatuar plotësisht, duke bërë që realizimi i Objektivit 1.2 të mbetet i pjesshëm.

***Objektivi për funksionimin më të mirë të tregut të punës nuk është realizuar plotësisht.***

➤ Objektivi 1.3 – *Përmirësimi i funksionimit të tregut të punës për të gjithë*, synon të realizohet nëpërmjet masave prioritare si:

- transformimi digjital i shërbimeve të punësimit dhe sistemit të arsimit dhe formimit profesional (AFP);
- krijimi i një sistemi të inteligjencës së aftësive që prodhon sinjale të rregullta mbi kërkesën dhe ofertën në tregun e punës;
- konsolidimi dhe zgjerimi i shërbimeve për punëkërkuarit dhe punëdhënësit, duke i përshtatur në mënyrë të vazhdueshme mbi bazën e praktikave të monitorimit dhe vlerësimit;
- lehtësimi i lëvizshmërisë së fuqisë punëtore brenda dhe jashtë vendit.

Mbështetur nga të dhënat e Progres Raportit të strategjisë për vitin 2024, AKPA ka vijuar përmirësimin e portalit “puna.gov.al”<sup>28</sup> dhe ka ndërmarrë hapa për transformimin digjital të shërbimeve për punëkërkuarit, rritjen e përdorimit të platformave digjitale të AFP-së (MësoVet); zhvillimin e materialeve digjitale mësimore; prodhimin e 12 analizave rajonale të tregut të punës. Po ashtu, gjatë vitit 2024, MEI dhe AKPA nisën dy vlerësime të rëndësishme për identifikimin e mospërputhjeve të aftësive: Analizën e Nevojave për Aftësi 2024 dhe vlerësimin e ndikimit të digjitalizimit në sektorët prioritarë të turizmit, energjisë dhe TIK-ut.

<sup>27</sup> Mikrokredencialet janë kualifikime të pjesshme që certifikojnë kompetenca specifike të fituara përmes programeve të shkurtra të të nxënimit gjatë gjithë jetës.

<sup>28</sup> <https://www.puna.gov.al/>

Analiza e Nevojave për Aftësi, do të vlerësojë mungesat e aftësive, sfidat e rekrutimit dhe marrëdhëniet ndërmarrje-institucione, bazuar në një kampion prej 2,880 ndërmarrjesh nga i gjithë vendi. Rezultatet e së cilës priten të dalin në 2025.

Gjithashtu, janë ndërmarrë masa të synuara për të pajisur punëkërkuarit me aftësitë digjitale dhe të buta të domosdoshme. Programi kombëtar “Aftësitë Digjitale”, i zbatuar në të gjitha qendrat e formimit profesional, ka trajnuar 1,756 punëkërkuar (përfshirë 1,667 të papunë të regjistruar). Paralelisht, AKPA ka operacionalizuar një program të avancuar për kodim, duke ofruar trajnime në fusha shumë të kërkuara të TI-së si programimi, siguria kibernetike dhe robotika. Kjo nismë, e mbështetur nga subvencione publike, ka arritur 845 pjesëmarrës gjatë vitit 2024 dhe ka kontribuar në përmirësimin e aftësive të fuqisë punëtore për një treg pune gjithnjë e më të digjitalizuar.

Grupi i auditimit konstaton se, pavarësisht se janë bërë përpjekje të rëndësishme në zbatimin e masave të objektivit 1.3, nga të dhënat e raportuara në progres raport, tregon se, edhe pse ka shumë vende të lira të raportuara (61,624 në 2024), vetëm 7,303 ndërmjetësime janë realizuar. Kjo tregon se edhe pse sistemi digjitalizuar (si puna.gov.al), ndërmjetësimet kanë rënë nga 12,088 në 2023 - 7,303 në 2024.

Shifrat e vitit 2024 nënkuptojnë se objektivi për funksionimin më të mirë të tregut të punës nuk është realizuar plotësisht.

***Politika 2, mbi nxitjen e punësimit të denjë për gratë dhe burrat përmes zbatimit të politikave gjithëpërfshirëse të tregut të punës, në Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, për vitin 2024, ka objektiva pjesërisht të arritura.***

Objektivi Strategjik 2.1 synon të sigurojë një sistem shërbimesh punësimi që ofron ndërmjetësim efektiv dhe programe gjithëpërfshirëse për të gjitha grupet vulnerabël. Ky objektivi është përzgjedhur sepse lidhet drejtpërdrejt me krijimin e një tregu pune gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm. Analiza e treguesve për periudhën 2022-2024 tregon progres në disa masa, por gjithashtu evidenton një sërë mangësish mes objektivave strategjike dhe rezultateve të arritura, duke çuar në përfundimin se zbatimi mbetet i pjesshëm.

Konkretisht, mbi përfshirjen e grupeve vulnerabël në programet e nxënies së punësimit, paraqitet si në tabelën më poshtë:

*Tabela nr. 4: Pjesëmarrja në programet e nxitjes së punësimit të ndarë sipas kategorive.*

Treguesi	2022	2023	2024	Analizë
<b>Totali i pjesëmarrësve</b>	4,344	2,635	2,465	Rënie e vazhdueshme
<b>Nga ndihma ekonomike</b>	692 (16%)	494 (19%)	618 (25%)	Përqindja rritet, por numri mbetet i ulët krahasuar me vitin 2022.
<b>Romë &amp; Egjiptianë</b>	304 (7%)	194 (7%)	303 (12%)	Përmirësim në 2024

*Burimi: MEI, Raport Progresi 2024*

*Punoi: Grupi i auditimit*

Për sa i përket pjesëmarrjes në trajnimin profesional, nga grupet specifike të ndarë në bazë të kategorive të ndryshme (nga niveli i tretë, përfituesit e ndihmës ekonomike, grupet etnike, etj.), rezultatet dhe analiza paraqitet si në tabelën më poshtë.

*Tabela nr. 5: Pjesëmarrja në trajnim profesional*

Kategoria	2022	2023	2024	Analizë
<b>Afatgjatë të papunë</b>	786	TBD	-	Mungesë raportimi në 2023-2024, pamundëson matjen e progresit
<b>Përfitues të ndihmës ekonomike</b>	768	842	-	Rritje në 2023, por mungesë të dhënash në 2024
<b>Romë &amp; Egjiptianë</b>	255	228	-	Rënie në 2023, dhe mungesë të dhënash në 2024

*Burimi: MEI, Raport Progresi 2024*

*Punoi: Grupi i auditimit*

Mbi punësimin e grupeve vulnerabël, rezultatet paraqiten si më poshtë:

*Tabela nr. 6: Punësimi i grupeve vulnerabil*

Grupet	2022	2023	2024	Analizë
<b>Punësime totale</b>	26,794	27,657	27,497	Nivel i qëndrueshëm
<b>Nga ndihma ekonomike</b>	1,785 (7%)	2,820 (10%)	2,211 (8%)	Rritje në 2023, rënie në 2024
<b>Romë &amp; Egjiptianë</b>	497 (2%)	1,032 (4%)	1,086 (4%)	Rritje në 2023-2024

*Burimi: MEI, Raport Progresi 2024*

*Punoi: Grupi i auditimit*

Bazuar në Progres Raportin e vitit 2024, vlerësimi i masës prioritare 2.1.1 tregon një ecuri të konsiderueshme në disa ndërhyrje kyçe (ndërhyrjet e paraqitura në Aneksin nr. 1) të parashikuara për t'u realizuar deri në fund të vitit 2024, veçanërisht ato që lidhen me ngritjen e modeleve të reja të shërbimeve, pilotimin e partneriteteve dhe forcimin e kapaciteteve institucionale në nivel lokal.

Gjatë vitit 2024 është finalizuar modeli për menaxhimin e specializuar të rasteve për grupet vulnerabël dhe modeli i bashkëpunimit me OJF-të, i cili u konkretizua me VKM. Ky model ka nisur të pilotohet në 19 bashki, ndërsa është zhvilluar procesi i konkurrimit dhe përzgjedhja e 12 projekteve që do të zbatohen nga viti 2025. Sipas raport-progresit zbatimi i tyre aktiviteve ka qenë kryesisht në fazë pilotimi dhe ende nuk është shtrirë plotësisht në nivel kombëtar.

Megjithatë, Progres Raporti dhe të dhënat statistikore (si në tabelat më sipër) nxjerrin në pah disa sfida që tregojnë se jo të gjitha ndërhyrjet e parashikuara kanë arritur të përkthehen në rezultate të matshme deri në fund të vitit 2024. Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën nr.4 më sipër, pjesëmarrja në programet e nxitjes së punësimit ka pësuar rënie të vazhdueshme nga viti 2022 në 2024, duke u ulur nga 4,344 në 2,465 pjesëmarrës. Pjesëmarrja në trajnimet profesionale shfaq një boshllëk të të dhënave për vitin 2023 dhe 2024, duke pamundësuar vlerësimin e ndikimit të ndërhyrjeve që synojnë aftësimin e punëkërkesve vulnerabël. Punësimi i këtij grupi paraqet një situatë më të qëndrueshme, por edhe këtu shihen sinjale të dobësimit për përfituesit e ndihmës ekonomike, ndërsa komunitetet Romë dhe Egjiptianë tregojnë një trend pozitiv për dy vite radhazi.

### ***Portali i Garancisë Rinore nuk ka të dhëna mbi arritjet e suksesit.***

Në objektivin specifik 2.1.2. “Tranzicion i mbështetur dhe gjithëpërfshirës nga shkolla në punë për të rinjtë (NEET) nëpërmjet zbatimit të skemës së Garancisë Rinore”, një ndër ndërhyrjet është zgjerimi i sistemit të menaxhimit të informacionit të tregut të punës për të gjurmuar rrugëtimin e të rinjve NEET para, gjatë dhe pas përfshirjes në skemën e Garancisë Rinore. Garancia Rinore është një program që synon të sigurojë që çdo i ri, brenda një periudhe të caktuar pas regjistrimit si i papunë ose pas përfundimit të arsimit, të marrë një ofertë konkrete për punësim, arsim të mëtejshëm, trajnim profesional ose praktikë pune.

Nga të dhënat e marra gjatë auditimit nga AKPA, që nga nisja e fazës pilot në nëntor 2023 deri në shkurt 2025, rezulton se janë dorëzuar 1,932 aplikime, 1,252 të rinj janë përfshirë në skemë, dhe 840 kanë dalë me rezultat pozitiv (474 janë punësuar, 244 kanë ndjekur arsim ose trajnim profesional, dhe 122 janë përfshirë në praktika profesionale).

Megjithatë, këto të dhëna operative nuk pasqyrohen në portalin zyrtar të Garancisë Rinore, i cili është krijuar posaçërisht për të lehtësuar aksesin, informimin dhe komunikimin me të rinjtë. Në mungesë të publikimit të rregullt dhe gjithëpërfshirës të treguesve të rezultateve, institucionet nuk arrijnë të sigurojnë një qasje të bazuar në evidenca, çka është e domosdoshme për krijimin e besueshmërisë nga moshat e reja në institucionet shtetërore.

***Objektivi i vendosur në Dokumentin Politik Kombëtar për Moshimin 2020-2024<sup>29</sup>, për krijimin e mjediseve motivuese në punë për personat para daljes në pension dhe nxitjen e të mësuarit gjatë gjithë jetës nuk është realizuar plotësisht.***

Sipas Planit Kombëtar të Veprimit mbi Moshimin 2020–2024, objektivi specifik 4, i politikës 1 përcakton: “Të sigurojmë mjedise motivuese në punë për personat para daljes së tyre në pension dhe të nxisim të mësuarit gjatë gjithë jetës.” Ky objektivi synon që procesi i daljes në pension të mos jetë i menjëhershëm dhe i detyruar, por i shoqëruar me mundësi për vazhdimin e punës në forma fleksibël, sipas nevojave të individit dhe interesave të punëdhënësit. Gjithashtu, parashikon krijimin e mundësive për të mësuar gjatë gjithë jetës si një mënyrë për të ruajtur aftësitë profesionale, duke ruajtur në këtë mënyrë aftësitë për punë për një kohë të gjatë.

Treguesit e performancës për këtë objektivi përfshijnë:

- zhvillimin e fushatave të përvitshme sensibilizuese mbi punësimin e të moshuarve dhe mosdiskriminimin në punë;
- krijimin e një modeli të “Universitetit të Moshës së Tretë”, me 10 kurrikula të miratuara dhe 1000 pjesëmarrës në aktivitete të të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij objektivi janë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) dhe Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (ish MEKI).

Në lidhje me informimin e publikut mbi moshimin dhe diskriminimin, sipas raportit përfundimtar të dokumentit janë organizuar disa aktivitete sensibilizuese dhe fushata ndërgjegjësuese në datat 1 tetor 2020 dhe 2021 (Dita Ndërkombëtare e të Moshuarve) dhe 15 qershor (Dita Ndërkombëtare kundër abuzimit me të moshuarit) 2020 dhe 2022. Në këto aktivitete kanë marrë pjesë përfaqësues të MSHMS, Avokatit të Popullit, bashkisë Tiranë, ISHP dhe organizatave të shoqërisë civile. Grupi i auditimit konstaton se fushatat kanë një shtirje gjeografike të kufizuar, kryesisht në bashkinë Tiranë.

Lidhur me kurset e përgatitura, MSHMS ka zhvilluar disa takime të përbashkëta me përfaqësues të moshës së tretë dhe përfaqësues të punëdhënësve, me qëllim diskutimin e problematikave që dalin përpara punëdhënësve dhe punëmarrësve me largimin e tyre për shkak të plotësisht të moshës për të dalë në pension dhe mundësitë për vazhdimin me kohë të pjesshme apo zgjatjen e mundësive për vazhdimin e punës pas moshës ligjore të pensionit kur kjo është në interesin e ty dy palëve. Megjithatë, për këto takime nuk ka të dhëna të sakta për numrin e takimeve dhe numrin e pjesëmarrësve siç është shprehur dhe në raportin përfundimtar nga MSHMS.

Nuk ka baza të dhënash që të evidentojë numrin e personave që vijnë në punë pas moshës së pensionit apo që përfitojnë nga mundësitë e tranzicionit fleksibël. Për rrjedhojë, mungon një panoramë e qartë mbi përfshirjen e të moshuarve në tregun e punës dhe masat që mund të lehtësojnë këtë proces.

Sipas të dhënave në raportin përfundimtar të dokumentit, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA), çdo vit në Qendrën e Formimit Profesional nr. 4 ka zhvilluar kurse për kujdestari për të moshuar, të cilat ndjekin mesatarisht 35-40 persona, kryesisht kujdestarë të moshës 65+. Po ashtu, gjatë periudhës 2022 janë organizuar disa kurse formimi profesional nga AKPA në fusha të tilla si administrim pallati, rrobaqepësi, kuzhinë dhe gjuhë të huaj për të moshuarit. Nga të dhënat për vitin 2022 rezulton se vetëm 16 të moshuar mbi moshën 65 vjeç kanë marrë pjesë në këto kurse.

Grupi i auditimit konstaton se modeli i parashikuar i “Universitetit të Moshës së Tretë” nuk është ngritur, po ashtu asnjë nga 10 kurrikulat e planifikuara nuk rezultojnë të jenë miratuar. Mungesa e zbatimit të plotë të objektivit për krijimin e mjediseve motivuese në punë dhe të

<sup>29</sup> Miratuar me Vendimin nr. 864, datë 24.12.2019.

mundësive për të mësuarit gjatë gjithë jetës ka kufizuar efektivitetin e politikave për përfshirjen aktive të personave të moshuar në tregun e punës dhe nuk ka mundësuar shfrytëzimin e potencialit të tyre profesional dhe social.

**1. Gjetje nga auditimi:** Strategjia e Punësimit dhe Aftësive synon të sigurojë punësim cilësor dhe zhvillim të aftësive gjatë gjithë jetës përmes disa objektivave kryesorë, si: rritja e nivelit të aftësive të grave dhe burrave në moshë pune; përmirësimi i funksionimit të tregut të punës për të gjithë; si dhe forcimi i shërbimeve dhe mekanizmave që mbështesin një treg pune më efektiv dhe gjithëpërfshirës. Në këtë kuadër, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, si institucioni përgjegjës për koordinimin e politikave të punësimit dhe aftësive dhe për drejtimin e institucioneve zbatuese në varësi të saj, ka rol kyç në planifikimin, financimin, monitorimin dhe sigurimin e zbatimit të ndërhyrjeve të parashikuara në strategji.

Auditimi konstatoi se disa nga ndërhyrjet e planifikuara për vitin 2024 nuk rezultojnë të realizuara. Konkretisht, nuk ka evidencë për përfundimin e vlerësimit kombëtar të nevojave të të rriturve për aftësi, si dhe të studimit të fizibilitetit për mikrokredencialet, të cilat janë kualifikime të pjesshme, fleksibile dhe afatshkurtra që certifikojnë kompetenca specifike profesionale dhe që synojnë të mbështesin përditësimin e vazhdueshëm të aftësive të fuqisë punëtore. Këto aktivitete duhej të realizoheshin nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive si institucione pjesëmarrëse.

Ndërkohë, rezultatet tregojnë se, pjesëmarrja e të rriturve në trajnim ka rënë nga 16,428 në vitin 2023 në 12,830 në vitin 2024. Po ashtu, numri i ndërmjetësimeve të suksesshme në punë ka rënë nga 12,088 në 2023 në 7,303 në 2024, pavarësisht numrit të lartë të vendeve të lira të shpallura (61,624 në 2024). Kjo situatë vjen si pasoje e mos ndërhyrjeve të drejtpërdrejta institucionale për vlerësime kombëtare me ritmin e planifikuar, si dhe varësinë nga projekte të financuara nga partnerët ndërkombëtarë. Si rezultat, realizimi i objektivave të strategjisë deri në këtë fazë vlerësohet si i pjesshëm.

**2. Gjetje nga auditimi:** Programi i Garancisë Rinore është një program që synon të sigurojë që çdo i ri, brenda një periudhe të caktuar pas regjistrimit si i papunë ose pas përfundimit të arsimit, të marrë një ofertë konkrete për punësim, arsim të mëtejshëm, trajnim profesional ose praktikë pune. Në funksion të rritjes së aksesit dhe transparencës së këtij programi është krijuar Portali i Garancisë Rinore, i cili administrohet nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA) dhe synon të shërbejë si platformë informimi, aplikimi dhe publikimi të rezultateve të programit.

Grupi i auditimit konstatoi se portali zyrtar i Garancisë Rinore nuk pasqyron të dhëna mbi arritjet dhe treguesit kryesorë të performancës së programit. Sipas të dhënave të siguruar nga AKPA, që nga nisja e fazës pilot në nëntor 2023 deri në shkurt 2025 janë dorëzuar 1,932 aplikime, prej të cilave 1,252 të rinj janë përfshirë në program dhe 840 kanë dalë me rezultat pozitiv (474 të punësuar, 244 të përfshirë në arsim ose trajnim profesional dhe 122 në praktika profesionale). Megjithatë, këto të dhëna nuk janë publikuar në portal. Kjo vjen për shkak se portali është ende në përditësim dhe varet nga financimi ndërkombëtar. Mosreflektimi i të dhënave kufizon ndjeshëm funksionin e portalit si mjet i besueshëm informimi dhe rrezikon të ulë besimin e të rinjve në efektivitetin e skemës.

**3. Gjetje nga auditimi:** Sipas Planit Kombëtar të Veprimit mbi Moshimin 2020–2024, objektivi specifik 4 i politikës 1 synon sigurimin e mjediseve motivuese në punë për personat para daljes në pension dhe nxitjen e të mësuarit gjatë gjithë jetës. Përgjegjës për koordinimin e zbatimit të këtij objektivi është Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (MSHMS), në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit. Treguesit e performancës përfshijnë

zhvillimin e fushatave të përvitshme sensibilizuese për punësimin e të moshuarve dhe mosdiskriminimin në punë, si dhe krijimin e modelit të “Universitetit të Moshës së Tretë”, me dhjetë kurrikula të miratuara dhe 1000 pjesëmarrës në aktivitete të të mësuarit gjatë gjithë jetës. Nga verifikimi i dokumentacionit dhe raporteve të zbatimit rezulton se objektivi nuk është zbatuar plotësisht. Fushatat sensibilizuese raportohen si të realizuara në shtrirje të kufizuar gjeografike, kryesisht në Bashkinë Tiranë, dhe jo në mënyrë të përvitshme në nivel kombëtar. Modeli i “Universitetit të Moshës së Tretë” nuk është ngritur dhe asnjë nga dhjetë kurrikulat e planifikuara nuk është miratuar. Edhe pse janë zhvilluar disa kurse formimi profesional nga AKPA, pjesëmarrja ka qenë shumë e ulët (100 persona mbi 65 vjeç nga 1000 të synuar). Si pasojë, zbatimi i aktiviteteve të planifikuara ka qenë i kufizuar, duke ulur efektivitetin e politikave të ndërmarra dhe duke ndikuar negativisht në arritjen e objektivit për nxitjen e të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe integrimin e të moshuarve në tregun e punës.

**1. Konkluzion:** Institucionet përgjegjëse kanë ndërmarrë disa hapa të rëndësishëm për zbatimin e politikave që lidhen me moshimin e popullsisë. Megjithatë, zbatimi i politikave në fushën e punësimit, aftësive dhe përfshirjes sociale ka qenë i pjesshëm, me disa masa pjesërisht të realizuara dhe me tregues që shënojnë rënie. Rezultatet e programit për të rinjtë nuk pasqyrohen në mënyrë të plotë, ndërsa objektivat për përfshirjen e të moshuarve nuk janë arritur.

**1.1 Rekomandimi:** Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit në bashkëpunim me institucionet në varësi të saj, të marrin masa të: (i) realizojnë vlerësimin kombëtar të nevojave të të rriturve për të nxënë gjatë gjithë jetës; (ii) përgatisin dhe zbatojnë studimet e fizibilitetit dhe roadmap-in për mikrokredencialet; (iii) përfshijnë ndërhyrjet e Strategjisë së Punësimit dhe Aftësive në planet vjetore të punës, me qëllim zbatimin e objektivave të strategjisë.

**Brenda vitit 2026**

**2.1 Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive të marrë masa për rritjen e transparencës së portalit të Garancisë Rinore, duke e publikuar në mënyrë të rregullt dhe të përditësuar treguesit kryesorë të progresit të skemës (numrin e aplikimeve, punësimeve, trajnimeve dhe praktikave profesionale), me qëllim që ky portal të ofrojë informacion të besueshëm për të rinjtë.

**Brenda vitit 2026**

**3.1 Rekomandimi:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, të analizojë shkaqet e mosrealizimit të aktiviteteve të Planit Kombëtar të Veprimit mbi Moshimin 2020–2024. Lidhur me zbatimin e objektivave të Dokumentit Politik për Moshimin 2025-2030, të sigurojnë burime të nevojshme dhe mekanizma efektivë monitorimi, me fokus përfshirjen dhe aktivizimin e të moshuarve në tregun e punës, me qëllim shmangien e përsëritjes së mosrealizimit të objektivave në të ardhmen.

**Në vijimësi**

### **5.1.2 A është kryer monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të politikave të moshimit të popullsisë?**

Monitorimi dhe vlerësimi i politikave të lidhura me moshimin e popullsisë përbëjnë një komponent thelbësor të ciklit të politikbërjes, pasi mundësojnë ndjekjen e zbatimit të masave dhe matjen e ndikimit të tyre në kohë. Ky proces siguron informacion të nevojshëm për të kuptuar se në çfarë mase objektivat e përcaktuara në dokumentet strategjike janë përmbushur dhe nëse masat e marra kontribuojnë në arritjen e rezultateve të synuara. Kështu që, analiza

fokusohehet në ekzistencën dhe funksionimin e mekanizmave institucionale të monitorimit dhe raportimit, në qartësinë dhe rregullshmërinë e procesit të mbledhjes dhe analizimit të të dhënave, si dhe në përdorimin e rezultateve të monitorimit për përmirësimin e politikave dhe planifikimin e buxheteve përkatëse. Gjithashtu, shqyrtohet niveli i koordinimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse dhe mënyra se si sigurohet harmonizimi i informacionit që prodhohet në këtë fushë.

Ky vlerësim synon të ofrojë një pasqyrë të përgjithshme mbi mënyrën se si funksionon sistemi i monitorimit dhe vlerësimit të politikave për moshimin e popullsisë, duke evidentuar praktikat ekzistuese dhe shkallën e përputhjes së tyre me kuadrin strategjik dhe ligjor në fuqi. Grupi i auditimit për këtë, ka analizuar nëse mekanizmat për monitorimin dhe vlerësimin e politikave që lidhen me procesin e një popullsie në moshim janë ngritur dhe funksionojnë në përputhje me kornizën strategjike kombëtare. Dokumentet strategjike që përcaktojnë këto mekanizma janë konsideruar si bazë për vlerësimin e përgjegjësive institucionale dhe të nivelit të zbatimit në praktikë.

### **Procesi i Monitorimit të Strategjive të Mbrojtjes Sociale 2019–2023 dhe 2024–2030<sup>30</sup>**

Sipas Strategjisë së Mbrojtjes Sociale 2019–2023, monitorimi është udhëhequr nga Grupi Tematik për Përfshirjen Sociale, i cili funksionon brenda strukturës së Grupit për Menaxhimin e Integruar të Politikave (GMIP), të krijuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 157, datë 22.10.2018, “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”.

Në bazë të këtij dokumenti, monitorimi realizohet çdo vit, ndërsa raportet e monitorimit dhe vlerësimit përkatës duhet të hartohen dhe miratohen në afate 1-vjeçare. Ky proces është thelbësor për të vlerësuar nivelin e realizimit të objektivave strategjike dhe për të garantuar zbatimin efektiv të masave të parashikuara.

Për periudhën objekt auditimi 2020 – 2025, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) ka hartuar katër raporte monitorimi, që lidhen me strategjinë e mëparshme në fuqi (2019 – 2023) dhe një draft- raport monitorimi për Strategjinë e re të Mbrojtjes Sociale 2024 – 2030, si dokument i detajuar për periudhën e monitorimit të vitit 2024.

Monitorimi është konceptuar si një proces vjetor i matjes së progresit drejt objektivave strategjike dhe specifike të strategjisë. MSHMS ka përdorur një matricë vlerësimi, e cila përmban hierarkinë e plotë të qëllimeve nga objektivat strategjike te indikatorët e performancës. Në total, strategjia përfshin 3 objektiva strategjike, 14 objektiva specifike dhe 39 indikatorë.

Të dhënat janë mbledhur përmes raportimeve administrative nga njësitë zbatuese, raporteve të Shërbimit Social Shtetëror dhe analizave të sektorëve përkatës në MSHMS. Për verifikimin e indikatorëve, janë zhvilluar takime periodike ndërmjet tre sektorëve kryesorë të Drejtorisë së Politikave të Mbrojtjes Sociale, me qëllim vlerësimin e zbatueshmërisë së objektivave dhe matjes së progresit

Sipas të dhënave të Progres Raportit të vitit 2023, Objektivi specifik A1 “*Të përmirësohet performanca, përshtatshmëria dhe përgjigjja ndaj krizave e skemave financiare dhe përfitimeve për individët (burra, gra, djem dhe vajza)*”, i cili lidhet dhe me temën e auditimit ka katër indikatorë nga të cilët dy janë arritur plotësisht dhe kryesisht indikatorit 3 (përqindja e shpenzimeve të Ndihmës Ekonomike që shkon për të varfrit) dhe indikatorit 4 (përqindja familjeve përfituese të fondit 6% akorduar bashkive në raport me kërkesat). Indikatorit 2 Numri i familjeve përfituese NE sipas gjinisë është i arritur, dhe indikatorit 1 (Përqindja e popullsisë së varfër ekstreme që marrin NE) janë arritur pjesërisht.

---

<sup>30</sup>Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2019-2023

Tabela nr. 7: Statusi i Realizimit të Indikatorëve (në nr. dhe %) për Objektivin Specifik A1.

Nr.	Statusi	Shprehur në numër	Shprehur në %
1	I arritur plotësisht	2	50 %
2	I arritur	1	25%
3	I arritur pjesërisht	1	25 %
4	I paarritur		
5	I pamatur/Pa Raportuar		
6	Total	4	100%

Në gjykimin e grupit të auditimit monitorimi i Strategjisë së Mbrojtjes Sociale 2019–2023 është zhvilluar mbi një bazë të konsoliduar metodologjike, duke ndjekur standardet e transparencës, matjes dhe raportimit të performancës. Procesi ka qenë i institucionalizuar dhe gjithëpërfshirës, me pjesëmarrjen e aktorëve qendrorë, rajonalë dhe vendorë, dhe ka përdorur instrumente digjitale për mbledhjen dhe verifikimin e të dhënave.

### **Procesi i monitorimit të Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024 – 2030**

Procesi i monitorimit të Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024–2030 është konceptuar si një mekanizëm gjithëpërfshirës për vlerësimin periodik të progresit në zbatimin e politikave dhe masave që lidhen me mbrojtjen sociale në vend. Përgjegjës për drejtimin dhe koordinimin e këtij procesi është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), e cila e ushtron këtë rol përmes strukturave të saj të brendshme Drejtorisë së Përkujdesit të Shërbimeve Sociale të Integruara, Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit për Mbrojtjen Sociale dhe Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.

Për të siguruar një qasje ndërsektoriale dhe të koordinuar, monitorimi mbështetet gjithashtu nga Grupi i Integruar i Menaxhimit të Programeve “Zhvillimi i Kapitalit Njerëzor”, nën-grupi tematik “Mbrojtja Sociale”, i ngritur me Urdhrin e Kryeministrit nr. 90, datë 1.08.2023” Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe për ngritjen dhe/ose riorganizimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar. Ky grup luan rolin e strukturës mbikëqyrëse dhe analitike që garanton bashkëpunimin mes institucioneve qendrore, agjencive zbatuese, njësisive të qeverisjes vendore dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Gjatë vitit të parë të zbatimit të strategjisë, pra në vitin 2024, monitorimi është përqendruar kryesisht në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave sasiore për programet ekzistuese të mbrojtjes sociale. Të dhënat janë mbledhur nëpërmjet matricës së vlerësimit, e cila përmban objektivat madhorë, objektivat specifike dhe indikatorët përkatës të performancës. Këto të dhëna janë përdorur për të përshkruar shkallën e mbulimit të skemave financiare, si ndihma ekonomike dhe përfitimet për personat me aftësi të kufizuara, si dhe për të evidentuar ndryshimet strukturore në zbatimin e tyre. Në raport janë përfshirë të dhëna të detajuara për numrin e familjeve dhe individëve përfitues nga skemat e mbrojtjes sociale, shpërndarjen e tyre sipas qarqeve, përbërjen gjinore dhe grupmoshore, si dhe përpjekjet për integrimin në tregun e punës përmes mekanizmave të referimit dhe ndërmarrjeve sociale. Këto të dhëna paraqiten kryesisht në formë përshkruese, pa një analizë të thelluar krahasuese mbi realizimin e objektivave të përcaktuara në strategji.

Krahas informacionit sasior, të dhënat cilësore janë mbledhur përmes konsultimeve dhe intervistave me aktorë institucionalë në nivel qendror dhe vendor, me synimin për të reflektuar progresin, sfidat dhe boshllëqet në zbatim. Megjithatë, Progres Raporti evidenton se këto aspekte janë ende në fazë zhvillimi dhe nuk përbëjnë pjesë të konsoliduar të analizës së performancës.

Në aspektin metodologjik, monitorimi është konceptuar të realizohet në mënyrë periodike, me raportime gjashtëmujore për burimet financiare dhe raportime vjetore për indikatorët e

performancës. Institucionet zbatuese, përfshirë Shërbimin Social Shtetëror dhe njësitë e qeverisjes vendore, janë të detyruara të raportojnë të dhënat në formate të unifikuara, përmes një matrice elektronike të monitorimit. Kjo qasje synon të garantojë transparencë, standardizim dhe krahasueshmëri midis periudhave raportuese.

Megjithatë, analiza e dokumentacionit tregon se viti 2024 ka qenë kryesisht një fazë përgatitore për konsolidimin e mekanizmave të monitorimit. Strategjia është miratuar në fillim të vitit, dhe si rrjedhojë, procesi është përqendruar në krijimin e bazës institucionale dhe metodologjike për mbledhjen e të dhënave, më shumë sesa në matjen e rezultateve konkrete të politikave. Për disa objektiva specifike, si p.sh. Objektivi A1: *“Të përmirësohet performanca, përshtatshmëria dhe përgjigjja ndaj krizave e skemave financiare dhe përfitimeve për individët (burra, gra, djem dhe vajza)”*, i cili lidhet drejtpërdrejtë me temën e auditimit është konstatuar se treguesit e performancës për këtë masë prioritare indikatorët ende nuk janë përcaktuar, pasi dokumenti i raportimit ndodhet në fazë drafti. Kjo tregon se mekanizmi i matjes së performancës është ende në proces zhvillimi dhe nuk ka prodhuar ende vlerësime të plota mbi efektivitetin e ndërhyrjeve. Në këtë pikë grupi auditimit konstaton se procesi i monitorimit i Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024-2030 në vitin e parë të zbatimit është ndërtuar mbi bazën e një qasjeje raportuese dhe përgatitore, më shumë sesa vlerësuese. Ai ka shërbyer për të vendosur bazat institucionale, për të testuar instrumentet e mbledhjes së të dhënave dhe për të përcaktuar formatet e raportimit, por ende nuk ka arritur të prodhojë një analizë të plotë të performancës dhe impaktit social të masave të ndërmarra.

### **Mbi monitorimin e Strategjisë së Punësimit dhe Aftësive 2023–2030<sup>31</sup>**

Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023-2030 përcakton në kreun IV të saj kornizën për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të masave prioritare. Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), si institucioni përgjegjës për fushën e punësimit dhe aftësimit profesional, ka rolin udhëheqës dhe është institucioni përgjegjës për monitorimin dhe koordinimin për ndjekjen e vazhdueshme të progresit dhe vlerësimin e rezultateve në kuadër të zbatimit të Strategjisë. Në shtojcën 1 të Strategjisë është pasqyruar plani i veprimit, ku janë përcaktuar 3 objektiva specifike dhe masat prioritare të çdo objektivi, së bashku me institucionet përgjegjëse (AKAFPK, MFE, AKPA, MAS). Institucionet përgjegjëse raportojnë mbi aktivitetet dhe burimet financiare përmes planeve vjetore të punës dhe sistemit të monitorimit. MFE ka detyrën për sistematizimin e informacionit dhe përgatitjen e raportit vjetor të monitorimit, i cili i dorëzohet qeverisë dhe diskutohet me aktorë të tjerë.

Sipas Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023-2030, ky monitorim synon të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e masave dhe ndërhyrjeve; të krahasojë progresin me planin e veprimit; të vlerësojë përdorimin e burimeve financiare (alokime dhe shpenzime); të analizojë rezultatet e arritura në tri nivele (masat prioritare, objektivat specifike, synimet afatgjata të politikës) si dhe të sigurojë informacion të rregullt për marrjen e vendimeve dhe përshtatjen e masave, kur është e nevojshme.

Strategjia specifikon se Monitorimi i zbatimit (masat, ndërhyrjet, burimet financiare) do të kryhet çdo vit. Monitorimi i performancës bazohet në kornizën e treguesve të përcaktuar në Shtojcën 2 të VKM-së nr. 173, datë 24.3.2023 *“Për miratimin e Strategjisë së Punësimit dhe Aftësive 2023-2030”* dhe gjithashtu realizohet në periudhë vjetore. Raporti vjetor i monitorimit përgatitet nga MFE dhe i paraqitet qeverisë. Ndërsa, për sa i përket vlerësimeve, Strategjia parashikon dy vlerësime kryesore:

- Vlerësimin e ndërmjetëm (2023-2025), i cili analizon zbatimin, rezultatet, rëndësinë e objektivave dhe koherencën me politikat kombëtare dhe kontekstin e ri;

---

<sup>31</sup> VKM nr. 173, datë 24.3.2023 *“Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023–2030, Planit të Veprimit për Zbatimin e saj, si dhe Planit të Zbatimit të Garancisë Rinore 2023–2024”*.

- Vlerësimi përfundimtar (2029-2030), i cili shqyrton ecurinë e të gjithë periudhës dhe vlerëson efektivitetin, efikasitetin, rëndësinë dhe qëndrueshmërinë e masave.

***Strategjia e Punësimit dhe Aftësive, adreson plakjen e popullsisë vetëm në nivel vizioni, pa tregues raportimi për grupin e cënueshëm +55 vjeç.***

Personat mbi 55 vjeç hyjnë në “Grupet e veçanta” sipas përkufizimit ligjor<sup>32</sup>, të cilët janë punëkërkues të disavantazuar në tregun e punës. MEI duhet të analizojë periodikisht tendencat e tregut të punës, të parashikojë zhvillimet e tij dhe të hartojë programe për nxitjen e punësimit.<sup>33</sup>

Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023-2030 e njeh plakjen e popullsisë si sfidë që ndikon në tregun e punës dhe kërkesën për aftësi, por kjo njohje mbetet në nivel të përgjithshëm politik, pa u shoqëruar me tregues të matshëm që të fokusohen në grupin e popullsisë mbi 55 vjeç. Në dokumentet strategjike, përfshirë planin e veprimit dhe raportet e monitorimit për vitet 2023 dhe 2024, nuk ka tregues monitorimi të dedikuara për punësimin, rikualifikimin ose përfshirjen e kësaj grupmoshe. Kjo e bën të pamundur matjen e ndikimit të programeve ekzistuese mbi punësimin e personave në moshë të avancuar. Vetë Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI) ka pranuar se masa për adresimin e plakjes janë indirekte, të lidhura me politikatat e përgjithshme të punësimit dhe aftësimit gjatë gjithë jetës, pa një qasje të veçantë për popullsinë në moshim.

Programet si Punësimi, Formimi në Punë, Vetëpunësimi dhe Riintegrimi Social janë formalisht të hapura për këtë grupmoshë, por mungon ndarja e të dhënave sipas moshës, gjë që pengon analizën e efektit real të tyre në nxitjen e punësimit të moshave 55+. Nga të dhënat e AKPA (2020–2025), rezulton se vetëm një numër shumë i kufizuar personash mbi 50 vjeç janë përfshirë në këto programe (596 në Programin e Punësimit, 358 në Formim në Punë, 45 në Vetëpunësim dhe 18 në Riintegrim Social). Nisur nga fakti që mosha mediane është rritur vitet e fundit, raportimi mbi ecurinë e kësaj grupmoshe në tregun e punës shihet me rëndësi. Mosndarja e raportimeve dhe e arritjeve sipas grupmoshave e kufizon analizën periodike të tregut të punës.

***Procesi i monitorimit të Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (2023–2030) në vitin 2024, nuk ka të dhëna mbi treguesit e rezultateve për masat e politikave në objektivin strategjik 1.3.***

Nga shqyrtimi i Raportit të Zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023–2030 për vitin 2023, grupi i auditimit evidentoi se procesi i monitorimit është kryer dhe përbën fazën e parë të funksionimit të sistemit të ndjekjes së strategjisë. Monitorimi është zhvilluar në përputhje me strukturën e dokumentit strategjik dhe ka pasqyruar zbatimin e masave të planifikuara për vitin e parë, por ka pasur kryesisht karakter organizativ dhe përgatitor, duke u fokusuar më shumë në vendosjen e mekanizmave të bashkëpunimit dhe raportimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse. Përgjegjës për procesin e monitorimit është Ministria e Ekonomisë, dhe Inovacionit (MEI), e cila drejton dhe koordinon punën me Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA), Agjencinë Kombëtare për Arsimin Profesional dhe Kualifikimet (AKAFP), si dhe me Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Sociale. Në proces janë përfshirë gjithashtu INSTAT, partnerët e zhvillimit dhe organizatat e shoqërisë civile, që kanë kontribuar me të dhëna statistikore dhe mbështetje analitike. Në tabelën ku tregohen treguesit e performancës së monitorimit të zbatimit të masave, konstatohet se nuk ka të dhëna gjatë vitit 2024, për:

-Numri i punëkërkuesve që përdorin shërbimet digjitale;

<sup>32</sup> Ligj Nr. 15/2019 “Për Nxitjen e Punësimit”, i ndryshuar, neni 3, pika 4, shkronja “d”.

<sup>33</sup> Ligj Nr. 15/2019 “Për Nxitjen e Punësimit”, i ndryshuar, neni 5, pika 1, shkronja “a” dhe “c”.

- Numri i ofruesve të AFP-së që ofrojnë mësim të kombinuar ose online;
- Përqindja e ndërmjetësimeve të realizuara jashtë bashkisë së banimit.

Lidhur me treguesit për masat e politikës 2.1.1 - Shërbimet dhe programet që promovojnë punësimin dhe trajnimin duke përdorur ekosistemin e tregut të punës, konstatohet se për vitin 2024, nuk ka raportim për numri (ose përqindja) e pjesëmarrësve në formim profesional nga grupe të caktuara, të ndarë sipas kategorive të ndryshme (niveli i tretë, përfitues të ndihmës ekonomike, grupe etnike etj.);

Për sa më sipër, mungesa matjes së treguesve e bën të pamundur vlerësimin e realizimit të objektivave.

Megjithëse raporti ndjek strukturën logjike të ndërhyrjeve të strategjisë dhe përfshin informacion mbi rezultatet e arritura, ai mbetet më shumë përshkrues sesa analitik, pasi mungon ndarja e të dhënave sipas grupmoshave, gjinive apo kategorive të përfituesve, ashtu si kërkohet në strategji. Procesi i monitorimit është zhvilluar me përfshirje të pjesshme të aktorëve institucionalë. Roli kryesor është luajtur nga MEKI dhe agjencitë e varësisë, ndërsa përfshirja e institucioneve të tjera, si Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale apo Shërbimi Social Shtetëror, ka qenë e kufizuar.

### **Mbi monitorimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë (2022–2029)<sup>34</sup>**

Sipas Strategjisë Kombëtare të Rinisë (2022–2029), procesi i monitorimit të Strategjisë Kombëtare të Rinisë (2022–2029) duhet të realizohet në mënyrë periodike, përmes raporteve gjastëmujore dhe vjetore, të cilat përmbajnë të dhëna statistikore dhe narrative mbi progresin e arritur. Përveç këtyre, parashikohet edhe një monitorim afatmesëm në fund të vitit 2026, me qëllim vlerësimin e mesëm të zbatimit të strategjisë dhe përshtatjen e planit të veprimit në përputhje me ndryshimet në kontekstin socio-ekonomik dhe nivelin e mobilizimit të burimeve financiare. Plani i veprimit rishikohet çdo 2–3 vjet për të garantuar një përputhje realiste midis objektivave dhe mundësive faktike për zbatim. Gjithashtu monitorimi është konceptuar dhe zhvilluar në përputhje me standardet e sistemit informatik të planifikimit të integruar (IPSIS), Metodologjia e ndjekur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (MSHMS) synon të sigurojë një sistem raportimi të unifikuar, efektiv dhe të bazuar në evidenca, që garanton ndjekjen e ecurisë së objektivave dhe masave të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Rinisë (2022–2029).

### ***Vlerësimi i procesit të monitorimit, sipas “Raportit të Monitorimit të Strategjisë Kombëtare të Rinisë (2022–2029) për vitin 2023.***

Nga shqyrtimi i Raportit të Monitorimit për Zbatueshmërinë e Strategjisë Kombëtare të Rinisë (2022–2029) për vitin 2023, rezulton se procesi i monitorimit është kryer në periodicitetin 6-mujor dhe vjetor. Është hartuar dokumenti përmbledhës që pasqyron ecurinë e zbatimit të masave dhe planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022–2029. Raporti është realizuar në përputhje me strukturën e dokumenteve strategjike sektorialë dhe ndërsektorialë, sipas kërkesave metodologjike të IPSIS. Ai ofron informacion mbi zbatueshmërinë e qëllimeve politike, objektivave specifike, masave dhe aktiviteteve të planifikuara, si edhe mbi realizueshmërinë e treguesve të performancës gjatë periudhës së raportimit.

Nga shqyrtimi i Raportit të Monitorimit për Zbatueshmërinë e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022–2029, viti 2023, rezulton se dokumenti jep informacion analitik dhe të matshëm mbi progresin e masave prioritare, problematikat e hasura gjatë zbatimit, sfidat e institucioneve përgjegjëse dhe kontribuuese, si dhe rekomandon masat e nevojshme korrigjuese për periudhat e ardhshme. Po ashtu, raporti përfshin të dhëna statistikore dhe evidenca të verifikueshme, të

<sup>34</sup> VKM nr. 692, datë 26.10.2022 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe Planit të Veprimit 2022–2029”.

mbledhura nga vetë institucionet zbatuese, dhe reflekton konsultimin me aktorët zbatues dhe vlerësues të procesit.

Në lidhje me cilësinë e monitorimit, nga shqyrtimi i raportit të monitorimit për vitin 2023, rezulton se ekzistojnë disa sfida që ndikojnë në efektivitetin e tij. Raporti evidenton se performanca e disa objektivave specifikë ka rezultuar e dobët dhe jo rezultative, për shkak të nivelit të ulët të zbatimit të masave përkatëse. Si sfida paraqitet domosdoshmëria për të nisur me kohë aktivitetet në funksion të zbatimit të masave që rezultojnë me realizueshmëri të ulët, pasi ato ndikojnë drejtpërdrejt në performancën e objektivave dhe të qëllimeve politike që ato mbështesin.

Në aspektin e funksionimit të mekanizmave institucionale, nga shqyrtimi i Raportit të Monitorimit për Zbatueshmërinë e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022–2029, viti 2023, rezulton se, numri i madh i institucioneve përgjegjëse dhe kontribuuese për zbatimin e masave kërkon menaxhim efektiv dhe koordinim të vazhdueshëm. Raporti nënvizon se Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët (MSHRF), si institucioni që drejton procesin e monitorimit të SKR-së, ka staf të reduktuar, çka përbën risk dhe kërkon ndërhyrje për t'u adresuar. Raporti thekson se rritja e kapaciteteve zbatuese dhe financuese është e nevojshme. Po ashtu, theksohet nevoja për të forcuar Agjencinë Kombëtare të Rinisë, përmes shtimit të burimeve njerëzore dhe miratimit të ndryshimeve të propozuara strukturore, në mënyrë që të rritet roli i saj në zbatimin dhe monitorimin e politikave të rinisë. Nga shqyrtimi i raportit rezulton se bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë dhe donatorët është vlerësuar si pikë e fortë e procesit.

Grupi i auditimit vlerëson se monitorimi është kryer në periodicitetin 6-mujor dhe vjetor, duke ofruar një tablo të përgjithshme të ecurisë së Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022–2029 për vitin 2023. Megjithatë, vihet re se raportimi është fokusuar kryesisht në nivelin e realizimit të objektivave, masave dhe treguesve të performancës, ndërsa më pak në analizën kritike të vetë procesit të monitorimit, funksionimit të mekanizmave ndërinstitucionalë dhe cilësisë së të dhënave të raportuara nga institucionet përgjegjëse dhe kontribuuese.

Në këtë kuadër, grupi i auditimit vlerëson se forcimi i mëtejshëm i cilësisë, koherencës dhe thellësisë analitike të procesit të monitorimit do të rriste vlerën e tij si instrument orientues për politikëbërjen. Një proces më gjithëpërfshirës dhe analitik do të ndihmonte në identifikimin e mangësive dhe pengesave në zbatim, si edhe në ndërmarrjen e masave korrigjuese në kohë.

Një proces i tillë do të siguronte një panoramë më të qartë mbi ndikimin potencial të politikave rinore në zhvillimet demografike të vendit, përfshirë edhe ato që lidhen me moshimin e popullsisë. Ky dimension është i rëndësishëm, pasi politikat rinore, përmes fuqizimit të të rinjve, rritjes së mundësive për arsim, punësim dhe pjesëmarrje, përbëjnë një komponent të drejtpërdrejtë në ruajtjen e kapitalit njerëzor dhe në frenimin e trendeve të moshimit demografik.

#### ***Vlerësimi i procesit të monitorimit, sipas “Raportit të Monitorimit të Strategjisë Kombëtare të Rinisë (2022–2029) viti 2024.***

Nga shqyrtimi i Raportit të Monitorimit për Zbatueshmërinë e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022–2029, viti 2024, rezulton se procesi i monitorimit është kryer vjetor. Raporti paraqet të dhëna mbi ecurinë e zbatimit të masave dhe objektivave të strategjisë dhe ofron një tablo të përgjithshme të progresit dhe sfidave të hasura gjatë vitit 2024.

Nga shqyrtimi i raportit, rezulton se dokumenti i Raportit të Monitorimit për Zbatueshmërinë e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022–2029, për vitin 2024 ka vijuar të paraqesë të dhëna statistikore dhe analitike të mbështetura në evidenca të matshme dhe të verifikueshme, të

raportuara nga institucionet zbatuese dhe të kombinuara me informacion të publikuar nga burime shtetërore, kombëtare dhe ndërkombëtare. Sipas raportit procesi është shoqëruar me konsultim me aktorët zbatues dhe vlerësues, si dhe me analiza krahasimore të progresit sipas objektivave të strategjisë.

Nga shqyrtimi i Raportit të Monitorimit për Zbatueshmërinë e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022–2029, viti 2024 , rezulton se efektiviteti i procesit të monitorimit vijon të përballet me një sërë sfidash të ngjashme me ato të konstatuara edhe në periudhat e mëparshme. Raporti thekson se, pavarësisht progresit të shënuar në disa objektiva, zbatueshmëria e masave ka qenë e kufizuar në disa fusha për shkak të fillimit me vonesë të aktiviteteve dhe kapaciteteve të pamjaftueshme zbatuese. Kjo situatë ka ndikuar negativisht në performancën e objektivave specifike dhe të treguesve të tyre përkatës.

Në aspektin institucional, raporti nënvizon se procesi i monitorimit dhe koordinimit mbetet i ekspozuar ndaj risqeve që lidhen me numrin e lartë të institucioneve përgjegjëse dhe kontribuuese, kompleksitetin e kërkesave të SKR 2022–2029 dhe mungesën e burimeve të mjaftueshme njerëzore në MSHRF, institucion përgjegjës për drejtimin e monitorimit. Raporti vlerëson se reduktimi i stafit në MSHRF përbën risk të drejtpërdrejtë për cilësinë dhe koherencën e procesit të monitorimit, duke e bërë të nevojshme ndërhyrjen strukturore dhe rritjen e kapaciteteve të Agjencisë Kombëtare të Rinisë, e cila po përgatitet të ristrukturohet dhe të forcohet me staf shtesë.

Raporti vlerëson pozitivisht rolin e partnerëve ndërkombëtarë dhe vendas në zbatimin e masave, duke theksuar se mbështetja e tyre njerëzore dhe financiare ka kontribuar ndjeshëm në rritjen e numrit të masave të përfunduara gjatë vitit 2024. Megjithatë, raporti thekson se mbështetja e jashtme nuk zëvendëson nevojën për forcimin e kapaciteteve institucionale të brendshme dhe për sigurimin e burimeve të qëndrueshme për monitorim dhe zbatim.

Nga shqyrtimi i Raportit të Monitorimit për Zbatueshmërinë e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022–2029, viti 2024 raportit të vitit 2024, rezulton se, ndonëse monitorimi është kryer dhe paraqet informacion mbi progresin e masave dhe objektivave, procesi i monitorimit nuk ka arritur ende të garantojë një analizë të plotë dhe të thelluar të shkaqeve të mosrealizimit të masave, të vështirësive në raportim dhe të riskut të moszbatimit. Raporti nënvizon nevojën për përmirësimin e metodologjisë së raportimit, sigurimin e evidencave të plota mbi zbatueshmërinë e masave dhe forcimin e standardeve të cilësisë së të dhënave të raportuara nga institucionet zbatuese.

Grupi i auditimit vlerëson se monitorimi për vitin 2024 është kryer në përputhje me periodicitetin e parashikuar dhe ka siguruar një pasqyrë të përgjithshme të ecurisë së zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022–2029. Megjithatë, procesi nuk ofron një vlerësim të mjaftueshëm të vetë mekanizmit të monitorimit. Raporti fokusohet kryesisht te niveli i realizimit të objektivave dhe masave të strategjisë, ndërsa mbetet më pak i thelluar në analizën e cilësisë së monitorimit, funksionimit të mekanizmave ndërinstitutionalë, koherencës së të dhënave të raportuara dhe shkallës së përfshirjes së të gjithë aktorëve përgjegjës, siç parashikohet nga kuadri strategjik dhe ligjor.

Në gjykimin e grupit të auditimit, monitorimi i vitit 2024, ndonëse i kryer, nuk siguron ende analizën e nevojshme kritike për të vlerësuar se sa efektiv është procesi si instrument menaxhimi dhe vendimmarrjeje. Cilësia dhe efektiviteti i procesit të monitorimit të SKR-së ka rëndësi të veçantë, pasi politikat rinore janë komponent i pandashëm i masave kombëtare që synojnë ruajtjen e kapitalit njerëzor, fuqizimin e të rinjve dhe përmirësimin e perspektivës së tyre social ekonomike në vend. Një proces më i fortë monitorimi do të shërbente jo vetëm për të matur progresin e politikave rinore, por edhe për të orientuar më mirë politikat shtetërore që

ndikojnë në dinamikat demografike dhe në frenimin e tendencave të moshimit të popullsisë në periudhë afatmesme dhe afatgjatë.

**Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë.** Përfshirja e këtij ndryshimi institucional në raport, ka si qëllim të sqarojë se përgjegjësitë për politikën rinore nuk i përkasin më Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, por Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit.

Nga shqyrtimi i dy vendimeve të Këshillit të Ministrave me nr. 524, datë 22.9.2021, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët” dhe nr. 512, datë 25.9.2025, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit” vërehet një ristrukturim institucional dhe funksional i përgjegjësive shtetërore për politikën rinore në nivel qendror.

Vendimi me nr. 524, datë 22.9.2021 i caktonte Ministrinë të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët një fushë të veçantë përgjegjësie, me kompetencë të drejtpërdrejtë për hartimin, zhvillimin dhe monitorimin e politikave për rininë dhe fëmijët. Ky ministër kishte rol koordinues ndër-institucional dhe përgjegjësi për:

- hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë mbrojtjen e të drejtave të të rinjve dhe garantimin e pjesëmarrjes së tyre në jetën shoqërore;
- përcaktimin e funksioneve e kompetencave të institucioneve në nivel qendror e vendor për çështjet e rinisë;
- bashkëpunimin me organizatat rinore dhe trajtimin e çështjeve që lidhen me të rinjtë në diasporë dhe programet e shkëmbimeve ndërkombëtare rinore.

Ndërsa me vendimin nr. 512, datë 25.9.2025, kompetencat për çështjet e rinisë janë transferuar dhe integruar brenda Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, e cila tashmë ka një portofol të zgjeruar që bashkon katër fusha: turizmin, kulturën, sportin dhe rininë.

Ky ndryshim nënkupton kalimin nga një ministri e dedikuar për rininë në një ministri me karakter sektorial të kombinuar, ku politikën për rininë janë një ndër nëndrejtimet të përgjegjësive shtetërore, krahas politikave për turizmin, kulturën dhe sportin.

Vendimi nr. 512/2025 përcakton se Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit:

- harton, zhvillon dhe monitoron politikën për mbrojtjen e të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse;
- krijon kushtet për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve;
- përcakton funksionet e institucioneve në nivel qendror e vendor për çështjet e rinisë;
- bashkëpunon me organizatat rinore, me strukturat për diasporën dhe me institucionet ndërkombëtare për programet e shkëmbimeve rinore.

Në të njëjtin vendim përcaktohet shprehimisht se shfuqizohet vendimi i vitit 2021 për Ministrinë e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, duke e zhvendosur përgjegjësinë shtetërore për politikën rinore nën juridiksionin e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit. Kjo do të thotë se funksionet politike dhe administrative për rininë, hartimi i strategjive, koordinimi institucional, monitorimi i zbatimit dhe raportimi në nivel qeveritar tani administrohen nga kjo ministri.

Kështu, përgjegjësitë për rininë kalojnë nga një institucion me rol koordinues ndërsektorial (Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët) tek një ministri me funksione të kombinuara sektoriale, ku politikën rinore konsiderohen pjesë e politikave të zhvillimit të turizmit, kulturës dhe sportit, me synim nxitjen e aktivizimit, pjesëmarrjes sociale dhe fuqizimit ekonomik të të rinjve në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm.

**4. Gjetje nga auditimi:** Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2024-2030 përcakton që Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale duhet të kryejë monitorim periodik me tregues të përcaktuar performance dhe raportime analitike që mundësojnë vlerësimin e progresit dhe

efektivitetit të masave. Auditimi konstatoi se monitorimi për vitin 2024 është realizuar në mënyrë të pjesshme dhe kryesisht me karakter raportues, pasi treguesit e performancës nuk janë ende të përcaktuar dhe raporti i progresit për vitin 2024 nuk përbën një dokument të plotë dhe të miratuar të monitorimit. Kjo vjen për shkak se procesi i përditësimit të indikatorëve të performancës dhe mekanizmave të raportimit mbetet në zhvillim. Si rrjedhojë, mungon një raport përfundimtar që të mundësojë vlerësim të plotë të progresit dhe efektivitetit të masave të parashikuara në strategji, duke kufizuar mbështetjen për vendimmarrjen.

**5. Gjetje nga auditimi:** Strategjia e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030 përcakton që politikat sektoriale të përfshijnë objektiva të matshëm, tregues të dedikuar dhe raportim të ndarë sipas grupmohave për grupet e identifikuara si të veçanta, për të mundësuar vlerësimin e efektivitetit të tyre. Nga auditimi u konstatua se, ndonëse strategjia parashikon “punësim cilësor dhe aftësim gjatë gjithë jetës për të gjithë” dhe e njeh plakjen e popullsisë si sfidë, raport-progresi i strategjisë nuk përcakton tregues performance apo raportime të dedikuara për grupmohën mbi 55 vjeç. Raportimet e MEI dhe AKPA nuk paraqesin të dhëna të ndara sipas moshës për këtë grup. Si pasojë, nuk mund të vlerësohet ndikimi real i politikave në rritjen e pjesëmarrjes së kësaj grupmoshe në tregun e punës.

**6. Gjetje nga auditimi:** Strategjia e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030 kërkon raportim të plotë vjetor për treguesit e rezultateve, të ndarë sipas kategorive të përfituesve dhe faktorëve të tjerë demografikë, në mënyrë që të mundësohet vlerësimi i progresit dhe planifikimi efektiv i politikave. Auditimi konstatoi se monitorimi për vitin 2024, ndonëse është kryer, nuk është plotësisht funksional për shkak të mungesës së të dhënave për disa tregues kyç të objektivit 1.3, si numri i punëkërkuësve që përdorin shërbimet digjitale, numri i ofruesve të AFP-së që ofrojnë mësim online ose të kombinuar, dhe përqindja e ndërmjetësimeve jashtë bashkisë së banimit. Gjithashtu, mungojnë të dhëna të ndara sipas kategorive specifike të përfituesve për masën 2.1.1. Si pasojë, raportet e monitorimit mbeten kryesisht përshkruese dhe jo analitike, nuk ofrojnë ndarje të rezultateve sipas grupmohave, gjinive apo kategorive të përfituesve dhe nuk ofrojnë informacion të mjaftueshëm për matjen e progresit dhe përmirësimin e vendimmarrjes.

**2. Konkluzion:** Monitorimi dhe vlerësimi i politikave të lidhura me moshimin e popullsisë dhe zhvillimin e kapitalit njerëzor është një komponent kyç për menaxhimin e politikave publike në Shqipëri. Nga vlerësimi i procesit të monitorimit për Strategjitë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale (2019-2030), Punësimit dhe Aftësive (2023-2030) dhe Rinisë (2022-2029), rezulton se proceset e monitorimit janë ngritur dhe funksionojnë mbi bazën e një strukture institucionale të qartë dhe metodologjike. Megjithatë, ekzistojnë sfida të rëndësishme për disa strategji të reja, që lidhen me përcaktimin e indikatorëve të performancës apo raportimin, çka kufizon mundësinë e vlerësimit të plotë të progresit dhe ndikimit të masave. Proceset janë kryesisht raportuese dhe përgatitore në vitet e para të zbatimit, me një fokus më të kufizuar në analizën kritike të performancës dhe funksionimit të mekanizmave ndër-institucionalë.

**4.1 Rekomandim:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të marrë masa që të përshpejtojë procesin e përditësimit dhe miratimit të indikatorëve të performancës për secilin objektiv strategjik të përcaktuar në Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024-2030, në mënyrë që raportet e monitorimit të jenë të bazuara në tregues të matshëm dhe të krahasueshëm. Gjithashtu, MSHMS të sigurojë publikimin periodik të raporteve vjetore të monitorimit, të cilat të përfshijnë analiza cilësore dhe financiare, duke mundësuar vlerësimin transparent të progresit dhe llogaridhënies institucionale.

**Brenda datës 31.12.2026**

**5-6.1 Rekomandim:** Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI), në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe institucionet partnere, të marrë masa të pasqyrojë në raport progresin e Strategjisë Punësimit dhe Aftësive 2023–2030 të gjithë treguesit e performancës sipas përcaktimeve të saj në mënyrë që të shihen arritjet e indikatorëve përkatës.

**Brenda datës 31.12.2026**

## **5.2 A adresojnë politikat kombëtare sfidat e moshimit të popullsisë në periudhë afatgjatë?**

### **5.2.1 A janë miratuar politikat bazuar në të dhënat aktuale mbi moshimin e popullsisë?**

#### **Strategjia Kombëtare e Migracionit 2023 – 2030**

Në përballje me sfidat e plakjes së popullsisë dhe emigracionit të lartë, Shqipëria ka miratuar Strategjinë Kombëtare për Migracionin 2023 – 2030 si një dokument kornizë për menaxhimin e lëvizjeve migratore. Ky dokument përbën një përpjekje të integruar për të kanalizuar politikat e migracionit drejt zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, social dhe politik të vendit, në përputhje me aspiratat e integritit evropian. Strategjia Kombëtare për Migracionin 2024 – 2030 paraqet një kuadër të gjerë politikash për menaxhimin e flukseve migratore dhe për riintegrimin e të kthyerve, por ajo nuk mbështetet në një bazë të plotë statistikore dhe demografike që të mundësojë analizën e thelluar të shkaqeve, tipareve dhe trendeve të migracionit. Në dokument mungojnë të dhëna të detajuara mbi moshën, gjininë, statusin, nivelin arsimor, arsyet e migrimit si dhe natyrën sezonale apo të përhershme të emigracionit dhe imigracionit.

Këto elementë janë thelbësore për të kuptuar jo vetëm përmasat, por edhe strukturën dhe motivet e fenomenit, si dhe për të ndërtuar politika më të orientuara, me objektiva të matshëm dhe me ndikim real. Pa një analizë të tillë të bazuar në evidenca, strategjia rrezikon të mbetet në nivel deklarativ, duke mos adresuar në mënyrë të diferencuar grupet më të prekura si të rinjtë, gratë, apo komunitetet rurale dhe duke mos mundësuar vlerësimin e efekteve afatgjata të migracionit mbi tregun e punës, zhvillimin ekonomik dhe strukturën demografike të vendit. Për pasojë, mungesa e përdorimit të të dhënave të detajuara e kufizon aftësinë e strategjisë për të parashikuar trendet e ardhshme dhe për të hartuar ndërhyrje efektive që synojnë ruajtjen e kapitalit njerëzor dhe ngadalësimin e plakjes së popullsisë.


Strategjia Kombëtare e Migracionit 2023 – 2030 është mbështetur pjesërisht në burime statistikore kombëtare dhe ndërkombëtare si: INSTAT, EUROSTAT, FRONTEX, IOM, UNHCR, dhe Komisioni Evropian. Dokumenti përfshin një sërë treguesish të rëndësishëm për të përshkruar kontekstin migrator të Shqipërisë, duke përfshirë:

Bilancin migrator<sup>35</sup> negativ, me migrim neto që është përkeqësuar ndjeshëm nga -15,030 persona në vitin 2018, në -32,853 në vitin 2021, dhe në -32,497 në vitin 2022.

---

<sup>35</sup> Bilanci migrator është një tregues demografik që mat ndryshimin e popullsisë së një vendi ose rajoni si rezultat i migracionit, pra i lëvizjes së njerëzve që hyjnë (imigrantët) dhe dalin (emigrantët) nga ai vend.

Figura nr. 5: Bilanci Migrator në Shqipëri, 2018-2022



Burimi: INSTAT, 2023.

Tendencat e shpërndarjes gjeografike, ku sipas EUROSTAT-it, shqiptarët me leje qëndrimi janë të përqendruar në Greqi, Itali, Gjermani, Francë etj, paraqiten më gjerësisht në Aneksin nr. 3 bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Tabela nr. 8: Shtetasit shqiptarë me leje qëndrimi për herë të parë në vendet evropiane, 2019-2022

Tabela 2. Shtetasit shqiptarë me leje qëndrimi për herë të parë në vendet evropiane, 2019–2022

	Shqiptarë me leje qëndrimi në Evropë			
	2019	2020	2021	2022
Belgjikë	774	766	844	1,023
Bullgari	167	97	157	151
Republika Çeke	254	105	109	148
Danimarkë	47	42	65	236
Gjermani	12,014	8,308	4,492	13,334
Estoni	11	9	10	6
Irandë	142	104	151	468
Greqi	15,733	7,768	10,201	14,313
Spanjë	312	422	622	723
Francë	2,344	1,951	2,313	2,455
Kroaci	2,216	1,695	1,819	2,003
Itali	21,221	13,627	29,732	34,864
Qipro	59	33	33	65
Lituani	26	12	15	35
Luksemburg	157	138	140	177
Hungari	335	246	275	321
Mali	1,178	415	1,142	2,009
Hollandë	357	244	299	444
Austri	384	300	402	544
Poloni	-	236	348	626
Portugali	13	24	6	22
Rumani	275	266	261	249
Sloveni	111	61	113	134
Finlandë	146	174	263	430
Suedi	1,723	1,124	1,067	1,210
Islandë	34	31	31	40
Norvegji	143	101	127	118
Zvicër	306	-	356	419


Burimi: EUROSTAT, 2023

Burimi: Strategjia Kombëtare e Migracionit 2023–2030

Janë pajisur me leje qëndrimi për herë të parë në vendet evropiane në total sipas viteve:

- 2019 – 30482 leje qëndrimi;
- 2020 – 38299 leje qëndrimi;
- 2021 – 55393 leje qëndrimi;
- 2022 – 76567 leje qëndrimi.

Figura nr.6: Zhvillimi i kërkesave për azil nga qytetarët e Shqipërisë 2000 deri në 2024



Burimi: World data<sup>36</sup>

Vija e sipërme përfaqëson numrin total të aplikimeve për azil (aplikimet e para + shqyrtimet), numri i aplikimeve të pranuar (jeshile) dhe aplikimeve të refuzuara (e kuqe).

Të dhënat tregojnë se gjatë vitit 2024 8,541 shtetas shqiptarë kanë paraqitur kërkesë për azil, kryesisht në vendet evropiane, ku destinacioni kryesor mbetet Mbretëria e Bashkuar, e ndjekur nga Italia, Franca dhe Gjermania. Megjithatë, shkalla e pranimit është shumë e ulët, vetëm 2.4% në total, me shumicën dërrmuese të kërkesave të refuzuara. Vendet e BE-së si Gjermania, Greqia, Suedia dhe Holanda kanë normë pranimi 0%, ndërsa norma më e lartë e pranimit vërehet në Kanada (79.5%) dhe Shtetet e Bashkuara (42.9%), edhe pse me numër relativisht të vogël aplikimesh.


Tabela nr.9: Kërkesat për azil, 2024

Destinacioni	Zbatuar	Pranuar	Refuzuar	Shkalla e pranimit
Mbretëria e Bashkuar	2,752	69	3,653	1.9 %
Italia	1,882	20	695	2.8%
Francë	1,391	41	2,068	1.9 %
Gjermania	962	0	1,199	0.0 %
Greqi	589	0	363	0.0 %
Belgjikë	245	10	329	2.9 %
Shtetet e Bashkuara	209	15	20	42.9 %
Irlandë	180	5	236	2.1%
Kanada	130	58	15	79.5%
Zvicër	50	0	42	0.0 %
Suedi	29	0	22	0.0 %
Norvegji	24	0	12	0.0 %
Holanda	22	0	17	0.0 %
Spanjë	22	0	21	0.0 %
Austri	18	0	26	0.0 %
Danimarka	8	0	5	0.0 %
Finlanda	8	0	10	0.0 %
Islanda	5	0	0	
Luksemburg	5	0	11	0.0 %
Meksikë	5	0	0	
Slloveni	5	0	0	
Izrael	0	0	10	0.0 %
Australi	0	0	0	
<b>Totalet</b>	<b>8,541</b>	<b>218</b>	<b>8,754</b>	<b>2.4%</b>

Burimi: World Data

<sup>36</sup> [https://www.worlddata.info/europe/albania/asylum.php?utm\\_source](https://www.worlddata.info/europe/albania/asylum.php?utm_source)

Figura nr. 7: Kërkesat për azil, 2019-2022



Burimi: Databaza e EUROSTAT & Home Office UK, 2023

**Mungesa e projeksioneve** në Strategjinë Kombëtare të Emigracionit 2023-2030 për vitet e ardhshme mbi emigracionin paraqet një problem të rëndësishëm, pasi pengon parashikimin e tendencave demografike dhe planifikimin efektiv të politikave sociale dhe ekonomike. Këto mund të ilustron në mënyrë qartë përmes disa mangësive kryesore të strategjisë:

- Strategjia nuk përmban parashikime (projeksione) për trendet e migracionit në vitet 2024–2030, ndonëse është një dokument afatmesëm strategjik.
- Nuk janë përdorur modele demografike për të vlerësuar ndikimin e migracionit në strukturën e popullsisë (p.sh. ulja e numrit të të rinjve në moshë pune apo rritja e raportit të varësisë demografike).
- Dokumenti mbështetet në të dhëna retrospektive (për periudhën 2015–2018 ose 2019 – 2022), pa e projektuar prirjen në të ardhmen.
- Kjo e kufizon aftësinë parashikuese të strategjisë, duke e bërë më të vështirë planifikimin buxhetor dhe programimin e masave efektive për menaxhimin e emigracionit dhe rikthimin.

Strategjia Kombëtare për Migracionin 2024 – 2030 nuk përmban parashikime për zhvillimet e ardhshme të emigracionit gjatë periudhës së zbatimit të saj. Dokumenti mbështetet kryesisht në të dhëna retrospektive, të përfshira në profilet e migracionit që mbulojnë periudhën 2015 – 2018 dhe në vlerësime të përgjithshme të situatës deri në vitin 2022. Megjithatë strategjia synon të orientojë politikën kombëtare për një periudhë shtatëvjeçare, ajo nuk ofron një analizë të projeksioneve të mundshme për flukset migratore, për ndarjen e popullsisë sipas grupmoshave apo për ndikimin afatgjatë që emigracioni mund të ketë në strukturën demografike të vendit.

Kjo qasje kufizon ndjeshëm kapacitetin planifikues të dokumentit dhe e bën të vështirë parashikimin e tendencave që do të ndikojnë drejtpërdrejt tregun e punës, zhvillimin ekonomik dhe shërbimet publike. Pa një bazë parashikuese, institucionet përgjegjëse nuk kanë mundësi të projektojnë me saktësi nevojat për ndërhyrje, burimet financiare dhe masat korrigjuese që duhen ndërmarrë në rast ndryshimesh të mëdha në flukset migratore.

Në aspektin e auditimit të performancës, kjo nënkupton se politikën e hartuar mund të mos jenë në përputhje me realitetin demografik në zhvillim dhe se burimet publike rrezikojnë të mos përdoren në mënyrë optimale. Mungesa e projeksioneve gjithashtu kufizon koordinimin ndërsektorial me politikën e punësimit, arsimin dhe mbrojtjes sociale, të cilat varen nga dinamika e popullsisë aktive dhe nga ndryshimet në raportin e varësisë demografike. Si pasojë,

strategjia humbet aftësinë për të qenë një instrument parashikues dhe për të udhëhequr qeverisjen afatgjatë të migracionit në përputhje me realitetet demografike të vendit. Strategjia nuk ofron bazë të mjaftueshme për të vlerësuar nëse politikat e saj janë të qëndrueshme në kushtet e ndryshimeve të ardhshme demografike.

**Mungesa e të dhënave të detajuara mbi shpërndarjen gjeografike të emigrantëve sipas rajoneve** përbën një kufizim të rëndësishëm në Strategjinë Kombëtare të Emigracionit, pasi dokumenti nuk ofron analiza të thelluara rajonale ose lokale që të tregojnë se nga cilat qarqe, bashki apo zona rurale vjen pjesa më e madhe e emigrantëve. Mungesa e kësaj shpërndarjeje kufizon mundësinë për të hartuar masa të synuara territorialisht, si për shembull:

- programe punësimi për zonat me emigracion të lartë,
- mbështetje për familjet e emigrantëve të larguar,
- apo politika për riintegrim të përqendruar në bashkitë me kthime më të larta.

Një tjetër mangësi e rëndësishme e strategjisë lidhet me mungesën e një analize territoriale të emigracionit. Dokumenti nuk përmban të dhëna mbi përkatësinë rajonale apo bashkiake të shtetasve shqiptarë që emigrojnë jashtë vendit, duke mos lejuar identifikimin e zonave më të prekura nga largimi i popullsisë. Aktualisht, burime zyrtare si INSTAT nuk publikojnë periodikisht statistika që pasqyrojnë origjinën territoriale të emigrantëve sipas qarqeve, bashkive apo rajoneve.


Për pasojë, strategjia mbetet në nivel të përgjithshëm kombëtar dhe nuk arrin të adresojë dallimet e mëdha që ekzistojnë mes zonave urbane dhe rurale apo midis veriut dhe jugut të vendit, ku emigracioni ka ritme dhe shkaqe të ndryshme. Mungesa e analizës territoriale e kufizon aftësinë e institucioneve për të hartuar masa të synuara sipas specifikave të secilit rajon, si për shembull programe punësimi për zonat me emigracion të lartë, politika për riintegrimin e të kthyerve në komunitetet e origjinës apo mbështetje për familjet e emigrantëve të mbetur pas.

Kjo krijon rrezikun që masat e parashikuara të kenë efekt të kufizuar dhe të mos garantojnë një shpërndarje të drejtë të përfitimeve në të gjithë territorin e vendit. Strategjia mund të prodhojë politika të njëtrajtshme për gjithë vendin, pa marre parasysh nevojat dhe kapacitetet lokale. Në terma afatgjatë, kjo prirje mund të ndikojë negativisht në zhvillimin e qëndrueshëm dhe në integrimin social midis rajoneve, si dhe të rrisë pabarazitë në zhvillim ekonomik e në aksesin në shërbime publike. Për më tepër, mospërfshirja e një analize gjeografike pengon bashkërendimin efektiv me njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat kanë rol kyç në riintegrimin e të kthyerve dhe në hartimin e politikave lokale për menaxhimin e emigracionit.

### **Lidhja midis papunësisë rajonale dhe emigracionit ekonomik**

Sipas Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023 – 2030, qarku i Lezhës regjistron shkallën më të lartë të papunësisë në vend (22.6% në vitin 2021), i ndjekur nga Vlora me 19.5%, ndërsa në krahun tjetër Kukësi (4%) dhe Gjirokastra (4.7%) paraqesin nivelet më të ulëta.

Figura nr. 8: Shkalla e papunësisë sipas qarqeve (2021)



Burimi: Strategjia Kombëtare të Punësimit dhe Aftësi 2023 – 2030

Këto të dhëna pasqyrojnë pabarazi të theksuara rajonale në tregun e punës, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në prirjet e migracionit dhe në vendimmarrjen e individëve për të emigruar, veçanërisht për arsye ekonomike.

Papunësia e lartë, sidomos në mesin e të rinjve, mbetet një nga faktorët kryesorë shtytës të emigracionit. Qarqe si Lezha dhe Vlora, që paraqesin nivele të larta të papunësisë, përkojnë shpesh me rajone ku migrimi veçanërisht ai sezonal dhe i të rinjve është më i përhapur.

Kukësi, ndonëse sipas statistikave zyrtare ka papunësi të ulët, mbetet historikisht një zonë me intensitet të lartë emigrimi, çka sugjeron se vendimmarrja për migrim nuk kushtëzohet vetëm nga mungesa e vendeve të punës, por edhe nga faktorë të tjerë ekonomikë dhe socialë, si pagat e ulëta, mungesa e shërbimeve publike, apo tradita migratore.

Megjithëse këto të dhëna evidentojnë një lidhje të qartë midis tregut të punës dhe emigracionit, Strategjia Kombëtare e Migracionit (SKM) nuk përfshin analiza të detajuara të papunësisë sipas qarqeve, duke humbur mundësinë për të shpjeguar emigrimin në nivel lokal.

Mungesa e lidhjes ndërmjet tregut të punës dhe migracionit, përmes treguesve territorialë të detajuar, e kufizon aftësinë e strategjisë për të identifikuar rajonet ku politikat e kthimit të emigrantëve apo nxitjes së punësimit lokal do të mund të ishin më efektive.

Si pasojë, politikat e migracionit rrezikojnë të mbeten shumë të përgjithshme dhe jo të targetuara, duke mos reflektuar specifikat socio-ekonomike të rajoneve me risk të lartë emigrimi.

Në mungesë të një analize të tillë, zvogëlohet mundësia për të ndërhyrë me masa të dedikuara në qarqe si Lezha dhe Vlora, ku papunësia e lartë dhe mungesa e alternativave ekonomike nxisin largimin e popullsisë aktive. Masa të tilla mund të përfshijnë subvencione për punësim, programe trajnimi profesional, apo incentiva fiskale për bizneset që punësojnë të rinj në këto zona.

Një integrim sistematik i të dhënave të tregut të punës dhe të migracionit do të mundësonte ndërtimin e hartave të riskut të emigrimit sipas qarqeve, duke lejuar qeverinë të orientojë më mirë burimet dhe të zbatojë politika të bazuara në evidenca, të afta për të frenuar shpopullimin dhe për të forcuar zhvillimin rajonal të qëndrueshëm.

Sipas një studimi të publikuar nga Komiteti i Çështjeve të Brendshme<sup>37</sup> të Mbretërisë së Bashkuar, publikuar më 12 qershor 2023, i bazuar në gjetjet e organizatës ndërkombëtare Swiss Contact, Qarku i Kukësit përbën një nga zonat me intensitetin më të lartë të emigracionit nga Shqipëria drejt Mbretërisë së Bashkuar.

<sup>37</sup> <https://committees.parliament.uk/publications/40291/documents/204657/default/>

Kjo prirje lidhet me ekzistencën e lidhjeve familjare dhe rrjeteve të migrimit të krijuara ndër vite nga brezat e mëparshëm të emigrantëve, të cilat kanë lehtësuar qasjen në strehim dhe punësim për migrantët e rinj.

Sipas sondazhit të zhvilluar nga Swiss Contact në këtë qark, 35% e të anketuarve kanë shprehur dëshirë për të emigruar dhe ndër ta, 59% kanë deklaruar Mbretërinë e Bashkuar si destinacion të preferuar. Rezultatet e sondazhit nënvizojnë se problemet ekonomike mbeten shtysa kryesore e këtij fenomeni. Më konkretisht:

- 58% e të anketuarve përmendin koston e lartë të jetesës si sfidën kryesore;
- 43% përmendin emigrimin e të rinjve;
- 42% raportojnë mungesë të mundësive të punësimit;
- 37% përmendin papunësinë tek të rinjtë;
- 35% evidentojnë varfërinë si problem dominues;
- dhe 21% nënvizojnë mungesën e nevojave bazike.

Në mënyrë domethënëse, 42% e të anketuarve pajtohen fuqimisht me deklaratën se “nuk ka zgjidhje tjetër për të rinjtë përveçse të emigrojnë jashtë vendit me të gjitha mjetet e mundshme”, ndërsa 31% besojnë se emigrimi i parregullt është një fenomen i pandalshëm.

Të dhënat konfirmojnë gjithashtu se Kukësi është qarku më i varfër në Shqipëri, me tregues socio-ekonomikë që qëndrojnë 30–40% nën mesataren kombëtare. Struktura e punësimit është e përqendruar kryesisht në sektorin bujqësor (70%), ndërsa vetëm 5% e të punësuarve janë në industri dhe pjesa tjetër në sektorin e shërbimeve, duke reflektuar mungesë diversifikimi ekonomik dhe varësi të lartë nga bujqësia tradicionale.

Këto gjetje ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi lidhjen e ngushtë midis varfërisë, papunësisë dhe emigracionit ekonomik në rajonet veriore të vendit, si Kukësi, dhe theksojnë nevojën që strategjitë kombëtare të migracionit dhe punësimit të mbështeten më fort në analiza territoriale për të targetuar zonat me risk të lartë emigrimi dhe mungesë mundësish zhvillimi.

### **Mungesa e të dhënave mbi moshën e emigrantëve dhe imigrantëve**

Pa një ndarje të qartë sipas moshës, strategjia nuk mund të vlerësojë grupet demografike më të prekura nga migracioni, si p.sh. të rinjtë në moshë pune apo personat në prag pensioni që migrojnë për arsye familjare. Të dhënat mbi moshën janë thelbësore për të kuptuar ndikimin e emigracionit në strukturën e popullsisë aktive dhe në procesin e plakjes së popullsisë, që është një ndër sfidat më të mëdha demografike për Shqipërinë.

Në mungesë të këtij treguesi, strategjia nuk mund të analizojë se çfarë grupmoshash po humb vendi, në cilat fusha ndodh kjo humbje dhe si ndikon në fuqinë punëtore, produktivitetin ekonomik apo në qëndrueshmërinë e sistemit të sigurimeve shoqërore. Kjo kufizon mundësinë për të ndërtuar objektiva të matshëm si, për shembull, ulja e emigrimit të të rinjve 20–34 vjeç ose rritja e përqindjes së të kthyerve në këtë grupmoshë. Politikat pa orientim moshor mbeten të përgjithshme dhe të paqarta në ndikim.

INSTAT nuk e kishte një informacion të tillë lidhur me moshën e emigrantëve. Ata kanë të dhëna mbi moshën vetëm të të huajve me leje qëndrimi në Shqipëri, në tabelën si vijon:

*Tabela nr. 10: Të huajt me leje qëndrimi në Shqipëri sipas grupmoshës, 2020-2024*

Grupmosha	Vitet				
	2020	2021	2022	2023	2024
<b>Deri 19</b>	1150	1390	1863	1891	1947
<b>20-29</b>	1729	2026	2865	3811	4356
<b>30-39</b>	2732	3042	3761	4829	5395
<b>40-49</b>	2512	2753	3227	3878	4283
<b>50-59</b>	2870	2935	3287	3491	2952

<b>Mbi 60 vjeç</b>	2616	2775	3148	3560	3007
<b>Totali</b>	<b>13609</b>	<b>14921</b>	<b>18151</b>	<b>21460</b>	<b>21940</b>

Burimi: INSTAT

### Mungesa e të dhënave mbi gjininë

Edhe pse në dokument përmendet “perspektiva gjinore” si fokus, nuk ekziston asnjë analizë statistikore sipas gjinisë. Ndarja gjinore e migracionit është e domosdoshme për të kuptuar nëse gratë apo burrat migrojnë më shumë, për çfarë arsye, në cilat sektorë punojnë jashtë vendit dhe si ndikon kjo në strukturën familjare, në kujdesin social dhe në tregun e punës në vendin e origjinës.

Migracioni gjinor ka pasoja të shumëfishta: emigracioni i burrave mund të çojë në feminizimin e varfërisë në zonat rurale, ndërsa emigracioni i grave shpesh lidhet me humbjen e rolit të tyre në familje dhe me sfida në mbrojtjen e të drejtave në vendet pritëse. Pa të dhëna të tilla, strategjia nuk mund të formulojë masa të diferencuara gjinore, si programe për punësimin e grave të kthyer apo politika për përfshirjen e burrave në proceset e riintegritimit.

Sikurse dhe me moshimin, INSTAT nuk kishte një informacion lidhur edhe me gjininë e emigrantëve. Ata kanë të dhëna mbi gjininë vetëm të të huajve me leje qëndrimi në Shqipëri, në tabelën si vijon:

Tabela nr. 11: Të huaj me leje qëndrimi në Shqipëri sipas gjinisë, 2020-2024

Vitet	Gjithsej	Meshkuj	Femra
<b>2020</b>	13,609	8,676	4,933
<b>2021</b>	14,921	9,400	5,521
<b>2022</b>	18,151	11,345	6,806
<b>2023</b>	21,460	13,691	7,769
<b>2024</b>	21,940	13,572	8,368

Burimi: INSTAT


### Mungesa e të dhënave mbi nivelin arsimor

Të dhënat mbi arsimimin e emigrantëve dhe imigrantëve janë ndër treguesit më të rëndësishëm për vlerësimin e ndikimit të migracionit në kapitalin njerëzor të vendit.

Raporti i Monitorimit Global për Arsimin<sup>38</sup> i UNESCO-s (2019) thekson se Shqipëria është ndër vendet me normën më të lartë të emigrimit të personave me arsim të lartë. Ky fenomen, i njohur si “ikja e trurit” (brain drain), po përbën një sfidë serioze për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror të vendit. Të dhënat e raportit tregojnë se më shumë se 20% e punëtorëve të kualifikuar shqiptarë jetojnë dhe punojnë jashtë vendit, duke e renditur Shqipërinë ndër vendet me humbje më të madhe të kapitalit njerëzor në Evropë.

<sup>38</sup> <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000265866>

Figura nr. 9: Migrimi i personave me arsim të lartë




Burimi: Raporti i Monitorimit Global për Arsimin i UNESCO-s (2019)

UNESCO vëren se ky proces nuk është thjesht migrim ekonomik, por largim sistematik i potencialit intelektual dhe profesional, i cili është produkt i investimeve publike në arsim. Në shumë vende të varfra ose me të ardhura të mesme, si Shqipëria, ky fenomen sjell si pasojë humbje të drejtpërdrejtë të fuqisë punëtore të kualifikuar.

Pavarësisht se raportet ndërkombëtare, përfshirë UNESCO-n, e identifikojnë Shqipërinë si një nga vendet me normën më të lartë të emigracionit të të arsimuarve, Strategjia Kombëtare për Migracionin 2024–2030 nuk përfshin asnjë referencë ndaj këtij fenomeni. Dokumenti nuk përmban të dhëna, analiza apo masa specifike që lidhen me emigracionin e punëtorëve të kualifikuar, me humbjen e kapitalit njerëzor apo me ndikimin që kjo ka në zhvillimin afatgjatë të vendit.

Mungesa e kësaj të dhëne përbën një boshllëk të theksuar. Në një kohë kur vendet e rajonit dhe të Bashkimit Evropian po ndërmarrin politika për të kthyer trurin (brain gain) përmes programeve të riintegritit profesional dhe inovacionit, Shqipëria nuk ka integruar ende një qasje të ngjashme në strategjinë e saj kombëtare.

Figura nr. 10: Të dhëna mbi emigrimin e popullsisë së arsimuar



Burimi: Raporti i Monitorimit Global për Arsimin i UNESCO-s (2019)

Kjo sjell që dokumenti të mbetet i kufizuar në adresimin e migracionit në mënyrë të përgjithshme, pa u përqendruar tek të rinjtë dhe të arsimuarit.

Gjithashtu, tregon se strategjia nuk mbështetet në analiza të plota të të dhënave ndërkombëtare dhe nuk e lidh politikëbërjen me sfidat reale të tregut të punës dhe të arsimit në Shqipëri. Mungesa e vlerësimit të “ikjes së trurit” pengon krijimin e politikave efektive për të mbajtur talentin brenda vendit, për të nxitur rikthimin e profesionistëve shqiptarë nga jashtë dhe për të harmonizuar arsimin me kërkesat e tregut të punës.

Në këtë mënyrë, dokumenti rrezikon të mos japë përgjigje të mjaftueshme ndaj procesit të plakjes së popullsisë dhe zbrazjes së fuqisë punëtore aktive, që janë pasoja të drejtpërdrejta të emigracionit të të rinjve dhe të arsimuarve. Pa këtë tregues, nuk është e mundur të ndërtohen objektiva të matshëm, si p.sh. rritja e shkallës së rikthimit të profesionistëve të kualifikuar apo përfshirja e tyre në sektorët prioritarë. Mungesa e analizës arsimore e bën politikën e migracionit më pak të ndjeshme ndaj tregut të punës dhe nevojave reale të ekonomisë.

### **Mungesa e të dhënave mbi arsyet e emigrimit**

Një nga mangësitë themelore të strategjisë është mungesa e një analize të qartë mbi shkaqet kryesore të emigracionit. Në dokument nuk bëhet dallim midis arsyeve ekonomike, sociale, arsimore apo politike që nxisin largimin nga vendi. Pa këtë dallim, masat e propozuara mbeten përgjithësuere dhe nuk adresojnë burimin real të problemit. Për shembull, nëse shumica e emigrantëve largohen për arsye ekonomike, politikat duhet të fokusohen në krijimin e vendeve të punës dhe mbështetjen e sipërmarrjes së të rinjve; nëse arsyeja është mungesa e arsimit cilësor, atëherë politika duhet të orientohet drejt sistemit arsimor. Pa të dhëna të tilla, objektivat nuk janë të matshëm dhe indikatorët e performancës nuk mund të llogariten me saktësi. Pas një kërkesë për informacion drejtuar INSTAT, ky i fundit u shpreh se nuk e zotëron këtë të dhënë.

### **Mungesa e ndarjes sipas natyrës së emigracionit (sezonal ose jo)**


Një tjetër mangësi lidhet me mungesën e dallimit mes emigracionit sezonal dhe emigracionit afatgjatë. Ky tregues është i rëndësishëm sepse ndihmon në përcaktimin e ndikimit të migracionit në tregun vendas të punës, në prodhimin bujqësor, në të ardhurat familjare dhe në qëndrueshmërinë sociale. Emigracioni sezonal mund të ketë efekte të ndryshme nga ai i përhershëm, dhe kërkon politika të veçanta mbështetëse, si marrëveshje dypalëshe pune, sigurime të përkohshme shoqërore apo skema të rikthimit të lehtësuar. Pa këtë ndarje, strategjia nuk arrin të diferencojë qartë natyrën e flukseve migratore dhe, për rrjedhojë, masat e ndërmarrja mbeten të njëjta për grupe që kanë nevoja krejt të ndryshme.

### **Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023 – 2030 (SKPA)**

Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030 synon të nxisë përfshirjen në tregun e punës, të rrisë aftësitë profesionale dhe të përmirësojë cilësinë e punësimit në Shqipëri.

Sipas SKPA-së, të dhënat tregojnë një rritje të ndjeshme të aktivitetit ekonomik gjatë periudhës 2012–2021. Numri i njësive ekonomike aktive, përfshirë ndërmarrjet dhe fermerët e regjistruar, është rritur me 74%, duke arritur në 181,549 njësi në fund të vitit 2021. Në të njëjtën periudhë, ndërmarrjet e mesme (10–49 punëtorë) u rritën me 76% (në 6,862), ndërsa ndërmarrjet e mëdha (mbi 50 punëtorë) u dyfishuan, duke arritur në 1,959. Zhvillimi i sektorit privat dhe formalizimi i tregut janë reflektuar edhe në tregun e punës: numri i kontribuesve në sigurimet shoqërore është rritur mesatarisht me 5.6% në vit, duke arritur në mbi 703 mijë në vitin 2021, nga 482 mijë në vitin 2014. Sektori privat përbën rreth 74% të totalit të kontribuesve.

Figura nr. 11: Të punësuar kontribues dhe ndërmarrjet aktive në Shqipëri 2014-2021




Burimi: INSTAT: Databaza Statistike – Tregu i punës dhe Regjistrat e biznesit

Sipas Strategjisë Kombëtare të Punësimit, treguesit e punësimit në Shqipëri tregojnë se shkalla e papunësisë është ulur nga 17.5% në vitin 2014 në 11.5% në vitin 2021. Kjo rënie sipas SKP lidhet me krijimin e vendeve të reja të punës, zhvillimin e sektorit privat dhe masat për reduktimin e ekonomisë informale. Bujqësia vazhdon të jetë sektori që punëson pjesën më të madhe të shqiptarëve, me 33.8% të të punësuarve në vitin 2021 (INSTAT).

Figura nr. 12: Shkalla e papunësisë, 2014-2021

Figura 3: Shkalla e papunësisë, 2014–2021



Marrë nga SKPA 2023-2030, burimi INSTAT

Sipas statistikave zyrtare, niveli i papunësisë është më i theksuar te personat me arsimim më të ulët, gratë, banorët në zonat rurale dhe qytete të vogla dhe ndër shtresat e tjera vulnerabël të popullsisë duke ndikuar në një masë edhe më të madhe në nivelin e varfërisë së tyre. Në mënyrë të dukshme, vajzat dhe gratë rezultojnë në një pozitë më të pafavorshme se meshkujt në të gjithë treguesit e punësimit në vend.

Krahas bujqësisë, sektorët që punësojnë më shumë punonjës në vend janë tregtia me pakicë (13.2%), shërbimet e ndryshme (11%), ndërtimi (10.1%), tregtia me shumicë (9.8%), shërbimi ushqimor (8.4%), tekstile dhe veshje (5.5%), industria e këpucëve (4.1%) etj., ndërkohë që punësimi në sektorët e tjerë të ekonomisë është në nivele më të ulëta. Ecuria e punësimit e viteve të fundit dëshmon se sektorët që kanë pasur rritjen relative më të lartë në vend, janë shërbimet e informacionit, industri të tjera përpunuese, shëndetësia, hoteleri-turizmi, programimi, tregtimi dhe riparimi i automjeteve dhe shërbime të tjera.

Megjithatë, ajo nuk mbështetet mjaftueshëm në të dhëna të detajuara demografike dhe socio-ekonomike që lidhen drejtpërdrejtë me dinamikën e shpopullimit dhe plakjes së popullsisë.

Në një kontekst ku vendi po përballet me rënie të ndjeshme të popullsisë aktive, emigracion të rinjve dhe rritje të moshës mesatare, mungesa e analizës së thelluar statistikore e kufizon ndjeshëm aftësinë e kësaj strategjie për të parashikuar, adresuar dhe frenuar efektet që këto procese kanë mbi tregun e punës dhe zhvillimin ekonomik afatgjatë.

Sipas Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023-2030, Shqipëria po përballet me një zvogëlim të popullsisë, si pasojë e rënies së lindjeve dhe emigracionit të vazhdueshëm, që ka sjellë një bilanc negativ të shtesës natyrore. Emigrimi ka ndryshuar në natyrë, duke përfshirë gjithnjë e më shumë fuqi punëtore të kualifikuara, çka ka krijuar mungesa për aftësi specifike në tregun vendas.

Një tjetër tendencë e dukshme është migrimi i brendshëm nga zonat rurale dhe qytetet e vogla drejt qendrave urbane, për shkak të mundësive më të mira për punësim dhe strehim. Sipas INSTAT, mesatarisht rreth 39 mijë persona në vit janë zhvendosur brenda vendit gjatë periudhës 2014–2020.

Strategjia eidenton gjithashtu pabarazitë rajonale në tregun e punës: shkalla e papunësisë në vitin 2021 varionte nga 22.6% në Lezhë dhe 19.5% në Vlorë, deri në 4% në Kukës dhe 4.7% në Gjirokastrë. Më shumë se 60% e të papunëve janë të papunë afatgjatë, çka tregon vështirësi të mëdha në riintegrimin në tregun e punës.

*Tabela nr. 12: Shkalla e papunësisë*

Grupmosha	Shkalla e Unemployment rate		papunësisë/			
	2019	2020	2021	2022	2023*	2024*
<b>Gjithsej</b>						
15-29	21.5	20.9	20.9	20.7	21.7	18.9
30-64	8.7	9.2	9.0	8.2	7.2	7.0
15-64	12.0	12.2	12.0	11.3	10.1	9.4
15+	11.5	11.7	11.5	10.9	9.5	8.5
<b>Meshkuj</b>						
15-29	21.3	20.8	20.5	20.7	21.6	18.8
30-64	8.8	8.8	8.7	7.6	6.8	6.3
15-64	12.2	12.0	11.8	10.9	9.9	8.9
15+	11.6	11.5	11.3	10.6	9.3	8.0
<b>Femra</b>						
15-29	21.7	21.1	21.4	20.7	21.9	19.0
30-64	8.5	9.6	9.4	8.8	7.6	7.8
15-64	11.8	12.4	12.4	11.7	10.3	10.0
15+	11.4	11.9	11.8	11.4	9.8	9.2

*Burimi i informacionit: Anketa e Forcave të Punës 2019-2024*

\*Rezultatet e Anketës së Forcave të Punës të paraqitura në këtë tabelë janë kalibruar bazuar në popullsinë e 1 janarit 2023, 1 janar 2024, sipas rezultateve të Cens të Popullsisë dhe Banesave 2023.

Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (SKPA) mbështetet në një bazë të dhënash statistikore për periudhën 2012–2021, që përfshin tregues mbi numrin e ndërmarrjeve aktive, rritjen e punësimit formal, uljen e papunësisë dhe shpërndarjen sektoriale të fuqisë punëtore. Këto të dhëna, të mbledhura kryesisht nga INSTAT për periudhën 2014–2021, ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi zhvillimet historike të tregut të punës në Shqipëri dhe mbi dinamikën e sektorëve ekonomikë që kanë gjeneruar vende pune gjatë dekadës së fundit.

Megjithatë, pavarësisht bazës solide statistikore për të kaluarën, strategjia nuk përfshin projeksione demografike për periudhën e zbatimit 2023–2030. Kjo do të thotë se, ndonëse dokumenti reflekton me saktësi ecurinë historike të tregut të punës, ai nuk parashikon ndikimin e plakjes së popullsisë në strukturën e punësimit në vitet që vijnë. Për shembull, mungon analiza e ndryshimit të raportit midis popullsisë aktive dhe asaj në pension, apo vlerësimi i ndikimit që ka emigracioni i të rinjve në mungesën e aftësive profesionale në sektorë të caktuar. Si rezultat, objektivat strategjikë janë të formuluar në mënyrë të përgjithshme dhe shpesh pa indikatorë të matshëm që lidhen me ruajtjen e potencialit demografik të vendit.

Një tjetër aspekt që kufizon qasjen gjithëpërfshirëse të SKPA lidhet me mungesën e analizës së detajuar mbi punësimin në zonat rurale. Edhe pse strategjia njih pabarazitë rajonale dhe thekson se papunësia është më e lartë në zonat rurale dhe në qytetet e vogla, ajo nuk mbështetet në një bazë të plotë statistikore që të shpjegojë në mënyrë të thelluar përmasat, shkaqet dhe tendencat e punësimit në këto zona. Kjo mangësi kufizon aftësinë e strategjisë për të adresuar një nga faktorët më të rëndësishëm që ushqejnë shpopullimin e qëndrueshëm dhe plakjen demografike të vendit.

Strategjia ofron disa tregues të përgjithshëm për pabarazitë rajonale në shkallën e papunësisë (p.sh. 22.6% në Lezhë, 19.5% në Vlorë, 4% në Kukës dhe 4.7% në Gjirokastër), por këto të dhëna nuk shoqërohen me analiza të brendshme për strukturën e punësimit rural. Në mënyrë të veçantë, mungojnë ndarjet statistikore sipas moshës, gjinisë dhe nivelit të arsimit të banorëve ruralë; mungojnë të dhënat mbi natyrën e punës (formale, informale, sezonale apo afatgjatë); si dhe mungon një analizë mbi sektorët dominues të punësimit rural – bujqësia, blegtoria apo shërbimet bazë – dhe prirjet e tyre në raport me migrimin.

Pa një ndarje të tillë, është e vështirë të kuptohet nëse zonat rurale po humbin kryesisht popullsinë e re dhe të aftë për punë, apo nëse ato po përballen me një proces më të shpejtë plakjeje sesa qendrat urbane. Në mungesë të këtyre të dhënave, politikat për zhvillimin e tregut të punës në territor mbeten të njëtrajtshme dhe nuk pasqyrojnë realitetet e ndryshme socio-ekonomike që karakterizojnë zonat urbane dhe ato rurale.

Për më tepër, strategjia përmend se rreth 39 mijë persona në vit janë zhvendosur brenda vendit gjatë periudhës 2014–2020, por nuk analizon në mënyrë sistematike strukturën e kësaj lëvizjeje: cilat rajone janë burime të migrimit, cilat janë destinacione, cilat grupmosha preken më shumë, dhe si lidhet kjo dinamikë me zhvillimin e tregut lokal të punës. Kjo mungesë e analizës territoriale e pengon strategjinë të kuptojë lidhjen midis mungesës së mundësive të punësimit rural dhe emigracionit ndërkombëtar, i cili në shumë raste përbën fazën përfundimtare të migrimit të brendshëm. Për rrjedhojë, masat që synojnë “krijimin e vendeve të punës në rajone” mbeten të përgjithshme dhe nuk bazohen në evidenca reale mbi nevojat lokale të tregut.

Mungesa e analizës statistikore për punësimin rural ka pasoja të drejtpërdrejta në përshejtimin e shpopullimit. Zonat rurale vazhdojnë të humbasin të rinjtë për shkak të mungesës së mundësive të punës dhe modernizimit të bujqësisë, ndërsa popullsia që mbetet është kryesisht më e moshuar, çka ul produktivitetin dhe rrit varësinë ekonomike nga transfertat publike dhe remitancat. Në këto kushte, strategjia nuk mund të masë efektivitetin e politikave të punësimit që synojnë mbështetjen e popullsisë aktive në zonat e braktisura dhe, për rrjedhojë, nuk arrin të parandalojë ritmet e shpopullimit që ushqejnë plakjen e popullsisë në nivel kombëtar.

Një element që do të mund të kishte përmirësuar ndjeshëm cilësinë analitike të Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive është përdorimi më i thelluar dhe i integruar i të dhënave statistikore nga INSTAT dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA). Të dy këto institucione gjenerojnë vazhdimisht informacione të vlefshme për strukturën e popullsisë,

zhvillimet demografike dhe tregun e punës, të cilat përbëjnë bazën kryesore për hartimin e politikave të punësimit të bazuara në evidenca.

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA) zotëron një bazë të dhënash administrative, që mund të përdoret për të përmirësuar monitorimin dhe parashikimin e dinamikave të tregut të punës. Këto të dhëna përfshijnë numrin e punëkërkuarve të regjistruar sipas moshës, gjinisë dhe arsimit, profesionet më të kërkuara, përhapjen rajonale të vendeve të punës të krijuara përmes programeve aktive të punësimit, si dhe efektivitetin e trajnimeve profesionale në përmirësimin e punësimit afatgjatë.

Megjithatë, në strategjinë aktuale këto burime nuk janë shfrytëzuar në mënyrë të plotë. Mungesa e integritetit ndërmjet statistikave të INSTAT-it dhe të dhënave administrative të AKPA-së kufizon aftësinë për të realizuar një analizë të sinkronizuar territoriale dhe demografike, që do të mundësonte politika më të sakta dhe të targetuara në nivel lokal. Një bashkëpunim më i strukturuar midis Ministrive përgjegjëse, INSTAT-it dhe AKPA-së do të garantonte ndërtimin e indikatorëve të harmonizuar për tregun e punës, sigurimin e të dhënave të përditësuara për vlerësimin e ndikimit të politikave në frenimin e emigracionit dhe ruajtjen e popullsisë aktive, si dhe rishikimin periodik të objektivave strategjike në përputhje me ndryshimet demografike dhe strukturën e tregut të punës.

Integrimi i të dhënave të INSTAT-it dhe AKPA-së do të rriste ndjeshëm cilësinë e planifikimit strategjik dhe efikasitetin e buxhetimit të politikave publike, duke e bërë Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive një instrument më të fortë për t'u përballur me sfidat e shpopullimit dhe plakjes së popullsisë.

Në përmbledhje, Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030 mbështetet në mënyrë të pjesshme në të dhëna statistikore të verifikuara, kryesisht për treguesit ekonomikë dhe të punësimit. Dokumenti ofron një pasqyrë mbi zhvillimet në tregun e punës gjatë dekadës së fundit, duke reflektuar qartë ndikimin e formalizimit, rritjes së sektorit privat dhe uljes së papunësisë.

Megjithatë, përdorimi i të dhënave demografike dhe territoriale mbetet i kufizuar. Mungesa e projeksioneve për popullsinë aktive dhe e analizës së detajuar për punësimin në zonat rurale kufizon aftësinë e strategjisë për të parashikuar ndikimin e moshimit dhe për të hartuar objektiva të matshëm në funksion të frenimit të shpopullimit.

Në thelb, strategjia ndërtohet mbi një bazë të vlefshme informacioni ekonomik, por nuk e integron plotësisht dimensionin demografik, duke e bërë të nevojshme forcimin e analizës mbi strukturën e popullsisë dhe shpërndarjen territoriale të punësimit për të garantuar politika më efektive dhe gjithëpërfshirëse në një kontekst të popullsisë në moshim.

Nga analiza e **Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022–2029**, rezulton se dokumenti bazohet pjesërisht në të dhëna statistikore, kryesisht të siguruar nga INSTAT, Ministria e Arsimit dhe Rinisë, AKPA, dhe institucione ndërkombëtare si UNICEF.

Strategjia përfshin disa tregues të rëndësishëm të lidhur me gjendjen e të rinjve, të cilët janë marrë nga:

- Anketa e Forcave të Punës / INSTAT – për treguesit e pjesëmarrjes në trajnime dhe punësim;
- Anketa e Përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit / INSTAT – për aftësitë digjitale të të rinjve;
- Publikimi UNICEF–INSTAT “Treguesit e Mirëqenies së Fëmijëve, Adolehentëve dhe të Rinjve 2016–2019” – për edukimin dhe cilësinë e jetës së të rinjve
- Të dhënat administrative nga AKPA dhe MFE – për pjesëmarrjen në tregun e punës dhe programet e nxitjes së punësimit

Dokumenti përfshin një numër treguesish të matshëm:

- Shkalla e papunësisë së të rinjve (15–24 vjeç): 20.9% në vitin 2021 (20.5% meshkuj, 21.4% femra) – burimi INSTAT;
- Shkalla e pjesëmarrjes së të rinjve në tregun e punës: 52.5% (58.6% meshkuj, 46.3% femra) – burimi INSTAT;
- Përqindja e të rinjve që janë përfshirë në programet e nxitjes së punësimit: 45% – burimi AKPA

Dokumenti mbështetet në mënyrë të pjesshme në të dhëna statistikore të verifikuara. Edhe pse shumë tregues kanë burime të qarta (INSTAT, UNICEF, AKPA), mungon një analizë përmbledhëse demografike për grupmoshën rinore (si shpërndarja sipas rajonit, arsimit apo statusit ekonomik), dhe nuk ka projeksione për popullsinë e re apo prirjet migratore.

Në disa pjesë të strategjisë theksohet vetë mungesa e të dhënave të sakta mbi punësimin dhe zhvillimin rinor, duke u cilësuar si pengesë për planifikim efektiv të politikave.

Strategjia parashikon bashkëpunim të vazhdueshëm me INSTAT dhe AKPA për ndërtimin e një baze të dhënash për organizatat dhe rininë, si dhe për përditësimin e treguesve rinorë me qëllim politikë-bërës.

Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022–2029 mbështetet në mënyrë të pjesshme dhe selektive në të dhëna statistikore zyrtare. Ajo përfshin tregues bazë për arsim, punësim dhe mirëqenie të të rinjve, por nuk shfrytëzon plotësisht potencialin analitik të të dhënave kombëtare dhe rajonale, veçanërisht për të analizuar prirjet e migracionit rinor dhe ndikimin demografik të tyre. Kjo tregon nevojën për forcim të bashkëpunimit ndërinstitucional me INSTAT dhe AKPA për ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm të monitorimit të situatës rinore në nivel kombëtar dhe vendor.

Nga analiza e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022–2029 dhe lidhja e saj me Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023–2030, rezulton se punësimi i të rinjve trajtohet si një prioritet i përbashkët, por me qasje të pjesshme dhe jo të integruar në nivel rajonal apo rural.

### **Punësimi i të rinjve dhe pabarazitë territoriale**

Strategjia e Rinisë parashikon nxitjen e novacionit dhe rritjen e aftësive profesionale të të rinjve për hyrjen në tregun e punës. Sipas të dhënave të INSTAT, shkalla e papunësisë për grupmoshën 15–24 vjeç ishte 20.9% në vitin 2021, me një diferencë gjinore të lehtë në dëm të vajzave (21.4% kundrejt 20.5% për djemtë). Por pas konfirmimit të këtyre të dhënave në INSTAT, del që në strategji nuk janë referuar të sakta këto shifra pasi sipas INSTAT, gjatë vitit 2021 shkalla e papunësisë për grupmoshën 15-24 vjeç është 27.1%, ku 25.5 % janë djemtë/burra dhe 29.2% janë vajza/gra.


Tabela nr. 13: Punësimi i të rinjve, 2019-2024

				2019	2020	2021	2022	2023	2024
Gjithsej	15-24	Gjithsej	Shkalla e papunësisë	27,2	26,5	27,1	24,9	24,5	22,8
		Arsim 8/9 vjeçar	Shkalla e papunësisë	18,4	19,3	28,4	21,5	18,7	18,2
		Arsim të mesëm	Shkalla e papunësisë	28,9	27,1	24,0	24,0	28,9	26,2
		Arsim të lartë	Shkalla e papunësisë	34,7	32,9	32,9	32,5	21,4	21,0
Burra	15-24	Gjithsej	Shkalla e papunësisë	27,8	27,0	25,5	24,1	22,7	22,8
		Arsim 8/9 vjeçar	Shkalla e papunësisë	24,1	21,1	27,8	21,7	21,2	21,5
		Arsim të mesëm	Shkalla e papunësisë	28,1	27,7	24,7	24,1	24,9	25,3
		Arsim të lartë	Shkalla e papunësisë	35,5	34,2	22,8	29,9	15,8	14,5
Gra	15-24	Gjithsej	Shkalla e papunësisë	26,3	25,9	29,2	25,9	27,2	22,8
		Arsim 8/9 vjeçar	Shkalla e papunësisë	8,9	16,5	29,1	21,2	13,5	10,7
		Arsim të mesëm	Shkalla e papunësisë	30,6	25,9	22,8	23,8	36,4	28,0
		Arsim të lartë	Shkalla e papunësisë	34,3	32,0	37,7	34,0	24,0	24,2

Burimi: INSTAT


Figura nr. 13: Shkalla e papunësisë

**Shkalla e papunësisë për të rinjtë 15-24 vjeç, sipas gjinisë**




Shpjegimi: Përqindja e të papunëve ndër të rinjtë 15-24 vjeç ndaj forcës së punës në grupmoshën përkatëse  
Burimi: Anketa e Forcës së Punës / INSTAT

**Shkalla e papunësisë afatgjatë tek të rinjtë 15-24 vjeç, sipas gjinisë**



Shpjegimi: Përqindja e të papunëve afatgjatë (për 12 muaj e më shumë) ndër të rinjtë 15-24 vjeç ndaj forcës së punës në grupmoshën përkatëse  
Burimi: Anketa e Forcës së Punës / INSTAT


**Të rinjtë 15-24 vjeç jo në punësim, jo në trajnim dhe as duke ndjekur shkollën, sipas gjinisë**



Shpjegimi: Përqindja e të rinjve 15-24 vjeç jo në punësim, jo në trajnim dhe as duke ndjekur shkollën në 4 javët e mëparshme ndaj popullsisë së të njëjtës grupmoshë  
Burimi: Anketa e Forcës së Punës / INSTAT

Figura nr. 14: Shkalla e papunësisë te të rinjtë në Europë

**Shkalla e papunësisë tek të rinjtë sipas vendeve të Europës (në %)**  
(T4 2024)



Burimi: Eurostat, Instat • Ky grafik është krijuar nga "Scan Intel" 39

Grafiku tregon se Shqipëria renditet ndër vendet me shkallën më të lartë të papunësisë tek të rinjtë në Europë, me rreth 19% në T4 2024, dukshëm mbi mesataren e BE-së dhe shumë më e lartë se vendet e Europës Qendrore dhe Veriore. Ky nivel i lartë i papunësisë sinjalizon vështirësi strukturore në integrimin e të rinjve në tregun e punës, veçanërisht në ofrimin e vendeve të punës të qëndrueshme dhe cilësore.

Në këtë kontekst, papunësia e lartë e të rinjve përbën një faktor shtytës kryesor për emigracionin, duke e bërë Shqipërinë një nga vendet me prirjen më të fortë për largimin e popullsisë së re. Mungesa e perspektivës së punësimit në vend, krahas diferencave të theksuara në paga dhe kushte jetese me vendet e BE-së, nxit emigrimin afatgjatë të të rinjve, me pasoja direkte në plakjen e popullsisë, tkurrjen e fuqisë punëtore dhe humbjen e kapitalit njerëzor.

**Punësimi i të rinjve sipas sektorëve**

Sipas të dhënave të INSTAT (raporti me UNICEF, 2021), gjatë periudhës 2016–2019, struktura e punësimit të të rinjve 15–24 vjeç ka pësuar ndryshime modeste, por domethënëse për kuptimin e dinamikave ekonomike dhe migratore.

Tabela nr. 14: Shkalla e punësimit të të rinjve 15-24 vjeç, sipas sektorit

	2016			2017			2018			2019		
	15-17	15-19	15-24	15-17	15-19	15-24	15-17	15-19	15-24	15-17	15-19	15-24
Bujqësi	75.3	63	37.6	81.5	63	33	81.9	66.1	40.5	84.4	70.6	45.7
Industri	5.3	10.7	13.6	4.4	10.7	15.4	6.3	8.5	11.8	8.4	9.4	11.5
Ndërtim	3.7	3.2	6.7	1.7	3.2	5.2	0.1	2.3	4.4	0.9	2.1	3.9
Shërbime	15.7	23.1	42.1	12.3	23.1	46.4	11.7	23.1	43.3	6.3	17.9	38.9

Burimi: INSTAT

Në vitin 2016, bujqësia përfshinte 37.6% të punësimit të të rinjve, duke qenë sektori më i madh i angazhimit rinor, ndërsa shërbimet përbënin 42.1%, industria 13.6%, dhe ndërtimi 6.7%. Në vitin 2019, bujqësia u rrit në 45.7%, duke treguar se një pjesë e konsiderueshme e të rinjve vijojnë të punojnë në sektorin bujqësor, shpesh në mënyrë joformale dhe me produktivitet të

<sup>39</sup> <https://scantv.al/scan-intel/analiza/paradoksi-i-punesimit-ne-shqiperi-papunesia-e-te-rinjve-ne-rr-i22638>

ulët. Sektori i shërbimeve, përkundrazi, ra në 38.9%, ndërsa industria pati një rënie të lehtë në 11.5%, dhe ndërtimi u tkurr në 3.9%.

Këto të dhëna tregojnë se, ndryshe nga pritshmëritë e zhvillimit ekonomik dhe urbanizimit, bujqësia vazhdon të jetë sektori dominant i punësimit rinor, duke reflektuar mungesën e alternativave të qëndrueshme për punësim në sektorë më modernë. Kjo situatë përforcon varësinë e të rinjve nga ekonomia rurale tradicionale dhe, në shumë raste, i shtyn drejt emigrimit sezonal ose të përhershëm, sidomos në zonat me pak diversifikim ekonomik.

Nga ana tjetër, rënia e punësimit në sektorin e shërbimeve që është sektori më dinamik dhe me potencial për inovacion, teknologji dhe turizëm, tregon mungesë të politikave efektive për orientimin e të rinjve drejt tregjeve të reja të punës. Në ditët e sotme, ky është sektori që ofron më shumë mundësi për zhvillim të aftësive digjitale, punë me vlerë të shtuar dhe përfshirje në ekonominë e dijes.

Ndërkohë, Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030 mund të shërbente si bazë për ta integruar këtë qasje me politika më të synuara drejt përgatitjes së fuqisë punëtore rinore për sektorët në zhvillim, si teknologjia, industria përpunuese dhe shërbimet digjitale.

Në përfundim, të dhënat tregojnë qartë se ekonomia shqiptare ka ende një bazë të fortë rurale, e cila ndikon drejtpërdrejt në emigrimin e të rinjve dhe në plakjen e popullsisë aktive. Një strategji e bazuar në evidenca duhej të kishte vendosur objektiva të matshëm për zhvendosjen graduale të punësimit rinor drejt sektorëve me vlerë të shtuar, duke krijuar mundësi reale që të rinjtë të qëndrojnë dhe të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të vendit.


### Emigrimi i të rinjve dhe mungesa e analizës statistikore

Dokumenti e njuh largimin e të rinjve nga vendi si një fenomen shqetësues, por nuk përmban të dhëna statistikore të detajuara mbi përmasat, moshën apo arsyet e emigrimit. Mungon, për shembull:

- analiza e raportit midis papunësisë dhe prirjes për emigrim;
- të dhënat për emigrimin sezonal apo afatgjatë të të rinjve;
- ndarja sipas nivelit arsimor apo gjinisë.

Në ndryshim, Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive përfshin referenca më të qarta për emigracionin ekonomik si pasojë e mungesës së vendeve të punës në zonat rurale dhe të pagave të ulëta, duke theksuar se emigrimi i të rinjve është një faktor që dobëson bazën aktive të tregut të punës. Pra, ndërsa strategjia e punësimit e trajton emigracionin si pasojë ekonomike të pabarazive rajonale dhe mungesës së formimit profesional, strategjia e rinisë e përmend atë vetëm në mënyrë përshkruese, pa analizë të bazuar në të dhëna.

Figura nr. 15: Largimi para kohe nga shkollimi dhe trajnimi tek të rinjtë 18-24 vjeç, sipas gjinisë



Burimi: INSTAT

Sipas të dhënave të INSTAT, të publikuara në raportin e përbashkët me UNICEF (2021) mbi Treguesit e Mirëqenies së Fëmijëve, Adoleshentëve dhe të Rinjve në Shqipëri, fenomeni i largimit të parakohshëm nga arsimi dhe trajnimi profesional përbën një sfidë të vazhdueshme për grupmoshën 18–24 vjeç.

Të dhënat tregojnë se gjatë periudhës 2016 – 2019, niveli i braktisjes së arsimit mbetet i lartë:

- në vitin 2016, 21.6% e meshkujve dhe 17.3% e femrave u larguan nga arsimi apo trajnimi, duke çuar përqindjen totale në 19.6%;
- në 2017, përqindjet ishin pothuajse të njëjta (21.6% meshkuj dhe 17.2% femra, total 19.6%);
- në 2018, niveli ra lehtë në 18.3% për meshkujt dhe 16.4% për femrat (total 17.4%);
- ndërsa në 2019, përqindja totale e të rinjve që kishin lënë arsimin ishte ende 16.3%, me 17.5% meshkuj dhe 15.1% femra.

Këto shifra tregojnë një tendencë të qëndrueshme të largimit të një në çdo gjashtë të rinj nga sistemi arsimor dhe trajnimi profesional, çka nënkupton një potencial të humbur për zhvillimin e kapitalit njerëzor në vend. Braktisja e hershme nga arsimi përbën një nga faktorët kryesorë që çon në papunësi afatgjatë, përfshirje të ulët ekonomike dhe, në shumë raste, emigrim të parakohshëm, veçanërisht në zonat ku mungojnë mundësitë lokale për punësim apo arsim profesional.

Tabela nr. 15: Popullsia mesatare sipas qarqeve, 0-17 vjeç

### Popullsia mesatare

Femijë (0-17 vjeç) sipas qarqeve dhe sipas gjinisë

Qarku	2018			2019		
	Meshkuj	Femra	Total	Meshkuj	Femra	Total
Berat	13,976	13,445	27,421	13,236	12,871	26,107
Dibër	15,579	14,391	29,970	15,008	13,986	28,994
Durrës	32,082	30,445	62,527	31,358	29,987	61,345
Elbasan	31,807	30,621	62,428	30,492	29,598	60,090
Fier	32,929	31,385	64,314	31,352	30,238	61,590
Gjirokastrë	6,497	6,189	12,686	6,013	5,893	11,906
Korçë	23,720	22,129	45,849	22,644	21,333	43,977
Kukës	10,085	9,315	19,400	9,854	9,147	19,001
Lezhë	14,271	13,951	28,222	13,623	13,526	27,149
Shkodër	22,632	21,854	44,486	21,654	21,025	42,679
Tiranë	95,819	90,302	186,121	95,051	89,444	184,495
Vlorë	19,479	18,171	37,650	18,744	17,653	36,397
<b>Total</b>	<b>318,876</b>	<b>302,198</b>	<b>621,074</b>	<b>309,029</b>	<b>294,701</b>	<b>603,730</b>

Burimi: INSTAT

Tabela nr.16: Popullsia banuese sipas qarkut dhe grupmoshës, viti 2023

	0-14	15-64	65+	Total
<b>Gjithsej</b>	<b>373929</b>	<b>1555080</b>	<b>473104</b>	<b>2402113</b>
Berat	18346	90381	32229	140956
Dibër	18690	70620	17868	107178
Durrës	38002	147874	40987	226863
Elbasan	35563	151278	45739	232580
Fier	34068	149555	56754	240377
Gjirokastrë	6908	36350	16755	60013
Korçë	23663	108534	40894	173091
Kukës	12990	40859	8149	61998
Lezhë	16302	63513	19569	99384
Shkodër	23569	98471	32439	154479
Tiranë	126699	508596	123218	758513
Vlorë	19129	89049	38503	146681

Burimi: INSTAT

Qarqe si Kukësi, Berati, Dibra, Lezha dhe Gjirokastra kanë numër më të vogël të fëmijëve dhe një tendencë rënëse të popullsisë së re, duke reflektuar emigrimin familjar të vazhdueshëm dhe mungesën e perspektivës për punësim lokal. Në këto zona, potenciali i punësimit rinor është në tkurrje. Strategjia Kombëtare e Rinisë nuk e trajton këtë hendek rajonal në dritën e të dhënave demografike, duke humbur mundësinë për të planifikuar politika të synuara për ruajtjen e popullsisë aktive në qarqet më të prekura nga emigracioni. Rënia e numrit të fëmijëve në moshë shkollë është një tregues i qartë i tkurrjes së rezervës së ardhshme të fuqisë punëtore, sidomos në zonat me emigracion të lartë. Pa ndërhyrje të koordinuara për të rritur mundësitë e punësimit për të rinjtë dhe për të frenuar emigrimin, Shqipëria do të përballet me mungesa të ndjeshme të fuqisë punëtore në dekadën e ardhshme, duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen ekonomike dhe në qëndrueshmërinë e sistemit të pensioneve.

Megjithatë, Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022 – 2029 nuk përfshin asnjë analizë apo tregues të këtij fenomeni, pavarësisht se raporti INSTAT–UNICEF e identifikon si një nga problemet më serioze për grupmoshën e re. Strategjia e përmend shkurtimisht emigrimin si një sfidë, por nuk e lidh me faktorë si braktisja e hershme e shkollës apo mungesa e trajnimit profesional. Mungesa e kësaj lidhjeje kufizon aftësinë e strategjisë për të adresuar shkaqet themelore të migracionit rinor.

### **Politikat e riatdhesimit dhe integritit të të rinjve të kthyer**

Në Strategjinë e Rinisë nuk gjenden politika të posaçme për riatdhesimin e të rinjve që kanë emigruar, as masa për integrimin e tyre në tregun vendas të punës. Dokumenti përqendrohet në “ndryshimin e perceptimeve për punësimin në vend”, por nuk parashikon masa konkrete për kthimin e trurit (brain gain) apo përfshirjen e të rinjve të kthyer në programe punësimi, ndonëse këto janë shtylla të rëndësishme të Strategjisë Kombëtare të Migracionit 2022–2030 dhe të Strategjisë së Punësimit.

Kjo mungesë tregon një moskoordinim ndërsektorial: ndërsa politika e punësimit adreson riintegrimin përmes shërbimeve të punësimit dhe programeve të nxitjes, strategjia e rinisë nuk parashikon as instrumente financiare dhe as mekanizma bashkëpunimi për këtë grup.

Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022–2029 mbështetet në disa të dhëna të INSTAT për punësimin, por nuk e thëllon analizën sipas rajoneve apo grupeve të riskut. Ajo nuk përdor të dhëna mbi emigrimin/imigrimin e të rinjve, as mbi faktorët ekonomikë dhe socialë që e nxisin atë.

Në të kundërt, Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030 ofron një pasqyrë më të plotë të pabarazive rajonale dhe të ndikimit të tyre në punësim, duke evidentuar më qartë sfidat në zonat rurale dhe lidhjen midis mungesës së punës dhe emigrimit.

Në mungesë të kësaj qasjeje të integruar, politikat rinore mbeten më shumë deklarative sesa të mbështetura në analiza empirike dhe efektive për të frenuar emigrimin e brezit të ri dhe riintegrimin e të rinjve që janë riatdhesuar.

**7. Gjetje nga auditimi:** Strategjia Kombëtare e Migracionit 2023–2030 përdor pjesërisht të dhëna nga burime kombëtare dhe ndërkombëtare si INSTAT, EUROSTAT etj., pa i shfrytëzuar ato në mënyrë të integruar për një analizë më të thelluar. Në dokument mungojnë të dhëna të detajuara mbi moshën, gjininë, arsimin, profesionin, arsyet e migrimit dhe ndarjen sipas rajoneve, si dhe nuk janë përfshirë projeksione për periudhën 2024–2030. Në këtë kontekst, roli i INSTAT si prodhuesi kryesor i statistikave zyrtare në Republikën e Shqipërisë mbetet i pashfrytëzuar plotësisht. Duke qenë se misioni i tij është prodhimi i statistikave asnjënjë, transparente dhe të përditësuara për zhvillimet ekonomiko-sociale në vend, mungesa e integritit sistematik të të dhënave dhe projeksioneve të tij në dokumentin strategjik dobëson bazën analitike të politikave të migracionit. Si pasojë, masat e parashikuara nuk mbështeten në një bazë statistikore gjithëpërfshirëse që të lejojë vlerësimin e ndikimit të migracionit në tregun

e punës, strukturën demografike dhe zhvillimin rajonal, duke e lënë strategjinë kryesisht në nivel përshkrues dhe pa instrumente të qarta për parashikimin dhe menaxhimin afatgjatë të flukseve migratore.

**8. Gjetje nga auditimi:** Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030 mbështetet në një bazë të mirë statistikore për periudhën 2012–2021, duke përfshirë tregues mbi punësimin formal, ndërmarrjet aktive dhe uljen e papunësisë. Megjithatë, ajo mbetet e kufizuar në analizën e dinamikave të reja të tregut të punës. Strategjia nuk përfshin projeksione demografike dhe mungon vlerësimi i ndikimit të plakjes së popullsisë dhe emigracionit të rinjve në fuqinë punëtore. Gjithashtu, mungon një analizë e detajuar për zonat rurale, të cilat përballen me nivele më të larta papunësie dhe shpopullimi. Përdorimi i kufizuar i të dhënave të INSTAT-it dhe Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) pengon ndërtimin e politikave të targetuara në nivel rajonal dhe social. Kjo e bën të vështirë orientimin e masave për zhvillimin e qëndrueshëm të tregut të punës dhe frenimin e migracionit ekonomik.

**9. Gjetje nga auditimi:** Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022–2029 mbështetet në mënyrë të pjesshme në të dhëna statistikore, të marra kryesisht nga INSTAT, AKPA dhe UNICEF, por mungon një analizë e plotë demografike dhe socio-ekonomike e grupmoshës rinore. Dokumenti përfshin disa tregues mbi punësimin, pjesëmarrjen në tregun e punës dhe arsimin, por në disa raste përdor të dhëna jo të përditësuara ose të pasakta në krahasim me burimet zyrtare të INSTAT-it. Sipas të dhënave zyrtare të publikuara nga Instituti i Statistikave, për vitin 2021 shkalla e papunësisë për grupmoshën 15–24 vjeç është 27.1%. Nga kjo, 25.5% i përkasin djemve/burrave dhe 29.2% vajzave/grave. Ndërkohë, në strategji është cituar një nivel papunësie prej 20.9% (21.4% për vajzat dhe 20.5% për djemtë), shifra që nuk përputhen me të dhënat zyrtare të INSTAT. Kjo tregon se në dokumentin strategjik janë përdorur të dhëna të pasakta për vitin 2021.

Mungon një analizë përmbledhëse demografike për grupmoshën rinore (si shpërndarja sipas rajonit, arsimit apo statusit ekonomik), dhe nuk ka projeksione për popullsinë e re apo prirjet migratore. Mungesa e ndarjes rajonale apo rurale e treguesve e kufizon aftësinë për të identifikuar rajonet me risk më të lartë të papunësisë rinore dhe emigrimit. Po ashtu, strategjia nuk përmban analiza mbi arsyet, moshën apo përmasat e emigrimit të rinjve, dhe nuk i lidh qartë këto prirje me tregun e punës dhe me arsimimin. Të dhënat e UNICEF–INSTAT për braktisjen e hershme të arsimit, të cilat janë tregues kyç për emigracionin dhe punësimin e ardhshëm, nuk janë integruar në mënyrë analitike në dokument. Strategjia gjithashtu nuk adreson mungesën e politikave për riatdhesimin dhe integrimin e rinjve të kthyer.

**3. Konkluzion:** Strategjitë kombëtare për migracionin, punësimin dhe zhvillimin rinor tregojnë një përpjekje për të adresuar sfidat sociale dhe ekonomike, por mbeten të kufizuara nga mungesa e bazës së plotë statistikore dhe e analizave të detajuara. Konstatohet se strategjitë nuk përfshijnë analiza rajonale, gjinore dhe demografike, nuk përdorin projeksione për popullsinë aktive dhe nuk ofrojnë të dhëna mbi punësimin rural, duke e bërë dokumentin më shumë një udhëzues orientues sesa një instrument politikash të matshme. Kjo situatë pengon planifikimin e qëndrueshëm të politikave të punësimit, arsimit dhe riintegrimin, ndikon negativisht në përdorimin efikas të burimeve publike dhe kufizon institucionet për të ndërhyrë në mënyrë të synuar në zonat me risk të lartë emigrimi.

Mungesa e analizës mbi emigracionin ekonomik, sezonal dhe të kualifikuar, si dhe lidhjes ndërmjet arsimit, punësimit dhe emigracionit rinor, e bën strategjinë deklarative dhe jo parashikuese, duke reduktuar efektivitetin e masave për ruajtjen e kapitalit njerëzor dhe frenimin e ikjes së rinjve dhe të trurit. Si rezultat, dokumenti nuk arrin të projektojë ndikimet afatgjata të emigracionit mbi fuqinë punëtore, raportin e varësisë demografike, shpopullimin

dhe plakjen e vendit, duke vënë në rrezik integrimin social, zhvillimin ekonomik dhe efektivitetin e politikave publike.

**7.1 Rekomandim:** Instituti i Statistikave (INSTAT) të bashkëpunojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit për Migracionin dhe Azilin në Ministrinë e Brendshme, Gjendjen Civile dhe institucionet e tjera përgjegjëse, për krijimin e një baze të unifikuar dhe të përditësuar të të dhënave për migracionin, që të përfshijë informacion mbi moshën, gjininë, arsimin, profesionin dhe rajonin e origjinës.

**Në vijimësi**

**8.1 Rekomandim:** Instituti i Statistikave, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit për Migracionin dhe Azilin në Ministrinë e Brendshme dhe Gjendjen Civile, të publikojë në faqen e saj zyrtare të dhënat mbi migracionin, duke përfshirë moshën, gjininë, arsimin, profesionin dhe rajonin e origjinës, në mënyrë të rregullt dhe të përditësuar, për të garantuar transparencë dhe llogaridhënie

**Brenda vitit 2026 dhe në vijimësi**

**9.1 Rekomandim:** Instituti i Statistikave, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (AKPA), Ministria e Financave, të bashkëpunojnë midis tyre si dhe me institucionet e tjera përgjegjëse për ndërtimin e një sistemi të integruar të të dhënave që përfshin tregun e punës dhe të dhënat rinore, duke harmonizuar informacionin mbi arsimin, punësimin dhe migracionin e të rinjve. Ky sistem duhet të mundësojë politika të bazuara në evidenca, të orientuara sipas nevojave territoriale dhe demografike, dhe të përdoret për të hartuar masa që synojnë rritjen e përfshirjes së të rinjve në tregun vendas të punës.

**Në vijimësi**

### 5.2.2 A sigurojnë burimet financiare mbështetjen e nevojshme për të mundësuar arritjen e objektivave kombëtare në moshimin e popullsisë?

Buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, ka ardhur duke u rritur nga viti 2020 deri në vitin 2025.

Tabela nr. 17: Buxheti i MSHMS për periudhën 2020-2025 (në milion lekë)

Buxheti MSHMS	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	
	Fakt	Fakt	Fakt	Fakt	Fakt	Plan	Fakt 9M
	67,811.7	78,360.3	77,224.5	76,240.1	78,794.7	80,637.1	54,640.5

Burimi: Ministria e Financave

Nga të gjitha programet e buxhetit të MSHMS-së si të lidhur me temën tonë të auditimit kemi identifikuar programin “Përkujdesi Social” i cili ka në fokus mbështetjen financiare të kategorive në nevojë nëpërmjet shtyllave kryesore, që janë Ndhima Ekonomike, Pagesa e Aftësisë së Kufizuar, Bonusi i bebes, programi i mbështetjes së veçantë për gratë e papuna, me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç dhe financimi i shërbimeve të Përkujdesit Social. Referuar të dhënave të paraqitura në tabelën në vijim vlera e programit “Përkujdesi Social” po ashtu ka pësuar një rritje nga viti 2020 në vitin 2024. Vërehet se në vitin 2025 planifikimi i buxhetit për këtë program është 27,460.2 milion lekë dhe për 9 mujorin 2025 është realizuar në vlerën 18,292.1 milionë lekë.

Tabela nr. 18: Buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Programi “Përkujdesi Social” për periudhën 2020-2025 (në milionë lekë)

Buxheti MSHMS	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	
Programi	Fakt	Fakt	Fakt	Fakt	Fakt	Plan	Fakt 9M
Përkujdesi Social	27,756.1	28,215.8	29,486.5	30,187.0	30,332.7	27,460.2	18,292.1

Burimi: Ministria e Financave

Nga 14 produkte që ka “Programi i Përkujdesit Social”, referuar përshkrimin të produkteve dhe aktiviteteve që ndërmerren në arritje të qëllimeve të këtij programi, është identifikuar një produkt i lidhur me temën tonë të auditimit, konkretisht “Bonusi i bebes”.

### **Ndihma financiare e dhënë për nënat me foshnja të porsalindura nuk ka ndikuar në rritjen e numrit të lindjeve në Shqipëri.**

#### *Ndihma e menjëhershme financiare për nënat me foshnja të porsalindura (Bonusi i bebes)*

Në vijim të prioriteteve strategjike dhe politikave mbështetëse të Qeverisë Shqiptare, që nga janari i vitit 2019 e në vazhdimësi, po aplikohet “bonusi i bebes”, i cili është në stimul financiar për mbështetjen e familjeve të reja, rritjen e numrit të lindjeve dhe zhvillimin e shoqërisë<sup>40</sup>. “Bonusi i bebes” është një skemë mbështetje financiare për nënat e reja e cila ka për qëllim dhënien e ndihmës së menjëhershme nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për nënat me foshnje të porsalindura. Konkretisht, ndihma financiare (bonusi) jepet si vijon<sup>41</sup>:

- a) Në masën 40,000 (dyzet mijë) lekë për lindjen e fëmijës së parë;
- b) Në masën 80,000 (tetëdhjetë mijë) lekë për lindjen e fëmijës së dytë;
- c) Në masën 120,000 (njëqind e njëzet mijë) lekë për lindjen e fëmijës së tretë dhe fëmijëve të tjerë në vijim;
- ç) Për nënat që lindin binjakë, masa e përfitimit do të jetë në masën 80,000 (tetëdhjetë mijë) lekë për secilin fëmijë;
- d) Për nënat që lindin trinjakë dhe më shumë, masa e përfitimit do të jetë në masën 120,000 (njëqind e njëzet mijë) lekë për secilin fëmijë.

Në fillimet e kësaj skeme dhe deri në muajin prill 2020 bonusin e kanë përfituar edhe nënat shtetase shqiptare për fëmijë të lindur jashtë vendit dhe të regjistruar sipas afateve ligjore të përcaktuara në ligjin për gjendjen civile. Ndërsa duke filluar nga muaji prill 2020 e në vijim bonusin e përfitojnë<sup>42</sup>:

- a) prindi/prindërit, shtetas shqiptarë për foshnja të lindura brenda ose jashtë vendit dhe të regjistruara sipas afateve ligjore të përcaktuara në ligjin për gjendjen civile;
- b) prindi/prindërit me shtetësi tjetër, të cilët janë rezidentë të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë dhe vendosin t’i japin foshnjës shtetësi shqiptare, sipas ligjit për shtetësinë shqiptare dhe e regjistrojnë si shtetas shqiptar në Regjistrin e Kombëtar të Gjendjes Civile.

Ky ndryshim i VKM-së ka përjashtuar nga përfitimi i bonusit të bebes fëmijët e lindur nga nëna me shtetësi shqiptare rezidente jashtë Shqipërisë.

<sup>40</sup> Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2024-2030.

<sup>41</sup> VKM nr. 740, datë 12.12.2018 “Për përcaktimin e masës së ndihmës së menjëhershme financiare (bonusi) për nënat me foshnja të porsalindura dhe procedurën e dhënies së tij”.


<sup>42</sup> VKM nr. 288, datë 10.4.2020 “Për përcaktimin e masës dhe të procedurës së dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare për foshnjat e porsalindura dhe mënyrën e bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve të shërbimit spitalor dhe atyre të gjendjes civile”.

Tabela nr.19: Shpenzimet për Bonusin e bebes 2020-2025 (në milion lekë)

Bonusi Bebes	Fakt 2020	Fakt 2021	Fakt 2022	Fakt 2023	Fakt 2024	Plan 2025	Fakti 9M 2025
Shpenzime për Bonusin e Bebes	2,820	3,303	3,100	3,306	2,200	2,250	900
Numri i përfituesve <sup>43</sup>	36,188	43,441	42,504	42,740	26,358		

Burimi: Ministria e Financave, punoi grupi i auditimit

Figura nr. 16: Shpenzime për bonusin e bebes 2020-2025



Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale


Referuar të dhënave të paraqitura konstatohet një trend në ulje të shpenzimeve për bonusin e bebes, gjë që tregon për një rënie të numrit të lindjeve.

### Projeksionet e popullsisë 2019 – 2031

Diferenca midis numrit të lindjeve dhe numrit të vdekjeve është ai tregues që përfaqëson shtesën natyrore të popullsisë së një vendi. Referuar të dhënave të INSTAT grupi i auditimit ndërtoi paraqitjen grafike të mëposhtme e cila na tregon trendin e lindjeve dhe të vdekjeve përgjatë më shumë se tre dekadave. Sikurse mund të vihet re shtesa natyrore ka ardhur duke u ulur dhe për 6 mujorin e parë të vitit 2025 kemi shtesë natyrore negative (– 835).

<sup>43</sup> <https://shendetesia.gov.al/https-shendetesia-gov-al-tabelat-e-raportimit-per-intervalet-kohore-3-muaj-9-muaj-dhe-vjetore-si-dhe-relacionet-perkatese/>


Figura nr. 17: Numri i lindjeve dhe numri i vdekjeve 1990-2025



Burimi i të dhënave: INSTAT, punoi grupi i auditimit

Referuar bazës së të dhënave të INSTAT popullsia gjithsej e vendit tonë nga viti 2014 deri në vitin 2023 është pakësuar me 130,609 banorë, ndërsa referuar Censurit të vitit 2023 është pakësuar me rreth 420 mijë banorë krahasuar me vitin 2011.

Figura nr. 18: Popullsia e Shqipërisë 2014-2023



Burimi i të dhënave: INSTAT<sup>44</sup>, punoi grupi i auditimit

Popullsia e Shqipërisë më 1 Janar 2025 rezulton 2,363,314 banorë, duke pësuar rënie me 1,2 %, krahasuar me 1 Janar 2024 që ishte 2,390,942 banorë<sup>45</sup>.

Projeksionet e INSTAT për periudhën 2026 - 2031<sup>46</sup> parashikojnë një rënie të popullsisë totale nga viti në vit, ndërsa në qoftë se do t'i referohemi grupmoshave parashikohet se nga 0 në 66

<sup>44</sup> [https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST/START\\_DE/POP01/table/tableViewLayout1/](https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST/START_DE/POP01/table/tableViewLayout1/)

<sup>45</sup> <https://www.instat.gov.al/sq/temat/treguesit-demografike-dhe-sociale/popullsia/#tab2>

<sup>46</sup> [https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST/START\\_Projeksionet/Projek01/table/tableViewLayout1/](https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST/START_Projeksionet/Projek01/table/tableViewLayout1/)

vjeç do të kemi rënie të numrit pothuajse në të gjitha grupmoshat, ndërsa nga 67 vjeç deri në 99+ do të kemi rritje të numrit.


Tabela nr. 20: Projektionet e popullsisë gjithsej sipas moshës, skenari i rritjes së ulët 2024-2031

Viti	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031
Popullsia gjithsej	2,788,782	2,765,787	2,740,165	2,711,938	2,683,113	2,653,682	2,623,641	2,592,975

Burimi: INSTAT, punoi grupi i auditimit

Në vitin 2023 numri i grupmoshës 0 - 4 vjeç ka rezultuar 132,008, ndërsa në vitin 2031 parashikohet të jetë 16,582 më pak, pra 115,426 banorë. Në vitin 2023 numri i popullsisë për grupmoshën 65-99+ vjeç ka rezultuar 454,496 banorë, ndërsa në vitin 2031 për të njëjtën grupmoshë numri parashikohet të rritet me 123,089, pra në 577,585 banorë. Ajo që vihet re në këtë projektion është që rënia më e madhe e popullsisë parashikohet të jetë në grupmoshat 21-35 vjeç<sup>47</sup>.

Figura nr. 19: Projektioni për numrin e popullsisë për grupmoshat 21-35 vjeç, 2026 - 2031



Burimi: INSTAT, punoi grupi i auditimit

Sipas rezultateve të projeksioneve të popullsisë të publikuara nga INSTAT, skenari i rritjes së mesme të popullsisë sugjeron që popullsia e Shqipërisë do të tkurret nga 2,862,427 banorë në vitin 2019 në rreth 2,745,996 banorë në vitin 2031<sup>48</sup>. Ky skenar bazohet në hipotezat për një rritje mesatare të lindshmërisë, vdekshmërisë dhe migracionit. Ndërkohë që sipas skenarit të rritjes së ulët, ku supozohet rënie e mëtejshme e lindshmërisë dhe rritje të numrit të emigrantëve, popullsia e Shqipërisë pritet të arrijë në 2,592,975 banorë në vitin 2031<sup>49</sup>, pra me një rënie prej 269,452 banorë.

Skenari pozitiv është ai i rritjes së lartë i cili konsideron se lindshmëria fillon të rikuperohet me shpejtësi nga niveli aktual dhe emigrimi pëson rënie me ritme të larta atëherë popullsia e

<sup>47</sup> Aneksat nr. 2 dhe nr. 3 bashkëlidhur raportit paraqesin informacion më të detajuar për sa trajtuar më sipër.


<sup>48</sup> <https://www.instat.gov.al/media/5221/hipotezat-e-projeksioneve-t%C3%AB-p%C3%ABrdit%C3%ABsuara-t%C3%AB-popullsis%C3%AB-2019-2031.pdf>

<sup>49</sup> <https://www.instat.gov.al/media/5221/hipotezat-e-projeksioneve-t%C3%AB-p%C3%ABrdit%C3%ABsuara-t%C3%AB-popullsis%C3%AB-2019-2031.pdf>

Shqipërisë pritet që të arrijë në 2,922,749 banorë në vitin 2031<sup>50</sup>, pra me një rritje prej 60,322 banorë.

Figura nr. 20: Projektionet e përditësuara të popullsisë sipas 3 skenarëve 2019-2031

Fig. 1 Projektionet e përditësuara të popullsisë sipas 3 skenarëve 2019 – 2031



Burimi: INSTAT - Hipotezat e projeksioneve të përditësuara të popullsisë 2019-2031

Por në realitet parashikohet që rritja me ritme të ngadalta të lindshmërisë, shoqëruar nga hyrja në moshë riprodhimi e brezave të grave më të pakët në numër se ato aktual, do të bëjë që numri i lindjeve të mos pësojë ndryshime domethënëse gjatë periudhës 2019 – 2031. Në të njëjtën kohë numri i vdekjeve do të vazhdojë të rritet, si pasojë e një popullsie më të madhe në moshë të vjetër. Këto dy ndryshime do të sjellin edhe rënien e shtesës natyrore deri në vitin 2031.

Krahasimi i piramidave të popullsisë për vitin 2019 dhe popullsisë të projektuar të vitit 2031 na tregon se popullsia e Shqipërisë përveçse do të ndryshojë në numër, do të ndryshojë dukshëm edhe përbërjen e saj moshore dhe gjinore, që do të rezultojë në rritjen e numrit të popullsisë për moshat e vjetra mbi 67 vjeç, ndërsa moshat nën 67 vjeç do të pësojë tkurrje.<sup>51</sup>

Për të paraqitur të dhëna më aktuale grupi i auditimit iu referua projeksioneve të INSTAT për periudhën 2026-2031<sup>52</sup>. Referuar të dhëna të marra dhe të analizuar nga grupi i auditimit sipas projektionit për skenarin e rritjes së ulët nga viti 2026 deri në vitin 2031 vendi ynë mund të ketë një rënie të popullsisë me 147,190 banorë<sup>53</sup>.

<sup>50</sup> <https://www.instat.gov.al/media/5221/hipotezat-e-projeksioneve-t%C3%AB-p%C3%ABrdit%C3%ABsuara-t%C3%AB-popullsis%C3%AB-2019-2031.pdf>


<sup>51</sup> <https://www.instat.gov.al/media/5221/hipotezat-e-projeksioneve-t%C3%AB-p%C3%ABrdit%C3%ABsuara-t%C3%AB-popullsis%C3%AB-2019-2031.pdf>

[https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST/START\\_Projeksionet/Projek01/table/tableViewLayout1/](https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST/START_Projeksionet/Projek01/table/tableViewLayout1/)

<sup>52</sup> [https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST/START\\_Projeksionet/Projek01/table/tableViewLayout1/](https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST/START_Projeksionet/Projek01/table/tableViewLayout1/)

<sup>53</sup> Informacion më i detajuar rreth këtij projektioni për moshën nga 00 deri në 99+ vjeç, paraqitet në Aneksin nr. 5: “Projektionet e popullsisë gjithsej sipas moshës, skenari i rritjes së ulët”, bashkëlidhur raportit të auditimit.

Figura nr. 21: Projektionet e popullsisë gjithsej sipas moshës, skenari i rritjes së ulët 2026-2031



Burimi i të dhënave: INSTAT, punoi grupi i auditimit

Rezultatet e parashikimit tregojnë një intensifikim të rënies së popullsisë pas vitit 2031 për të arritur në 2,1 milionë banorë në vitin 2061. Popullsia në moshë pune parashikohet të pësojë rënie për të arritur në më pak se 1,2 milionë. Popullsia e të rinjve (0-14 vjeç) pritet të pësojë rënie të vazhdueshme deri në rreth 283.000 në vitin 2061, ndërsa numri i të moshuarve pritet të stabilizohet mbi 630.000 në fund të periudhës së projektimit. Ndryshime të tilla të popullsisë do të sillnin si rezultat një popullsi shumë të plakur, ku mosha mediane mendohet të jetë 49,7 vjeç. Theksojmë që këto projeksione janë bërë në vitin 2019 përpara Censurit të vitit 2023. Rezultatet e Censurit deri diku i kanë hedhur poshtë këto projeksione të cilat duhet të rishikohen përsëri në vijim.

Konstatohet se, në tremujorin e parë të vitit 2025, lindjet shënuan rënie me 14,1%, ndërsa vdekjet me 5,8%, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2024. Shtesa natyrore në tremujorin e parë të vitit 2025 ishte negative: -883 persona.<sup>54</sup>

Numri i lindjeve për tremujorin e dytë 2025 është 4,982 duke shënuar një rënie me 7,4 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2024.<sup>55</sup>

Të dhënat zyrtare nga Eurostat tregojnë se norma e lindshmërisë në Shqipëri ishte 1.71 fëmijë për grua në vitin 2012 dhe në vitin 2023 zbriti në 1,21 fëmijë për grua, ndërsa norma e BE-së ishte 1.38 lindje për grua në vitin 2023.

Ndër vendet e BE-së, Bullgaria raportoi shkallën më të lartë të fertilitetit në vitin 2023, me 1.81 lindje për grua, e ndjekur nga Franca (1.66) dhe Hungaria (1.55). Ndërsa shkalla më e ulët e fertilitetit në vitin 2023 u regjistrua në Maltë 1.06 lindje për grua, Spanjë (1.12) dhe Lituani (1.18)<sup>56</sup>.

Referuar rezultateve të Anketës së të ardhurave dhe nivelit të jetesës<sup>57</sup> konstatohet se **familjet me fëmijë në varësi në vitin 2024 rrezikun për të qenë i varfër e kanë në masën 24.8%** ndërsa familjet pa fëmijë në varësi e kanë këtë rrezik në masën 10.5%. Ky është një tregues tjetër që mund të shërbejë që për familjet me fëmijë duhet të ketë më shumë politika mbështetëse.

<sup>54</sup> <https://www.instat.gov.al/media/kindqdh4/treguesit-demografik-vjetore-2024-dhe-tremujori-i-2025.pdf>

<sup>55</sup> [https://www.instat.gov.al/media/5glj13r4/treguesit-demografike-tij\\_2025.pdf](https://www.instat.gov.al/media/5glj13r4/treguesit-demografike-tij_2025.pdf)

<sup>56</sup> [https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Fertility\\_statistics](https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Fertility_statistics)

<sup>57</sup> INSTAT

**Bazuar në analizën më sipër, arrijmë në konkluzionin se politika e bonusit të bebes nuk ka pasur asnjë ndikim në ndryshimin e trendëve aktuale për sa i takon rritjes së numrit të lindjeve.**

Qeveria shqiptare ka deklaruar publikisht që skema e mbështetjes për familjet nëpërmjet “Bonusit të Bebes” do të ndryshojë duke filluar nga data 1 janar 2026<sup>58</sup>. Koncretisht, “...mbështetja financiare nga 1 janari 2026 do të jetë pagesë mujore nga 0 deri në 5 vjeç, ... **Për fëmijën e parë** 5 mijë lekë në muaj nga 40 mijë lekë në total që është pagesa totale aktualisht. **Për fëmijën e dytë** 7 mijë lekë në muaj nga 80 mijë lekë që është pagesa totale aktualisht. **Për fëmijën e tretë** 10 mijë lekë në muaj, nga 120 mijë lekë që është pagesa totale aktualisht.

**Skema e re e propozuar publikisht për bonusin e bebes**

	Është	Bëhet
Fëmija 1	40 mijë lekë në total	5,000 lekë/muaj (300,000 në total) për 5 vite
Fëmija 2	80 mijë lekë në total	7,000 lekë/muaj (420,000 në total) për 5 vite
Fëmija 3	120 mijë lekë në total	10,000 lekë/muaj (600,000 në total) për 5 vite

Megjithatë, duhet evidentuar se, Qeveria Shqiptare ende nuk e ka miratuar zyrtarisht ndryshimin e skemës së bonusit të bebes, por po vlerësohen nga MSHMS skenarët e mundshëm dhe kostot financiare të lidhur këtë rishikim.

Sipas MSHMS, “...kostoja financiare në projektbuxhetin afatmesëm 2026 - 2028 është parashikuar të jetë 2 miliard lekë. Në të përfshihet dhe një pagesë mujore në vlerë progresive në rritje për fëmijën e parë, fëmijën e dytë e fëmijën e tretë e më shumë, deri në moshë parashkollore<sup>59</sup>. MSHMS-së nuk i ka paraqitur grupit të auditimit më shumë detaje rreth këtij projekti, kur parashikohet të fillojë, si dhe cila është skema që po planifikohet të zbatohet, nëse është ajo që është bërë publike më herët apo ka ndryshime.

Grupi i auditimit bëri një kërkim lidhur me praktikën e vendeve të tjera për sa i takon ndihmës financiare për fëmijët. Ajo që vërehet në këtë aspekt është se vende të ndryshme kanë praktika të ndryshme, por pothuajse të gjitha vendet e Evropës ofrojnë mbështetje në bazë mujore për fëmijët që nga lindja deri në moshën 15, 18 apo 21 vjeçare. Skemat janë të ndryshme sipas numrit të fëmijëve apo sipas të ardhurave mujore të familjes. P.sh në Kosovë<sup>60</sup> skema përfshin të gjithë fëmijët nga 0 deri në 16 vjeç që janë rezident në Kosovë dhe për familjet me 1 ose 2 fëmijë ndihma financiare është 20€ në muaj për secilin fëmijë, ndërsa për familjet me 3 ose më shumë fëmijë ndihma financiare është 30€ në muaj për secilin fëmijë. Kroacia<sup>61</sup> ka një skemë tjetër e cila jep ndihmë financiare për fëmijët nga 0 deri në 15 vjeç, dhe me përjashtime deri në 19 apo 21 vjeç. Skema bazohet në të ardhurat mesatare për anëtar të familjes, dhe ndihma financiare fokusohet në pesë grupe ku intervali i ndihmës financiare është nga 61.80 euro për fëmijë për ato që përfshihen në grupin e parë në 30.90 euro për fëmijë për ato që përfshihen në grupin e pestë. Konstatohet se pothuajse të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Europian japin ndihmë financiare mujore për fëmijët e cila varion sipas shteteve.

Një praktikë tjetër që është e përhapur gjerësisht në vendet e Evropës lidhet edhe me lehtësira të ndryshme tatimore për familjet me fëmijë. Për shembull, shumë vende ofrojnë, ulje tatimi,

<sup>58</sup> <https://shqiptarja.com/lajm/ekskluzive-nga-2026ta-ska-me-cek-per-bebin-qeveria-me-skeme-te-re-pagese-nga-510-mije-leke-cdo-muaj-deri-ne-moshen-5-vjec>

<https://zeri.ai/aktualitet/nga-2026-ta-ska-me-cek-lindjeje-per-bebet-qeveria-me-skeme-te-re-pagese-cdo-muaj-deri-ne-moshen-5-vjec-i230171>

<https://ekofin.al/ndryshon-bonusi-i-bebes-nga-viti-2026-do-kete-pagesa-mujore-per-femijet-deri-ne-5-vjec/>

<https://www.youtube.com/watch?v=dhSuzNb9TUE>

<sup>59</sup> Shkresa nr. 2743/1 Prot, datë 01.09.2025 për dërgimin e Projektbuxhetit afatmesëm në Ministrinë e Financave.

<sup>60</sup> <https://zck-kpz-platform.rks-gov.net/njoftim-per-udhezuesin-rreth-zbatimit-te-shtesave-per-femije-dhe-lehona/>

<sup>61</sup> <https://migracije.hr/childallowance/?lang=en#:~:text=Group%20%20%E2%80%93%20in%20which%20the,i.e.%2C%20EUR%2055.18%20per%20child.>


kredi tatimore, zbritje nga të ardhurat apo Tvsh e reduktuar. Në këtë aspekt vendi ynë duke filluar nga viti 2025 po zbaton zbritjen nga baza tatimore për çdo fëmijë në ngarkim më pak se 18 vjeç prej 48,000 lekësh në vit<sup>62</sup>.

Sa paraqitur dhe analizuar më sipër, si dhe duke iu referuar praktikave të vendeve të ndryshme të Europës, vendi ynë duhet të vlerësojë me prioritet ndryshimin e skemës së mbështetjes financiare për fëmijët si dhe të vlerësojë politika të tjera për mbështetjen e familjeve me fëmijë.

### Fondet e planifikuara për zbatimin e Planit të Moshimit 2020 - 2024 nuk janë realizuar sipas përcaktimeve të bëra në Planin e Veprimit.

Plani kombëtar i moshimit në tre shtyllat strategjike parashikon që të ofrohet mbrojtje dhe përfshirje sociale për të moshuarit, shërbime sociale e shëndetësore të përshtatshme, si dhe të promovohet shëndeti dhe mirëqenia e të moshuarve dhe ndërgjegjësimi i shoqërisë mbi moshimin. Në nivel makro shpenzimet e realizuara për periudhën 2020 - 2024 për zbatimin e objektivave të vendosura në dokumentin politik kombëtar për moshimin, 2020 - 2024 paraqiten:

Figura nr. 22: Niveli i shpenzimeve Plan/Fakt Periudha kohore në vite 2020-2024



Burimi: Raporti përfundimtar mbi zbatimin e dokumentit politik kombëtar për moshimin, 2020-2024.

Sa më sipër konstatohet se për vitin 2020 kemi një realizim prej 61%, në vitin 2021 – 56%, në vitin 2022 – 36%, në vitin 2023 – 51 % dhe në vitin 2024 – 50%. Në total janë disbursuar rreth 48% e fondeve të planifikuara, gjë që tregon për një progres të pjesshëm në realizimin e objektivave të planit.

Në fokus të auditimit tonë kemi analizuar objektivin specifik 4 të qëllimit të politikës 1 “Të sigurojmë mjedise motivuese në punë për personat para daljes së tyre në pension dhe të nxisim të mësuarit gjatë gjithë jetës”<sup>63</sup>, objektivi që lidhet me moshimin por në të vërtetë nuk ka ndikim në ndryshimin e fenomenit demografik. Për realizimin e këtij objektivi janë planifikuar dy aktivitete kryesore:

1. Përmirësim i ndërgjegjësimit të publikut në përgjithësi mbi mundësitë që ofron tregu i punës për punësimin e të moshuarve.

<sup>62</sup> Ligji nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, neni 22, zbritjet nga baza tatimore, germa ç).

<sup>63</sup> Realizimi i objektivave të tjera nuk është në fokus të këtij auditimi, së pari sepse nga KLSH është zhvilluar në vitin 2023 një Auditim Performance me temë “Kujdesi ndaj të moshuarve”, me qëllim vlerësimin e respektimit të standardeve të kujdesit social dhe të cilësisë së shërbimeve të ofruara në institucionet publike rezidenciale për të moshuarit, dhe së dyti sepse objektivi i auditimit tonë është vlerësimi i politikave që adresojnë fenomenin e moshimit të popullsisë dhe jo shërbimet që marrin qytetarët (të moshuarit) pasi kanë mbushur moshën për pension pleqërie.

2. Krijim i një modeli të “universitetit të moshës së tretë” në bashkëpunim mes institucioneve shtetërore dhe organizatave të shoqërisë civile.

Konkretisht, lidhur me këto aktivitete është planifikuar të jepet një fond prej 18,957 milion lekësh. Në përfundim të afatit të zbatimit konstatohet se fondet faktike të shpenzuara janë në vlerën 7,800 milion lekë ose 41%<sup>64</sup>.

Konstatohet se në vitin 2020 realizimi ka qenë në masën 49%, në vitin 2021 fondet faktike të shpenzuara kanë qenë vetëm 13 % të planit duke qenë edhe viti me realizimin më të ulët në të gjithë periudhën, ndërsa në vitet 2022-2024 ka pasur një përmirësim duke arritur në 73%, por përsëri pa arritur nivelin e parashikuar.

Raportimi financiar është bërë në mënyrë të përgjithshme dhe nuk ka një ndarje të fondit të shpenzuar sipas aktiviteteve konkrete të përcaktuara në planin e veprimit. Mosrealizimi i disa aktiviteteve apo nën objektiva është shpjeguar me situatën Covid19, dhe njëkohësisht edhe me një informacion të limituar në lidhje me shpenzimet buxhetore, për faktin se shpesh buxheti është vështirë të ndahet në kosto të detajuara, për shkak të çeljes së tyre dhe raportimit “on block”.

**Referuar Raportit të Monitorimit të Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024 - 2030, për vitin 2024, rezulton se lidhur me Fondin Social burimet financiare kanë rezultuar të pamjaftueshme për të përballuar kërkesën në rritje për shërbime sociale.**

Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2024 - 2030 ka dy qëllime kryesore, përkatësisht:

- Zbutja e varfërisë për çdo individ në nevojë dhe përmirësimi i jetesës për personat me aftësi të kufizuara përmes mbështetjes me skemat financiare.
- Zgjerimi i shërbimeve sociale të integruara, të aksesueshme e cilësore dhe të përgjegjshme gjinore, si dhe avancimi i deinstitutionalizimit të kujdesit rezidencial, në partneritet me pushtetin vendor dhe aktorët e tjerë.

Për të realizuar këto qëllime është përlogaritur kostoja e përgjithshme për zbatimin e masave administrative të kësaj strategjie dhe të planit të veprimit që është rreth 244,618,380,031 lekë<sup>65</sup> (Qëllimi i politikës A: 233,361,248,731, Qëllimi i politikës B: 11,257,131,300). Burimet e përcaktuara për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për programin buxhetor “Përkujdesi social” dhe “Planifikim, menaxhim dhe administrimi” mbulojnë rreth 96,2% të koston së përlogaritur për këtë strategji. Kostoja financiare e mbuluar nga buxheti i miratuar i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për çdo vit buxhetor përkatës, është e përfshirë brenda parashikimeve të tavanëve të shpenzimeve buxhetore për periudhën afatmesme e më tej. Kostoja e planit të veprimit specifikon për çdo objektiv dhe nën objektiv lidhjen me programin buxhetor sipas fushave kryesore që mbulon strategjia. Për vitin 2024, për qëllimin A dhe B sipas planit të veprimit të strategjisë për masat prioritare të objektivave A1, A2, A3, B1, B2, B3 është planifikuar buxheti prej 30,124,795,000 lekësh. Për vitin 2025 është planifikuar buxheti prej 31,766,015,000 lekësh.

Burimet e përcaktuara nga buxheti i shtetit për realizimin e këtyre aktiviteteve mbulohe nga dy programe buxhetore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale “Përkujdesi social” dhe “Planifikim, menaxhim dhe administrimi”.

Programi i Përkujdesit Social përfshin në financim programin e ndihmës ekonomike, programin e aftësisë së kufizuar, programin e bonusit të bebes, mbështetjen e veçantë nga shteti për nënat e papuna me shumë fëmijë, programin e ndërmarrjeve sociale, institucionet e

<sup>64</sup> Raporti përfundimtar mbi zbatimin e dokumentit politik kombëtar për moshimin, 2020-2024.

<sup>65</sup> Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2024-2030, Buxheti i nevojshëm (në lekë), fq.59.

përkujdesit social ku përfshihen ato për foshnje dhe fëmijët, të moshuar, persona me aftësi të kufizuar, si edhe përfitues të tjerë, Fondin social.

Programi “Administrim Planifikim Menaxhim” përfshin në financim shpenzimet e aparatit të MSHMS. Këtu përfshihen të gjithë ato aktivitete (të strategjisë) që shpenzimet e të cilave janë vetëm shpenzime operative.

Realizimi për vitin 2024 është i plotë sipas parashikimit të strategjisë, ndërsa për vitin 2025 planifikimi është 26,940,862,971 lekë.

Nga fondi i parashikuar për vitin 2025, është zbritur vlera rreth 3 miliardë lekë për pagesat e rreth 72 mijë invalidëve të punës, të cilat tashmë e marrin të gjitha pagesat nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Referuar Raportit të Monitorimit të Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024-2030, për vitin 2024, rezulton se lidhur me Fondin Social burimet financiare kanë rezultuar të pamjaftueshme për të përballuar kërkesën në rritje për shërbime sociale. Por në këtë raport nuk jepen të dhëna lidhur me fondet e alokuara në raport me ato të planifikuara për Fondin Social. Si sfidë për qëndrueshmërinë e shërbimeve identifikohet që në nivel lokal ka mungesë kapacitetesh për të planifikuar, menaxhuar dhe monitoruar programet e kujdesit social në mënyrë efektive.

Në raportin e monitorimit gjithashtu nuk jepen të dhëna lidhur me aktivitetet që kanë përdorim të ulët të fondeve dhe mosrealizim të objektivave për vitin 2024 por ky fakt vetëm identifikohet.

**Buxheti i planifikuar për zbatimin e Programeve të Nxitjes së Punësimit nuk paraqet një qëndrueshmëri në nivelet e realizimit për periudhën 2020 - 2025. Gjithashtu, fondet e parashikuara për programin e Garancisë Rinore nuk janë realizuar.**

## Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive

Tabela nr. 21: Buxheti i AKPA-së 2020-2025 (000 lekë)

Viti	Buxheti total AKPA			
	Plan fillestar	Plan i rishikuar	Fakt	Fakt%
2020	1,699,000	1,915,578	1,546,989	81%
2021	2,273,000	2,274,130	5,005,264	88%
2022	2,430,600	2,043,145	2,003,451	98%
2023	2,434,006	3,014,688	2,489,617	83%
2024	2,898,613	2,557,270	2,457,660	96%
2025	2,726,547	2,927,545	1,483,058*	-

Burimi i të dhënave: AKPA, punoi grupi i auditimit. \*8 mujori i vitit 2025

### Viti 2020

Për vitin 2020 buxheti i parashikuar për AKPA-në është 1,915,578 mijë lekë. Konstatohet se realizimi është 1,546,989 mijë lekë ose në masën 81%. Programi i Pagesës së Papunësisë zë 51% të fondit total të administruar nga AKPA, Programi i Nxitjes së Punësimit është 13% e totalit, Formimi Profesional Publik është 15% e totalit, ndërsa investimet buxhetore janë 2% e totalit etj.

Konstatohet se artikulli “Nxitje punësimi” është realizuar në masën 28% ndërsa zëri “Pagesë papunësie” është në masën 92%. Në artikullin “Nxitje punësimi” kemi pakësim -137,092,000 lekë për gjithë vitin buxhetor 2020. Në artikullin “Pagesë Papunësie” kemi shtesë 368,349,700 lekë.

Për vitin 2020 nga buxheti i shtetit u akordua për **programet e nxitjes së punësimit** fondi prej 390 milion lekësh për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit, fond i cili u ndryshua deri në fund të vitit në plan në shumën 252.9 milion lekë. Realizimi i programit të nxitjes së

punësimi është në masën 28%, ose nga 252,908 mijë lekë të planifikuara janë shpenzuar 71,555 mijë lekë .

Gjatë vitit 2020 për programet e nxitjes së punësimi janë lidhur marrëveshje tre palëshe për fondin total 344,032 mijë lekë, nga të cilat rreth 327 milion lekë ishin projekte që parashikoheshin të financoheshin gjatë vitit 2021.

**Programi i pagesës së papunësisë** si pasojë e situatës Covid-19 bëri që personat përfitues të të ardhurës së papunësisë që kishin aplikuar pranë Zyra të Punësimi deri më datën 10 mars 2021 të përfitojnë dyfishin e të ardhurës të përcaktuar me VKM. Numri i personave të trajtuar me të ardhura nga pagesa e papunësisë ka pësuar rritje në vitin 2020 në krahasim me vitin paraardhës dhe masa e trajtimit financiar është dyfishuar për një periudhë 3 mujore (mars, prill, maj) çka ka sjellë si pasojë shtimin e buxhetit për programin e pagesës së papunësisë në shumën 368,344,700 lekë.

Në nivelet e realizimit të programit të nxitjes së punësimi në masën 28 % kanë ndikuar:

- Koha e nevojshme për miratimin e gjithë akteve nënligjore përkatëse (VKM-ve) të reja të nxitjes së punësimi , udhëzimeve dhe rregulloreve përkatëse.
- Situata e krijuar nga pandemia Covid 19, ku kërkesat e përcaktuara në VKM-të përkatëse ishin të pa mundura të plotësoheshin në kushtet e krijuara që bizneset të aplikojnë në programet e nxitjes së punësimi.

#### Viti 2021

Për vitin 2021 buxheti i parashikuar për AKPA-në është 2,274,130 mijë lekë. Konstatohet se realizimi është 2,005,264 mijë lekë ose në masën 88%. Programi i Pagesës së papunësisë është 47% e totalit të buxhetit faktik vjetor, Programi i Nxitjes së Punësimi është 20% e totalit, Programi i Formimit Profesional është 15 % e totalit, etj.

Gjatë vitit 2021 janë kryer transferime buxhetore në total në shumën 1,130,000 lekë, ku referuar analitikës rezultoi shtese për programin e pagesës së papunësisë në shumën 186,385.000 lekë, për përballimin e kostos së mbështetjes me të ardhura të punëkërkuesve të papunë dhe pakësim për programin e nxitjes së punësimi në shumën -48,434,000 lekë.

Realizimi për programin e pagesës së papunësisë është 96% dhe për Programin e Nxitjes së Punësimi është 75%.

Për **programet e nxitjes së punësimi** nga buxheti i shtetit u akordua fondi prej 570,000,000 lekë që gjatë vitit është pakësuar dhe plani i rishikuar në fund të vitit 2021 ka rezultuar 521,566,000 lekë.

**Programi i Pagesës së Papunësisë** është realizuar në masën 96% në krahasim me planin e rishikuar , ose nga 986,385,000 lekë të planifikuara janë shpenzuar 947,632,000 lekë. Gjatë vitit 2021 në bazë të ecurisë së programit, dhe kërkesave të institucioneve të varësisë është bërë shtesë plani në shumën 186,385,000 lekë.

#### Viti 2022

Për vitin 2022 buxheti i parashikuar për AKPA-në është 2,430,600 mijë lekë. Konstatohet se realizimi është 2,003,451 mijë lekë ose në masën 98%. Gjatë vitit 2022 janë kryer transferime pakësimi buxhetore në total në shumën -387,455,000 lekë. Janë kryer pakësimi fondesh në programin e pagesës së papunësisë në shumën -164.467.250 lekë, në programin e nxitjes së punësimi në shumën – 84,000,000 lekë, investime në shumën -14,000,000 lekë, etj.

Nga struktura e shpenzimeve sipas programeve vihet re se 54% e fondeve janë përdorur për të financuar programe aktive të punësimi si nxitje punësimi, formimi profesional publik, ndërmjetësim e këshillime punësimi nga Drejtoritë Rajonale të Punësimi, 37% e fondit është përdorur për mbështetjen me të ardhura nga papunësia, 6% etj.

Për **Programin e nxitjes së punësimit** nga buxheti i shtetit u akordua fondi prej 550,000,000 lekë, gjatë vitit ky plan u pakësua dhe plani i rishikuar për programin e nxitjes së punësimit në fund të vitit 2022 ishte 452,222,000 lekë. Realizimi i treguesve buxhetore për programin e nxitjes së punësimit është 97% në krahasim me planin e rishikuar.

**Programi i Pagesës së Papunësisë** është realizuar në masën 100% në krahasim me planin e rishikuar. Për vitin 2022 plani fillestar ishte 900,000,000 lekë dhe gjatë vitit është rishikuar në shumën 735,533,000 lekë, dhe është realizuar në vlerën 735,515,000 lekë.

### Viti 2023

Konstatohet që gjatë vitit 2023 krahas zbatimit të programeve aktive dhe pasive të Programit Tregu i Punës janë aplikuar rishtas:

- Programi i formimit profesional (programi i kodimit) që është një politikë e re dhe përkrah aftësimin dhe riaftësimin e të interesuarve në fushën e kodimit, programimit kompjuterik, elektronika, inteligjenca artificiale etj.
- Janë realizuar zhvillime të reja, në përmirësimin e procesit të ndërmjetësimit të punëkërkuësve të papunë me vendet e lira të punës, zhvillime në modulën e formimit profesional etj.
- U bë pilotimi në tre rajone i programit Garancia Rinore.

Për vitin 2023 buxheti fillestar i parashikuar për AKPA-në ishte 2,434,006 mijë lekë, i rishikuar 3,014,688 mijë lekë. Shtesa e fondeve në shumën 580,682,781 lekë ka ardhur kryesisht për mbulimin e kostos së VKM-së nr. 325 datë 31.05.2023 për pagat e personelit. Konstatohet se realizimi është 2,489,617 mijë lekë ose në masën 83%. Struktura e planit të rishikuar në % sipas produkteve është, produkti Ndërmjetësim, Këshillim është 14% ndaj totalit, produkti **Nxitje punësimi është 31% ndaj totalit**, produkti Formimi profesional është 13% ndaj totalit, produkti Papunësia është 29% ndaj totalit, etj.

Në programin nxitje punësimi, ka patur një shtesë në shumën 476,846,900 lekë. Nga të cilat shtesa 452,000,000 lekë janë akorduar për zbatimin e VKM-së nr.114 datë 01.03.2023 “Për përdorimin e fondit të kontigjencës për kompensimin financiar të rritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për çdo të punësuar me pagë minimale për shkak të rritjes së kësaj page në shkallë vendi” dhe shtesa në shumën 24,846,900 lekë për programet e nxitjes së punësimit për përballimin e kostos së programeve të nxitjes si pasojë e rritjes së pagës minimale me VKM nr.113 datë 01.03.2023.

### **Pagesa e Papunësisë**

Gjatë vitit 2023 janë shpenzuar 857,299,511 lekë, për pagesën e papunësisë të 2,874 persona dhe 393 ish naftëtarë të Rafinerisë së naftës Ballsh sipas VKM nr.117 datë 01.03.2023. Fondi i shpenzuar për trajtimin mesatarisht të 2.874 punëkërkuësve të papunë përfitues të pagesës së papunësisë është 727,526,011 lekë, me kosto mesatare mujore 21.000 lekë/person. Nga përfituesit e pagesës së papunësisë 60% e tyre janë femra.

### **Programi i nxitjes së Punësimit**

Plani fillestar ka ndryshuar si pasojë e shtesës në shumën 452,000,000 lekë për zbatimin e VKM nr.114 datë 01.03.2023 “Për përdorimin e fondit të kontigjencës për kompesimin financiar të rritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për çdo të punësuar me page minimale, për shkak të rritjes së kësaj page në shkallë vendi” dhe shtesa tjetër në shumën 24,846,900 lekë për programet e nxitjes së punësimit, për përballimin e efektit financiar që solli rritja e pagës minimale në shkallë vendi me VKM nr.113 datë 01.02.2023 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”.

Nga viti 2022 janë mbartur programe për të cilat ishin lidhur marrëveshje trepalëshe me kosto totale 446,610,000 lekë. Fondi i mbetur në dispozicion të programeve të reja për 2023 rezulton 28,236,900 lekë.

## Viti 2024

Për vitin 2024 buxheti fillestar i parashikuar për AKPA-në ishte 2,898,613 mijë lekë, i rishikuar 2,557,270 mijë lekë. Struktura e planit të rishikuar në % sipas produkteve është, produkti Ndërmjetësim , Këshillim është 18% ndaj totalit, produkti Nxitje punësimi është 17% ndaj totalit, produkti Formimi Profesional është 15% ndaj totalit, produkti Papunësia është 34% ndaj totalit, produkti Kodimi është 4% ndaj totalit dhe produkti Garancia Rinore është 1% ndaj totalit, etj. Programet aktive janë financuar nga buxheti i shtetit 56% e fondeve të programit Tregu i Punës, 34% për programet pasive Papunësia. Plani fillestar i akorduar për programin “Tregu i Punës” për vitin 2024 është 2,898,613 mijë lekë. Gjatë vitit janë kryer transferime buxhetore në shumën -341,342,343 lekë dhe plani i rishikuar për periudhën janar-dhjetor 2024 është 2,557,270,657 lekë. Pakësime të fondeve kanë rezultuar në programet e nxitjes së punësimit në shumën 176,035,194 lekë, shtesë në pagesa e papunësisë 61,900,000 lekë dhe pakësim nga plani i investimeve në shumën 66,788,000 lekë në objektin ndërtimi i kampusit të formimit profesional, etj.

### Programi i Kodimit

Realizimi i treguesve të buxhetit:

- Plani fillestar 100,000,000 lekë
- Plani i rishikuar 103,258,526 lekë
- Shpenzime 98,504,312 lekë realizimi 95%

Tabela nr. 22: Programi i nxitjes së punësimit dhe Programi Pagesa e papunësisë 2020-2025 (000 lekë).

Viti	Programi i nxitjes së punësimit				Programi Pagesa e papunësisë			
	Plan fillestar	Plan i rishikuar	Fakt	Fakt%	Plan fillestar	Plan i rishikuar	Fakt	Fakt%
2020	390,000	252,908	71,555	28%	600,000	735,533	735,515	100%
2021	570,000	521,566	393,105	75%	800,000	986,385	947,632	96%
2022	550,000	466,000	452,222	97%	900,000	968,350	886,601	92%
2023	450,000	926,846	626,790	68%	900,000	868,253	857,299	99%
2024	450,000	432,706	411,480	95%	800,000	861,900	831,625	96%
2025	450,000	673,000	365,902*	46%	800,000	800,721	432,949*	54%

Burimi i të dhënave: AKPA, punoi grupi i auditimit

\*8 mujori i vitit 2025

### Programi i Garancisë Rinore

Programi i nxitjes së punësimit, sipas skemës së garancisë rinore, ka për qëllim përfshirjen në tregun e punës të rinjve të moshës 15–29 vjeç, që nuk janë në punësim, arsim ose formim profesional, nëpërmjet të nxënimit në vendin e punës. Programi Garancisë Rinore mbështetet në VKM-në nr.264, datë 27.04.2023 dhe ka për qëllim të ndihmojë të rinjtë të integrohen në tregun e punës. Programi ka filluar në tetor të vitit 2023 dhe është pilotuar në Tiranë, Shkodër dhe Vlorë. Programi zbatohet nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (AKPA) në programin e Tregu të Punës.

Tabela nr. 23: Programi i Garancisë Rinore 2023-2025 (000 lekë)

Viti	Programi i Garancisë Rinore			
	Plan fillestar	Plan i rishikuar	Fakt	Fakt%
2023	-	85,000	43,027	0%
2024	200,000	38,000	30,305	80%
2025	200,000	200,000	37,215*	19%

Burimi i të dhënave: AKPA, punoi grupi i auditimit

\*8 mujori i vitit 2025

## **Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023 - 2030**

Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030 ka një lidhje të drejtpërdrejtë me fenomenin e moshimit të popullsisë pasi e njeh këtë fenomen si një sfidë për vendin tonë. Në strategji konstatohet fakti që Shqipëria po përjeton një tkurrje të popullsisë dhe një rritje të moshës mediane. Projektionet e INSTAT parashikojnë një reduktim në shtesën natyrore të popullsisë, gjë e cila përkehet në më pak fuqi punëtore, më shumë barrë mbi sistemin e sigurimeve shoqërore dhe një nevojë emergjente për politika aktive. Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030 synon të adresojë moshimin e popullsisë përmes një qasjeje të integruar, duke forcuar formimin profesional të të rriturve, promovuar punësimin aktiv të moshave të mëdha, nxitur digjitalizimin dhe forma fleksibël të punës, si dhe duke ndërlidhur objektivat me politika të tjera sociale dhe ekonomike. Në këtë mënyrë, strategjia synon të kontribuojë drejtpërdrejt në zbutjen e efekteve negative të plakjes së popullsisë mbi zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit.

Për të siguruar një punësim cilësor dhe aftësim gjatë të gjithë jetës për të gjithë, strategjia ka vendosur objektivat që lidhen me zhvillimin e aftësive dhe lidhje më e mirë e kërkesës me ofertën në tregun e punës për më shumë punësim, si dhe mundësimi e punësimit të denjë për gra dhe burra nëpërmjet zbatimit të politikave gjithëpërfshirëse të tregut të punës;

Për arritjen e këtyre objektivave strategjia parashikon një kosto totale prej 75,513,866,666 lekë ku financimi nga buxheti i shtetit parashikohet të jetë në shumën 50,949,415,955 lekë, financimi i huaj në shumën 7,392,277,484 lekë dhe hendeku financiar në shumën 17,172,173,227 lekë (23%). Hendeku financiar më i lartë është për objektivin që lidhet me “Rritjen e nivelit të aftësive të grave dhe burrave në moshë pune”, duke rezultuar në 43% të buxhetit të nevojshëm. Përsa i përket hendekut financiar janë parashikuar masa dhe detyrime të cilat duhet të plotësohen në periudhën në vijim të zbatimit të strategjisë. Gjithashtu, ka dhe angazhime në kuadër të Programit Operacional të BE-së për Punësimin e të Rinjve 2024-2027 (EU4Youth Employment) ku pritet të akordohen 50 milion euro nga BE. Hendeku financiar pritet të plotësohet edhe me projektet dhe programet e donatoreve.

Referuar raportit të monitorimit të strategjisë për vitin 2024, buxheti total i shtetit i ndarë fillimisht për punësimin dhe arsimin dhe formimin profesional për vitin 2024 ishte plan afërsisht 62,25 miliardë lekë, ndërsa fakt rezulton 57,24 miliardë lekë. Buxheti i parashikuar për programet e punësimit dhe tregut të punës për vitin 2024 arriti në 25,6 miliardë lekë, shpenzimet aktuale ishin 24,58 miliardë lekë, me një shkallë shfrytëzimi të buxhetit prej 96%. Buxheti i parashikuar për programet e Aftësimit dhe Formimit Profesional në vitin 2024 arriti në 36,7 miliardë lekë, ndërsa shpenzimet arritën në 32,7 miliardë lekë.

**10. Gjetje nga auditimi:** Në vijim të prioritetëve strategjike dhe politikave mbështetëse të Qeverisë Shqiptare, që nga janari i vitit 2019 e në vazhdimësi, po aplikohet “bonusi i bebes”, i cili përbën një skemë mbështetje financiare për nënat e reja, që ka për qëllim dhënien e ndihmës së menjëhershme nga MSHMS për nënat me foshnje të porsalindura, rritjen e numrit të lindjeve dhe zhvillimin e shoqërisë. Nga të dhënat e analizuar rezulton se edhe pse skema e mbështetjes financiare për nënat e reja ka ndryshuar dukshëm nga sa ishte para vitit 2019, ajo përsëri nuk ka arritur të ketë një ndikim në një prej fenomeneve më të ndjeshme në moshimin e popullsisë, atë të rritjes së normës së lindshmërisë. Konkretisht në vitin 2021 janë shpenzuar 3.3 milion lekë për bonusin e bebes, ndërsa në vitin 2024 janë shpenzuar 2.2 milion lekë. Konstatohet se, në tremujorin e parë të vitit 2025, lindjet shënuan rënie me 14,1%, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2024, ndërsa në tremujorin e dytë të vitit 2025 është shënuar një rënie me 7,4 %, krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2024. Shtesa natyrore në tremujorin e parë të vitit 2025 është negative: -883 persona. Treguesi për të ardhurat dhe nivelin e jetesës tregon se

familjet me fëmijë në varësi në vitin 2024 rrezikun për të qenë i varfër e kanë në masën 24.8%, ndërsa familjet pa fëmijë në varësi e kanë këtë rrezik në masën 10.5%. Norma e lindshmërisë në Shqipëri në vitin 2012 ishte 1.71 fëmijë për grua dhe në vitin 2023 zbriti në 1,21 fëmijë për grua, ndërsa norma e BE-së është 1.38 lindje për grua në vitin 2023. Si rezultat politika e “bonusit të bebes” rezulton e pamjaftueshme për të siguruar rritjen e numrit të lindjeve.

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se buxheti i planifikuar për zbatimin e Planit të Moshimit 2020 - 2024 ka nivele të ulëta realizimi. Për të përmbushur aktivitetet kryesore që përfshijnë, përmirësim i ndërgjegjësimit të publikut në përgjithësi mbi mundësitë që ofron tregu i punës për punësimin e të moshuarve dhe krijim i një modeli të “universitetit të moshës së tretë” ishte planifikuar të jepej një fond prej 18,957 milion lekësh. Në përfundim të afatit të zbatimit konstatohet se fondet faktike të shpenzuara janë në vlerën 7,800 milion lekë ose 41%. Konstatohet se, raportimi financiar për zbatimin e Planit të Moshimit është bërë në mënyrë të përgjithshme dhe nuk ka një ndarje të fondit të shpenzuar sipas aktiviteteve konkrete të përcaktuara në planin e veprimit. Mosrealizimi i disa aktiviteteve apo nën objektiva është shpjeguar me situatën Covid - 19, dhe njëkohësisht edhe me një informacion të limituar në lidhje me shpenzimet buxhetore.

**12. Gjetje nga auditimi:** Referuar Raportit të Monitorimit të Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024-2030, për vitin 2024, rezulton se lidhur me Fondin Social burimet financiare kanë rezultuar të pamjaftueshme për të përballuar kërkesën në rritje për shërbime sociale. Në këtë raport nuk jepen të dhëna lidhur me fondet e alokuara në raport me ato të planifikuara për Fondin Social. Si sfidë për qëndrueshmërinë e shërbimeve identifikohet që në nivel lokal ka mungesë kapacitetesh për të planifikuar, menaxhuar dhe monitoruar programet e kujdesit social në mënyrë efektive. Në raportin e monitorimit gjithashtu nuk jepen të dhëna lidhur me aktivitetet që kanë përdorim të ulët të fondeve dhe mosrealizim të objektivave për vitin 2024 por ky fakt vetëm identifikohet.

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i planifikimit dhe zbatimit të buxhetit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive rezulton se buxheti i planifikuar për zbatimin e Programeve të Nxitjes së Punësimit nuk paraqet një qëndrueshmëri në nivelet e realizimit. Kjo paqëndrueshmëri është ndikuar nga faktorë si miratimi i programeve të reja të punësimit apo si rezultat i fillimit të Programit të Garancisë Rinore në tremujorin e fundit të vitit 2023. Konkretisht, për periudhën 2020-2025, masa e realizimit paraqitet në 28% në vitin 2020, 75% në vitin 2021, 97% në vitin 2022, 68% në vitin 2023, 95% në vitin 2024 si dhe 46% për tetë mujorin e vitit 2025. Nga analizimi i të dhënave konstatohet se, buxheti i rishikuar për artikullin e nxitjes së punësimit përgjithësisht pëson ulje krahasuar me planin fillestar të buxhetit. Përrjashtim bëjnë vitet 2023 dhe 2025 ku konstatohet të ketë një rritje nga plani fillestar në buxhetin e rishikuar. Programi i Garancisë Rinore i cili zbatohet nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive dhe ka për qëllim përfshirjen në tregun e punës të rinjve të moshës 15–29 vjeç, që nuk janë në punësim, arsim ose formim profesional, nëpërmjet të nxënimit në vendin e punës, ka filluar në tetor të vitit 2023 dhe është pilotuar në Tiranë, Shkodër dhe Vlorë. Rezultoni se në vitin 2023 janë planifikuar 85,000,000 lekë dhe realizimi është në masën 0%, në vitin 2024 - 2025 janë planifikuar 200,000,000 lekë dhe realizimi arrin në 80% për vitin 2024, ndërsa për tetë mujorin e vitit 2025 realizimi është 19%. Nivelet e realizimit lidhen me nevojën për një menaxhimin efektiv të marrëveshjeve trepalëshe që nënshkruhen në kuadër të zbatimit të programeve të nxitjes së punësimit.

**4. Konkluzion:** Sa i përket politikave familjare dhe rritjes së lindshmërisë, stimulimi i familjeve të reja dhe mbështetja e zgjatur sociale janë thelbësore. Sipas treguesve statistikor

mund të arrijmë në konkluzionin që bonusi i bebes nuk është një politikë e mjaftueshme për të nxitur lindshmërinë, por nevojiten masa të tjera shtesë të cilat duhet të vlerësohen nga MSHMS në bashkëpunim me ekspertët e fushën. Duhet të ndërmerren veprime konkrete në nivel lokal dhe kombëtar, si dhe është e domosdoshme të hartohen plane konkrete afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për adresimin e çështjeve demografike.

Institucionet politikëbërëse duhet të fokusohen në shërbime gjithëpërfshirëse, afatgjata, plotësuese dhe të qëndrueshme të mbështetjes familjare. Ato duhet të planifikojnë dhe disbursojnë burime të mjaftueshme për të përmirësuar faktorët të cilat kanë tendencë të jenë pengesat më të mëdha me të cilat përballen çiftet kur marrin në konsideratë prindërimin.

Politikëbërësit duhet të bashkëpunojnë me ekspertë, ofrues të kujdesit shëndetësor apo organizata komunitare për të zhvilluar ndërhyrje të synuara që adresojnë pengesat specifike për rritjen e familjes.

**10.1 Rekomandim:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, të vlerësojë me prioritet nismën që po diskuton për rishikimin e skemës së bonusit të bebes, duke theksuar nevojën për të ofruar mbështetje të mëtejshme financiare për familjet me fëmijë nëpërmjet dhënies së një ndihme financiare mujore për një periudhë disa vjeçare, praktikë kjo e aplikuar nga pothuajse të gjitha vendet e rajonit dhe të Bashkimit Europian. Gjithashtu, MSHMS të identifikojë dhe propozojë politika të tjera që ofrojnë mbështetje financiare dhe jo financiare për familjet me fëmijë.

**Brenda datës 31.12.2026**

**11.1 Rekomandim:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të marrë masa për identifikimin dhe monitorimin e burimeve të tjera të financimit, përfshirë ato lokale dhe të qeverisjes qendrore, për të krijuar një pasqyrë më të qartë financiare, si dhe për të bërë dallimin midis fondeve të planifikuara dhe atyre të shpenzuara për aktivitete jashtë planit të veprimit që mund të ndikojë në eficiencën e zbatimit të tij.

**Në vijimësi**

**12.1 Rekomandim:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Shërbimi Social Shtetëror të analizojë e rivlerësojnë pamjaftueshmërinë e burimeve financiare të Fondin Social për të përballuar kërkesën në rritje për shërbime sociale, përdorimin e ulët të fondeve si dhe mosrealizimin e objektivave. Gjithashtu, Shërbimi Social Shtetëror të ndjekë dhe informojë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale mbi ecurinë e shërbimeve të financuara me Fond Social, për progresin dhe sfidat e hasura.

**Brenda datës 30.06.2026 dhe në vijimësi.**

**13.1 Rekomandim:** Ministria e Financave të vlerësojë me prioritet buxhetin e planifikuar për Programet e Nxitjes së Punësimit dhe disbursimit të vlerës që planifikohet në buxhetin fillestar. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive të marrë masa për zbatimin e buxhetit për Programet e Nxitjes së Punësimit dhe atë të Garancisë Rinore në masën e planifikuar duke ndjekur me vëmendje zbatimin e marrëveshjeve të lidhura për këtë qëllim.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

## 6. Observacione të subjekteve nën auditim

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit me shkresën nr. 3023/1 Prot., datë 19.01.2026, administruar në KLSH me nr. 33/10 Prot., datë 20.01.2026 ka paraqitur observacione mbi Projektraportin e auditimit. Këto observacione konsistojnë në komente dhe sqarime për disa nga rekomandimet e lëna nga grupi i auditimit që i përkasin MEI-t dhe konkretisht për rekomandimet nr. 1.1, 2.1, 5.1, 6.1, 9.1, 13.1. Në mënyrë të përmbledhur komentet e MEI paraqiten në vijim:

### **1. Pretendimi i subjektit** - rekomandimi 1.1 pika (iii),

*MEI sqaron se zbatimi i strategjisë realizohet mbi bazë vjetore, në përputhje me masat dhe afatet e përcaktuara në planin e veprimit të saj. Procesi i zbatimit monitorohet çdo vit në mënyrë të strukturuar, me qëllim vlerësimin e arritjeve dhe progresit në përmbushjen e objektivave strategjike, si dhe identifikimin e problematikave që lidhen me vonesat ose mosrealizimin e masave të caktuara, duke mundësuar ndërmarrjen e masave korrigjuese. Gjithashtu, bëhet me dije se në fillim të çdo viti shpërndahen formate të posaçme raportimi dhe monitorimi për secilën masë të strategjisë, të cilat plotësohen nga drejtoritë dhe agjencitë përgjegjëse, dhe mbi bazën e tyre hartohet raporti vjetor i progresit. Ky raport diskutohet në kuadër të Grupit të Menaxhimit të Integruar të Politikave, duke siguruar koordinim institucional, transparencë dhe llogaridhënie në zbatimin e strategjisë. Paralelisht, strukturat përkatëse raportojnë në mënyrë mujore për Kartën e Performancës dhe për planet mujore dhe javore të punës, sipas kërkesave të struktura ve drejtuese të ministrisë.*

### **Qëndrimi i grupit të auditimit**

Grupi i auditimit vlerëson se sqarimet e dhëna nuk e ndryshojnë gjetjen e auditimit, pasi nga evidencat e administruara rezulton se një pjesë e ndërhyrjeve kyçe të strategjisë të planifikuara për vitin 2024 nuk janë realizuar dhe nuk shoqërohen me dokumentacion të qartë që të dëshmojë përfshirjen e tyre si objektiva konkrete. Në këtë kuadër, grupi i auditimit vlerëson se ekzistenca e mekanizmave të monitorimit strategjik, megjithëse e rëndësishme, nuk garanton domosdoshmërisht zbatimin efektiv të ndërhyrjeve strategjike përmes planeve vjetore institucionale, ndaj rekomandimi për përfshirjen e tyre në këto plane mbetet i vlefshëm.

### **2. Pretendimi i subjektit** - rekomandimi 2.1

*MEI/AKPA sqaron portali i garancisë rinore është pjesë përbërëse e portalit të punësimit (puna.gov.al) dhe shërben kryesisht si mjet informimi për të rinjtë mbi shërbimet dhe programet e ofruara nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive. MEI/AKPA sqaron se treguesit që lidhen me zbatimin dhe ecurinë e skemës publikohen periodikisht përmes Buletineve Statistike dhe Analizës Vjetore të institucionit, të cilat janë të aksesueshme në seksione të ndryshme të portalit të punësimit, në kuadër të programit të transparencës. Po ashtu, bëhet me dije se zhvillimi dhe përmirësimi i mëtejshëm i portalit të Garancisë Rinore do të mbështetet financiarisht dhe teknikisht nga Programi Operacional për Zbatimin e Garancisë Rinore, në kuadër të IPA III.*

### **Qëndrimi i grupit të auditimit**

Në lidhje me portalin e Garancisë Rinore, grupi i auditimit vlerëson se, mungesa e publikimit të drejtpërdrejtë dhe të përditësuar të treguesve kryesorë në vetë portalin e Garancisë Rinore kufizon funksionin e tij si mjet informimi i dedikuar për të rinjtë dhe pengon ndërtimin e një qasjeje të bazuar në evidenca. Për rrjedhojë, pavarësisht ekzistencës së publikimeve alternative përmes portalit “puna.gov.al”, grupi i auditimit vlerëson se rekomandimi për rritjen e transparencës dhe funksionalitetit të portalit mbetet i vlefshëm dhe i nevojshëm për rritjen e besimit dhe aksesit të të rinjve në informacionin mbi rezultatet e programit.

### **3. Pretendimi i subjektit** - rekomandimi 5.1 dhe 6.1

*Për sa i përket rekomansimeve 5 dhe 6, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit pretendon se, rekomandimet adresohen përmes një sistemi të përbashkët monitorimi dhe raportimi të Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023–2030, ku përfshihen institucionet përgjegjëse dhe donatorët. Sipas saj, monitorimi vjetor mat zbatimin e masave dhe arritjen e indikatorëve. Gjithashtu pretendohet se, ndonëse AKPA nuk harton politika demografike, ajo zbaton politika aktive të tregut të punës me prioritet për grupet e disavantazhuara, përfshirë moshën 50+. Ministria mbështetet në të dhëna statistikore të publikuara, sipas të cilave në vitin 2024 kjo grupmoshë përbën rreth 25% të përfituesve, duke e paraqitur këtë si dëshmi të trajtimit prioritar.*

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit**

Gjetjet e grupit të auditimit, kanë të bëjnë me të dhënat e munguara në raport-progresin e vënë në dispozicion për vitin 2024. Pavarësisht disponueshmërisë së të dhënave, ato nuk janë pasqyruar nga AKPA në këtë raport-progres. Si pasojë, grupi i auditimit do të marrë pjesërisht parasysh pretendimin e subjektit dhe në Raportin Përfundimtar lidhur me gjetjen dhe rekomandimin 5 dhe 6 do të pasqyrohet ky ndryshim.

#### **4. Pretendimi i subjektit - rekomandimi 9.1**

*AKPA e vlerëson rekomandimin si të drejtë dhe në përputhje me drejtimet aktuale të zhvillimit të politikave publike dhe mbetet e angazhuar për të forcuar bashkëpunimin e mëtijshëm me institucionet përgjegjëse.*

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit**

Rekomandimi pranohet nga AKPA, si rezultat grupi i auditimit nuk ka komente.

#### **5. Pretendimi i subjektit - rekomandimi 13.1**

*Realizimi i programeve të nxitjes së punësimit është ndikuar nga një sërë faktorësh kontekstualë dhe institucionalë të cilët kanë ndikuar në ritmin e zbatimit të fondeve. Në këtë kuadër, viti 2020 përkon me miratimin paketës së re të programeve të nxitjes së punësimit, por njëkohësisht lidhet me situatën e jashtëzakonshme të shkaktuar nga pandemia.*

*Ndërkohë, viti 2023 lidhet ngushtësisht me nisjen e zbatimit të Skemës së Garancisë Rinore, cila është lançuar vetëm në fund të muajit tetor 2023. Duke qenë se programet e nxitjes së punësimit funksionojnë mbi bazën e vitit buxhetor, kjo kohëzgjatje e kufizuar e zbatimit ka bërë të pamundur absorbimin e fondeve përkatëse brenda vitit, duke sjelle mbartjen e plotë të tyre për vitin pasardhës. Si rrjedhojë, treguesit performancës financiare për vitin 2023 reflektojnë kryesisht kufizime kohore dhe jo mungesë planifikimi apo zbatimi nga ana e institucionit.*

*Për vitin 2025, situata paraqitet ndryshe. Treguesit e pjesëmarrjes në programet e nxitjes së punësimit kanë tejkaluar objektivat e parashikuara dhe fondet bazë për këto programe janë realizuar plotësisht, Megjithatë, një pjesë e fondeve është lidhur me Planin e Rritjes, i cili nuk është bërë aktiv që në fillim të vitit buxhetor, por vetëm pas përfundimit të gjashtëmujorit të parë. Për pasojë, deri në fund të muajit tetor 2025, niveli i realizimit të këtij komponenti ka qenë rreth 80%, duke reflektuar kufizime në kohë dhe jo në kapacitet zbatues.*

*Në këtë kontekst, AKPA vlerëson se analiza e performancës së fondeve për politikat aktive të tregut të punës duhet të konsiderojë domosdoshmërisht kushtet e zbatimit, kohën efektive në dispozicion dhe vendimmarrjen buxhetore përkatëse, në mënyrë që vlerësimi të jetë i drejtë, proporcional dhe i bazuar në evidencë.*

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit**

AKPA në komentet e paraqitura sqaron se ka një sërë faktorësh që ndikojnë në nivelet e realizimit të buxhetit. Nga ana e grupit të auditimit i rekomandohet AKPA-së të marrë masa që këto faktorë të adresohen në kohë dhe me përgjegjësi maksimale me qëllim realizimin e plotë të buxhetit të planifikuar i cili lidhet drejtpërdrejtë me menaxhimin dhe zbatimin efektiv të politikave dhe marrëveshjeve të punësimit. Si rezultat rekomandimi i lënë nga grupi i auditimit qëndron.